



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23 JANAR 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. JANUARA 2014. GODINE**

**JANAR - JANUAR
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Debat parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës,
5. Debat parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës për Prodhimin e Gypave në Ferizaj,
6. Raporti i Qeverisë së Kosovës për ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportet e auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe raportin e auditimit mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale për vitin 2012,
8. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje Zapisnika sa prethodne sednice,
4. Parlamentarna debata o procesu privatizacije Fabrike amortizera u Industrijskoj zoni u Prištini,
5. Parlamentarna debata o procesu privatizacije Fabrike za proizvodnju šavnih cevi u Uroševcu,
6. Izveštaj Vlade Kosova o toku procesa pregovaranja Sporazuma o stabilizaciji i pridruživanju,
7. Razmatranje Preporuke Komisije za nadgledanje javnih finansija u vezi sa izveštajima revizije u Ministarstvu zdravstva, Kosovskoj agenciji za medicinske proizvode, Univerzitetskom kliničkom centru Kosova i Izveštaja revizije o upravljanju medicinskim otpatkom za 2012. godinu,
8. Predlog PG PDK o zamenjivanju članova parlamentarnih komisija.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari zëvendëskryeministër,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
Mirë se keni ardhur në mbledhjen e parë të sesionit pranveror të vitit 2014!

Mbledhja e sotme plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës mbahet sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetit Liburn Aliu, nga radhët e Lëvizjes “Vetëvendosje”, me deputetin Faton Topalli.

Deputetit të ri i dëshiroj mirëseardhje dhe e ftoj që ta nënshkruajë tekstin e betimit.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta, diskutimet në emër të grupeve parlamentare pesë minuta, në emër të deputetit tre minuta.

Fjalën e ka deputetja, sipas radhës natyrisht, Blerta Deliu-Kodra. Në emër të grupit, fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, dua të uroj të gjithë sportdashësit, e në veçanti botën e futbollit në Kosovë për vendimin e FIFA-s, e cila e lejoi Kosovën të zhvillojë ndeshje miqësore.

Me këtë vendim, FIFA i dha fund epokës së izolimit shumëvjeçar të futbollit të Kosovës.

Andaj, vendimi i FIFA-s i 13 janarit 2014 me të drejtë është quajtur historik, sepse thyen izolimin dhe hap rrugën e zhvillimit të futbollit të Kosovës dhe mundëson afirmimin e sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare.

Pasi Kosova nuk është anëtare e OKB-së, edhe Federata e saj e Futbollit nuk mund të jetë pjesë e UEFA-s dhe FIFA-s. Por, Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, në krye me Fadil Vokrrin, ka arritur t’i shpërthejë në këto barriera.

Fillimisht FIFA i njohu transferimet e lojtarëve të Kosovës, e tani lejoi edhe zhvillimin e ndeshjeve miqësore. Për këtë duhet falënderuar legjendën e futbollit, kryetarin e Federatës së Futbollit, Fadil Vokrrin, dhe Komitetin Ekzekutiv të FFK-së, të cilët e bënë

një punë të shkëlqyeshme gjatë këtyre viteve, duke punuar me një strategji të qartë për thyerjen e izolimit hap pas hapi.

Njëkohësisht, e falënderoj kryeministrin Thaçi, i cili personalisht i shkroi letër presidentit Step Blater për t'i dhënë Federatës së Futbollit të Kosovës dhe kryetarit Vokrii mbështetjen e duhur institucionale për realizimin e këtij hapi të madh për futbollin e Kosovës. Gjithashtu e falënderoj edhe ministrin Krasniqi për mbështetjen e dhënë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Vendimi i FIFA-s për ta lejuar Kosovën të zhvillojë ndeshje miqësore në futboll është një hap pozitiv, i cili do t'u mundësojë sportistëve tanë që ta përfaqësojnë shtetin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Ne krenohemi me futbollistët tanë, të cilët na kanë përfaqësuar denjësisht në futbollin botëror kurdo që janë paraqitur dhe tani ka ardhur momenti që këtë prezantim ata ta bëjnë nëpërmjet reprezentacionit të Kosovës në futboll.

Andaj, edhe një herë i ftoj publikisht, që nga ylli i Mançester Junajtedit, Adnan Jonuzin dhe të gjithë të tjerët, që t'i bashkohen reprezentacionit të Kosovës në futboll. Me këtë ata do ta bënin një hap shumë të rëndësishëm në fuqizimin e futbollit dhe të subjektivitetit të Kosovës si shtet i pavarur dhe afirmimin e saj në botë.

Ashtu siç pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës luftuan për lirinë e vendit tonë, edhe futbollistët tanë më të mirë, duke qenë pjesë e reprezentacionit të Kosovës në futboll do të bëjnë bujë mediatike dhe do të luftojnë që ta afirmojnë vendin tonë në arenën ndërkombëtare. Këta ua kemi borxh të gjithë atyre brezave që u sakrifkuan për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Të nderuar kolegë,

Edhe ata që mendojnë se duhet të kemi dy shtete e një përfaqësuese, edhe ata që mendojnë se duhet të kemi dy shtete e dy përfaqësuese, apo një shtet një përfaqësuese, që të gjithë duhet t'i gëzohen këtij vendimi të FIFA-s që e lejon Kosovën të luajë ndeshje miqësore shtet me shtet, sepse mundëson që më shumë futbollistë të promovohen në arenën ndërkombëtare.

Andaj, shpresojmë shumë që në një të ardhme të afërt edhe Kosova, edhe Shqipëria, të jenë pjesë e kampionatit botëror dhe për këtë duhet t'i përvishemi punës që të gjithë për zhvillimin e futbollit dhe të sportit në përgjithësi në Kosovë. Ta forcojmë, ta reformojmë, ta modernizojmë atë, duke u dhënë gjallëri dhe bukuri arenave tona sportive.

Personalisht disa herë kam tërhequr vëmendjen se dita për garim në arenën ndërkombëtare po vjen dhe ne na takon t'i bëjmë investimet infrastrukturore dhe hapat e duhur ligjorë për zhvillimin e sportit. Për këtë arsye, një vit më parë e kemi thirrur debatin parlamentar për sport bashkë me deputeten Vjollca Krasniqi, për çka dua të ju falënderoj për debatin, konstruktivitetin e treguar dhe rekomandimet e aprovuara, e të cilat nuk janë marrë parasysh seriozisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Me gjithë angazhimin maksimal të Federatës së Futbollit dhe Qeverisë së Kosovës, ne kemi mungesë të infrastrukturës sportive, nuk e kemi kompletuar legjislacionin e nevojshëm për zhvillimin e sportit. Mungon Ligji për sponsorizim dhe donacione në sport, mungon Ligji për ndalimin e dhunës, Ligji kundër huliganizmit, mungon Ligji për menaxhimin e objekteve sportive dhe për sigurinë e tyre e të tjera.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjithashtu dua të falënderoj të gjithë ata që punuan në pavarësimin e futbollit të Kosovës dhe ata që e mbajtën gjallë atë gjatë këtyre viteve, donatorët e shumtë, trajnerët, futbollistët. Prandaj, uroj që së bashku t'i arrijmë që Federata e Futbollit të Kosovës së shpejti të jetë anëtare me të drejtat e plota në UEFA dhe FIFA. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Para gati katër vjetëve, qytetarëve të Kosovës iu premtua lëvizja e lirë. Ky premtim i dhënë nga kryeministri Thaçi, edhe pse në kohë fushate elektorale, ngriti pritjet e qytetarëve, të cilët akoma mbeten të getoizuar si rezultat i keqqeverisjes së atyre që premtuan dhe garantuan se lëvizja pa viza do të ndodhë shumë shpejt.

Deklarimet e zyrtarëve të Qeverisë, duke premtuar liberalizim këtë vit apo vitin tjetër vazhduan, duke i zhgënjyer kështu vazhdimisht qytetarët e Kosovës dhe duke dëshmuar se për këtë Qeveri procesi i integritit evropian nuk është gjë tjetër, pos një proces i mbushur me deklarime boshe politike, por pa veprime konkrete dhe pa plotësim kriteresh.

Si rezultat i kësaj paaftësie për t'i ndërmarrë reformat e nevojshme dhe i papërgjegjësisë politike, procesi i integritit evropian ka degraduar jashtëzakonisht shumë.

Edhe partnerët tanë në BE tashmë e kanë kuptuar që nga kjo qeveri nuk mund të presin plotësim të kriterëve teknike, sepse është treguar e paaftë për këtë, por për t'u dhënë ndonjë karotë apo shpërblim në procesin e integritit, zakonisht nga ajo kërkohen koncesione në dialogun Kosovë-Serbi.

Se premtimet e kryeministrit rreth liberalizimit janë shumë larg realitetit u demaskuan edhe ditë më parë nga raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, zonja Lunaček, e cila deklaroi se liberalizimi nuk do të bëhet gjatë këtij viti dhe se kjo mund të ndodhë në dy apo tre vjetët e ardhshme. Pra, kjo ishte në vazhden edhe të deklaratave të zyrtarëve të tjerë evropianë.

Në fakt, kjo deklaratë dëshmon se shteti i Kosovës nuk i ka përmbushur obligimet e zotuar ndaj procesit të integritit, ndërsa për këtë nuk mund të fajësohet askush tjetër, përveç Qeverisë së Kosovës, si bartëse kryesore e këtij procesi.

LDK-ja vazhdimisht e ka përkrahur procesin e integrimit evropian, pasi e konsideron interes strategjik e kombëtar, por kjo përkrahje nuk i ka mjaftuar Qeverisë që t'i bëjë edhe hapat minimalë në këtë proces.

Gjatë vitit që shkoi, mijëra qytetarë të Kosovës e morën rrugën e rrezikshme të migrimit ilegal, duke rrezikuar kështu edhe jetën e tyre për ta siguruar një perspektivë dhe mbijetesë në ndonjë vend tjetër, meqë as perspektiva e as mbijetesë nuk ka mbetur e mundshme për ta në Kosovë.

Këto pamje që na kthyen kujtesën në vitin '99 tregojnë se deklaratimet e Qeverisë se procesi i integrimit evropian është interes prioritar i Kosovës nuk merren seriozisht as nga vetë ata zyrtarë. Në vend se t'i luftojnë skandalet korruptive, edhe dikasteret e Qeverisë u bënë sinonim i këtyre skandaleve. Në vend se të punojnë për pavarësinë e Gjyqësorit, vetë mbetën ndërhyrës kryesorë në këtë sektor. Në vend se të sigurojnë ekonomi të lirë të tregut, me veprimet e tyre kontribuan në zhvillimin e monopolit dhe ekonomisë jokonkurruese.

Në vend se të sigurojnë zhvillim ekonomik, Kosovën e shndërruan në një vend nga i cili qytetarët tentojnë të ikin vazhdimisht, duke u prirë kështu listave të shteteve për migrim ilegal.

Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka premtuar që fajin për mosavancim të procesit të liberalizimit ta kualifikojë si politik.

Të gjithë e kemi dëgjuar kryeministrin këtu në Parlament duke akuzuar Rumaninë, Sllovakinë, Qipron, Spanjën dhe Greqinë për bllokim të liberalizimit. Mirëpo, asnjëra nga këto shtete nuk e ka bllokuar Qeverinë e Kosovës që t'i adresojë kërkesat teknike të procesit, të cilat nuk varen e as nuk bllokohen nga dikush tjetër, pos nga dikasteret qeveritare.

Skandali i pasaportave, skandalet e shumta në Polici dhe në institucionet tjera treguan se faji nuk mund të hidhet diku tjetër, sepse fajtori kryesor gjendet brenda Kosovës.

Koordinimi nga Ministria e Integrimit Evropian, sado i mirë që të jetë, nuk mjafton nëse nuk ka çka të koordinohet, sepse nuk ka punë të mjaftueshme nga dikasteret tjera qeveritare.

Prandaj, LDK-ja i bën thirrje Qeverisë së Kosovës dhe të gjitha institucioneve që urgjentisht dhe seriozisht ta trajtojnë planin e veprimit për liberalizimin e vizave, t'i adresojnë të gjeturat e raporteve të fundit të progresit dhe të angazhohen shumë seriozisht në procesin e negocimit të MSA-së.

Getoizimi i qytetarëve të Kosovës duhet të marrë fund. Për çdo vit e më shumë po dëshmohet se ky izolim do të marrë fund vetëm kur t'i jepet fund qeverisjes Thaçi. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Skandalet publike në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” nuk kanë të ndalur. Për më tepër, ato e kanë pushtuar çdo pore të organizimit të këtij institucioni publik të arsimit të lartë. Të gjithëve na kujtohet afera e publikuar kohë me parë në mediet vendore, ku tregohet se si një rrjet i tërë kriminal, i përbërë nga profesorë, asistentë dhe studentë “administronte” nëntokën e Universitetit, duke regjistruar studentë jashtë konkursit, tregtonte provime, punësonte staf akademik nga radhët e militantëve partiakë, e shumë e shumë keqpërdorime tjera.

Mirëpo, ende pa filluar hetimet për këtë aferë nga institucionet përgjegjëse juridike, një skandal tjetër u publikua dje në media, përkatësisht në gazetën “Koha Ditore”. Kjo aferë tregonte për përmasat groteske të një maskerade pseudo-akademike që e ka pushtuar këtë institucion. Është fjala për rrjetin e “profesorëve mashtrues”, që karrierën e tyre akademike dhe avancimin shkencor brenda Universitetit e kanë ndërtuar mbi logjikën e manipulimit, mashtrimit, korrupsionit dhe devalvimit.

Ky hulumtim tregon se si kjo armatë e “profesorëve me tituj fals shkencorë” ka arritur që të ofrojë dëshmi të rreme për avancim të brendshëm brenda institucionit nga një revistë pa cilësi që publikohet në shtetin e Indisë, vetëm sa për ta plotësuar kriterin statutor të Universitetit, kriter ky që parasheh publikimin e 5 punimeve në revista shkencore ndërkombëtare për përfitimin e titullit të profesorit të rregullt.

Ky hulumtim tregon po ashtu se komandanti i kësaj armate të manipuluesve profesorë është rektori politik i Universitetit të Prishtinës, Ibrahim Gashi. Rektor ky që, siç dihet, edhe ishte zgjedhur në këtë pozitë me një sërë manipulimesh nga një këshill drejtues partiak i partisë në pushtet.

Këto fakte tregojnë shumë qartë se tashmë manipulimi, mashtrimi, shkatërrimi i cilësisë akademike dhe degradimi i Universitetit e përbën tiparin kryesor të punës së strukturave menaxhuese të këtij institucioni. Dhe, nuk ka dilemë se kjo frymë e shkatërrimit të këtij institucioni është zhvilluar me bekimin e politikës së deritanishme institucionale. Është më se e ditur se në Kosovën e pasluftës, strukturat udhëheqëse, e sidomos rektorët, janë emëruar nga strukturat politike dhe parapolitike. E të mos flasim edhe për komisionet recensuese për zgjedhjen e stafit akademik se si kriter të vetëm e kanë pasur rekrutimin e militantëve partiakë.

Substantialisht, kjo qasje e ndjekur nga politika e deritanishme e ka shndërruar këtë institucion vetëm në një godinë universitare, duke zhbërë idenë e Universitetit. Pra, nga një vend për prodhimin e dijes në funksion të zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe kulturor, këto struktura menaxhuese dhe ato pararendëse e kanë tjetërsuar bartësin më të madh të arsimit publik në vend në qendër të prodhimit të krimit, mashtrimit e korrupsionit.

Është e ditur se shteti modern, krahas aftësisë për ta shtrirë autoritetin e tij, duhet edhe ta investojë, prodhojë dhe universalizojë në kuadër të shoqërisë dijen. Nga ky motiv rrjedh edhe sintagma “Shteti i Dijes”, nocion ky që fatkeqësisht më së shumti është bastarduar nga kjo Qeveri dhe ministrat e saj. Dhe, mbi këtë formulë sot zhvillohet njëri nga boshtet kryesore të konkurrencës globale ekonomike dhe politike ndërmjet shteteve. Kurse vendet që janë të privuara nga këto cilësi, sikur rasti ynë, rrezikojnë të mbeten në margjina dhe pa pasur mundësi të bëhen pjesë e kësaj sfere të rëndësishme të ekzistencës moderne historike.

Ndërkaq administrimi dhe menaxhimi i Universitetit të Prishtinës nga kjo strukturë menaxheriale me mbështetje politike mbase mund ta bëjë këtë institucion shembull eklatant dhe të pakonkurrencë global në një dimension tjetër.

Besoj se nuk do të ketë kush t’ia kalojë sa i përket aftësisë për të mashtruar në mënyrë universale nën paravanin e vlerave akademike. Faleminderit!

KRYETARI: Unë kërkoj nga deputetët që disa vlerësime që nuk janë të deputetëve, por të organeve ndjekëse dhe të drejtësisë, le t’i thonë ato, e jo ne ta marrim rolin e tyre. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini, kryetar i Grupit.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do ta lexoj një nen të marrëveshjes për partneritet publiko-privat për operimin dhe zgjerimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Është i shkruar me një shqipe “të mirë”. Po e dini për çfarë e kam fjalën. Është i përkthyer keq domethënë. Me siguri këta farë profesorë ordinarë, për të cilët foli Afrim Kasolli, kanë punuar në këtë gjuhë, por nuk është vetëm gjuha për të cilën do të flas. Po e lexoj një herë, edhe pse është goxha zor, por po provoj.

“Dhënësi do ta zhdëmtojë partnerin privat kundër dhe do ta mbajë të padëmtuar partnerin privat nga ndonjë humbje e shkaktuar nga partneri privat që është i demonstrueshëm dhe drejtpërdrejtë i atribueshëm në operimin nga ana e dhënësit, apo ndonjë autoriteti relevant, apo nga ndonjë person i autorizuar nga dhënësi, apo ndonjë autoritet relevant i ndonjë aeroporti tjetër ndërkombëtar komercial në Republikë gjatë kohëzgjatjes të kësaj kontrate, përveç për aq sa humbja e tillë rezulton nga, apo është e atribueshme në ndonjë akt, apo lëshim nga partneri privat, apo ndonjë personi të partnerit privat, apo ndonjë kontraktor të partnerit privat, duke përfshirë pa limite kontraktorë dhe operues apo ndonjë shkelje të kësaj kontrate na partneri privat, duke përfshirë ndonjë dështim nga partneri privat që të respektojë dhe të veprohet në përputhje me ndonjë ligj, rregullim apo dekrete të aplikueshëm të Republikës, apo ndonjë autoriteti relevant”.

Nuk pati pikë. Për këtë arsye e lexova kështu, se nuk pati pikë, dhe është goxha problem të nxirren këto tema. Çka po thuhet këtu në këtë nen, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, i nderuar zoti kryetar, është kjo: Që dhënësi, do të thotë Qeveria e Kosovës, shteti i Kosovës, nuk ka të drejtë të operojë me kurrfarë aeroporti tjetër në Republikën e Kosovës, kurrsesi domethënë gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Kjo po thuhet. Po aq

mirë e kanë pështjellë gjuhën si zakonisht, sa duhet bërë hulumtime serioze kush janë këta profesorë ordinarë kaq të mençur që dinë t'i pështjellin kaq mirë.

E dini ju se gjatë fushatës është folur shumë për aeroportin, si do të hapet aeroporti, kush do ta hapë aeroportin. Shihni! Sikur për profesorët, sikur për temën për të cilën foli deputetja Vjosa Osmani, a po ju duket që ky vend yni është shndërruar në një vend ku veç mashtrohet, mashtrohet, mashtrohet, me nga 5 000 veta në Japoni, me liberalizim të vizave, me nga 600 njohje. A po ju duket që gjithçka është shndërruar në mashtrim dhe është lodhur, është lodhur materia, është lodhur populli. Është një farë fjale që thotë 'kur krimi bëhet i tepërt, as nuk shihet'. Kur mashtrimi bëhet i tepërt, as nuk shihet.

I nderuar, zoti kryetar,

Kush e ka bërë këtë kontratë, kush e ka pranuar këtë kontratë, më së paku ka menduar për Kosovën. Ama bash hiç nuk ka menduar për Kosovën. Veç po ju tregoj: Maqedonia i ka dy aeroporte, edhe pse e kanë koncesionuar, ata s'e kanë pasur problem t'i kenë dy aeroporte ndërkombëtare.

Mali i Zi i ka dy aeroporte. Shembull ta marrim, që ka për të tretën më pak banorë se Kosova dhe ndoshta për të katrën herë më pak fluturime se Kosova. Për Serbinë e për Kroacinë e për të tjera të mos flasim.

Zoti kryetar, veç shqiptarët e shkretë e kanë nga një aeroport, se e kanë bërë nga një kontratë të mos guxojnë të bëjnë asgjë tjetër. Edhe në të njëjtën kohë hiç nuk i vjen marre askujt të dalë në televizion dhe të rrejë, e të thotë do t'i hapim se po i ha populli. Do t'i çojmë nga 5 000 veta të mbledhin kërpudha, se po i ha populli. Domethënë, rrej sa të mundesh, se njerëzit po hanë.

I nderuar, zoti kryetar,

Këtë që e bëra dhe këtë që e lexova është një temë goxha relevante për shkak se edhe kontraktimet tjera, edhe shitjet tjera, edhe subvencionime tjera, kanë ndodhur në të njëjtën logjikë. Nuk është menduar për Kosovën, nuk është menduar për popullin e Kosovës. Është mendua vetëm të shiten sa më mirë që të jetë e mundshme dhe për këta njerëz të mos ndodhë asgjë. Kujtojeni vetëm këtë dimër në të cilin jemi sa njerëz janë sorollatur aeroporteve se s'kanë mundur të aterrojnë në Aeroportin e Prishtinës. Sa ditë, sa fluturime, sa njerëz kanë mbetur pa punë, sa njerëz kanë mbetur me fëmijë të vegjël nëpër aeroporte? Dikujt nuk i ka shkuar mendja se Kosova ka nevojë edhe për një aeroport tjetër, por ç'është më e keqja - nëse kanë qenë injorantë edhe të padijshëm dhe nuk e kanë ditur që Kosova ka nevojë edhe për një aeroport, kanë vazhduar të rrejën.

Domethënë, pasi e kanë nënshkruar kontratën, kanë vazhduar ta mashtrojnë popullin dhe ky është krimi. Ndoshta nuk i kishim llogaritë aq keq pse s'kanë ditur, por kur e dinë edhe ia nisin të mashtrojnë vazhdimisht, të rrejën për të mashtrua, mendoj se duhet nisur t'i tregohet popullit, t'i thuhet 'mos e ha kështu'...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Disa herë në këtë Parlament kam folur për pozitën e vështirë të personave me aftësi të kufizuara. Disa herë i kam përmendur ligjet ekzistuese, ligjet të cilat nuk i trajtojnë personat me aftësi të kufizuara në mënyrë dinjitoze, apo edhe ligjet të cilat janë në fuqi, por që nuk zbatohen.

Për personat me aftësi të kufizuara ekziston ligji i cili u ndan 100 euro familjeve të cilat kanë fëmijë me aftësi të kufizuara deri në moshën 18-vjeçare, e pas kësaj moshe është ligji tjetër, i cili personat me aftësi të kufizuara i quan pensionistë dhe shuma zbret në 60 euro.

Pastaj, e kemi ligjin tjetër për aftësim dhe aftësim profesional të personave me aftësi të kufizuara, sipas të cilit çdo i 50-ti i punësuar duhet të jetë person me aftësi të kufizuara, por i njëjti nuk zbatohet.

Dy ligje të cilat i përmenda, siç e patë edhe vetë, siç ju thashë, dhe e dini edhe ju, që pagesa e cila kryhet është minimale në krahasim me nevojat, të cilat i kanë këta persona.

E kemi udhëzimin administrativ, i cili thotë se objektet, rrugët duhet të jenë me pjerrina, por i njëjti e dimë sa zbatohet në Kosovë.

Në strategjinë legjislative të vitit 2013, një ndër ligjet të cilat është dashur ta marrim edhe në komisionin të cilin e drejtoj, është edhe Ligji për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, ligj i cili është pritur të vijë në dhjetor të vitit 2013. Do të thotë, është neglizhuar edhe koha, periudha kur është dashur të vijë në komision.

Në periudhën e vitit 2013, asnjë ligj nga gjashtë ligjet nuk ka ardhur në komisionin përkatës. Tani strategjia legjislative që do ta kemi në këtë Parlament e parasheh përpilimin e projektligjit për këta persona në muajin tetor, apo ndoshta në kohën kur do të ketë fushatë. Do të thotë, as sivjet nuk parashihet të përpilohet ky ligj.

Ligji për të verbrit është diskutuar disa herë në Parlament, por i njëjti ende nuk ka gjetur zbatim, edhe pse tash e një vit ka hyrë në fuqi.

Krejt të fund, dëshiroj ta theksoj kërkesën time për Qeverinë që ligjet ekzistuese kanë nevojë për plotësim dhe ndryshim dhe kërkoj nga Qeveria që të njëjtat t'i plotësojë dhe t'i ndryshojë, që personat me aftësi të kufizuara të trajtohen në mënyrë dinjitoze. Gjithashtu, ligjet të cilat nuk zbatohen, të njëjtat t'i zbatojë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari Petar Miletiq.

PETAR MILETIĆ: Poštovani gospodine predsedniče,
Članovi Vlade,
Kolegnice i kolege poslanici,
Pre nedelju dana u severnom delu Mitrovice ubijen je Dimitrije Janičijević, odbornik Skupštine opštine Mitrovica.

Ubijen je ispred svoje kuće, skoro na očigled majke i supruge, i pomalom je postalo deplasirano da svaki put kad neko bude ubijen sa ove govornice osuđujem ubistvo, jer to ne vodi ničemu, i to nedonosi nikakav rezultat.

Od Kosovske policije neočekujem da reši ovaj slučaj, nije rešila dosad nijedan, pa neće ni ovaj.

To sam rekao pre od priliku godinu ipo dana, kada je u selu Talinovac ubijena porodica Jeftić. I tada sam nedelju dana nakon ubitstva tvrdio da Kosovska policija neće rešiti slučaj. Izrazio svoju spremnost da se izvinim takođe sa ove govornice i policiji i Ministarstvu unutrašnjih poslova ako to urade. Naravno nisu. Tako da neočekujem ni ovoga puta da će ovaj zločin biti rešen, samo vas molim kao odgovorne ljude, kao poslanike, da se još jednom zamislite na time da neko koje izabran od naroda da bude njihov predstavnik u jednoj instituci, u ovom slučaju u Skupštini opštine, da je ubijen i da to znači da je to dozvoljeno da se radi, ukoliko se naravno ne odkrije počinitelac, a neće ni ovaj.

Želim da se zahvaljim Vladi što je odvojila novčana sredstva za porodicu Janičijević, i ako to naravno neće njima previše ublažiti bol, ali u svakom slučaju to je potez koji pokazuje da Vlada želi da misli o svojim građanima.

Kada sam, pre od prilike dve godine, takođe sa ovom govornicom pomenuo svoj slučaj, i napad na mene, dobio sam komentare da želim da profitiram nad svojom nesreću. Što naravno nije tačno, samo sam želo da se spreče novih napadi na ljude, novi napadi na poslanike, na odbornike, i naravno nisam uspeo u tome.

Porodici Janičijević, to sam učinio lično, jer Dimitrije bio lični prijatelj, i sa ovog mesta upućujem izraza saučešće.

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Rasim Demiri.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedniče!
Poštovani predsedniče,
Poštovani ministri,
Poštovani kolege poslanici,
Moje današnje obraćanje je povodom izbacivanje sa posla Edina Islamovića od strane gospodina Agima Bahtirija predsednika Opštine Mitrovica.

Predsednik Opštine Mitrovice Agim Bahtiri, koji u predizbornoj kampanji obećao

otvaranje novih radnih mesta, nažalost je počeo suprotno od datih obećanja, te je počeo sa otpuštanjem starih radnih i zapošljavane članova svoje političke partije.

Žrtva Agima Bahtirija, predsednika Opštine, je i Bošnjak Edin Islamović iz Mitrovice, koji je izbačen sa posla samo iz jednog razloga, kako kaže on, da mu je predsednik rekao da on nije radio u predizbornoj kampanji za njega i njegovu političku partiju.

Edin Islamović je radio u kancelariji za zajednice. Prije četiri godine, Edin Islamović bio je kontrolor parlamentarnih izbora u opštini Leposavić, sa prevelikom željom da institucije Republike Kosova zažive i na severu Kosova. Dok je obavljao svoj posao bio je ranjen i dobio osam metaka u selu Postenje opština Leposavić od onih koji i dan danas ugrožavaju mir i bezbednost građana na severu Republike Kosova, a u tom napadu ubijen je rahmetli Šefko Salković.

Edin Islamović je žrtva države Kosovo, koja nije uspela da mu obezbedi uslove za život, iako je radio za Kosovo i njene interese.

Edin Islamović koji je oženjen i ima troje dece, živi pod kirojom, koju je mesečno plaćao 150 evra od svoje plate dok je radio pri kancelariji za zajednice, a koji i dan danas ne sme da se vrati u svoj rodni kraj u selu Rvatska opština Leposavić od kako je bio ranjen, jer muje ugrožena bezbednost.

Da bi institucije Republike Kosova zaživela na severu Kosova, žrtva svega ovoga je i otac Edina Islamovića, koji je radio u Rudniku Crmoč, i kojije izbačen sa posla

Apelujem na sve institucije Republike Kosova, na predsenika Opštine Mitrovica, Agima Bahtiri, da se slučaj Edina Islamovića reši, i da se što pre vrati na svoje radno mesto, na koje je 14 meseci radio kao šluzbenik pri kancelariji za zajednice. Hvala!

KRYETARI: Dhe, diskutuesi i fundit për sot, deputeti Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem predsedniće,

Poštovani Vladin kabinet,

Poštovani kolege zastupnici,

Po cifri od 50 hiljada nezaposlenih u prizrenskom-dragaškom regionu, svakako da je najveći procenat nezaposlenosti pripada Bošnjačkoj i Goranskoj zajednici. Ovu tvrdnju mogu podkrepiti argumentima o statističkim podacima iz regionalnog instituta zapošljavanja, odnosno biroa za zapošljavanje.

Izneću neke komparativne parametre o određenoj ulozi Bošnjačke i Goranske zajednice u opštini Prizren, Dragaš, Peć i Istok. Ekonomska podređenost bošnjačke i goranske zajednice zbog neobjašnjivog ignorisanja formiranja opština, čime je naneta ogromna nepravda na socio-ekonomskom planu zbog razno raznih propusta na političkoj sceni, koje se ogledaju u sledećem.

Vlast preko lokalne samouprave, koja treba da donese blagostanje po novoformiranim opštinama, jedino nije približena građanima bošnjačke i goranske zajednice, koja na nivou Kosova ubedljivo iz albanske po najnovijim zvaničnim saznanjima i Zavoda za statistiku, a u opštinama Prizren, Dragaš, Peć i Istok ubedljivo naveća nevećinska zajednica.

Bošnjačka i Goranska zajednica na primer nisu imali tu privilegiju da se nađu među 8 novoformiranim opštinama po Ahtisarijem paketu, a o decentralizaciji, i kako se u nekim izveštajima OSCE navodi da nisu bili čak ni zainteresovani za opštine, što je sasvim suprotno od onoga što narod traži.

Zbor neuspešnog procesa decentralizacije, naša zajednica jeostala bez zapošljavanja svojih kadrova u Gori, Župi, Vitimirici. Najmanje 200 do 300 zapošljenih u administraciji u novim oštinama bi bilo, ili za 6. godina to je najmanaje cifra 5. miliona eura izgubljenih ličnih primanja. Nepovratnih grantova iz Vladinog budžeta Kosova, nevladenih i vladinih međunarodnih orgaizacije, godišnje po opštini od prilike od 140 do 250 hiljada eura, ili 840 hiljada do milion eura za 6. godine izgubljenih, a za tri opštine puta tri.

Veliki broj NVO Župe, Podgore, Gore Vitimirice ostali su bez šanse da se kandiduju, i da kandiduju svoje projekte pred organima svojih opština, a opštine pred organima centralne vlasti Kosova i međunarodnim donatorskim organizacijama, bilo vladinim ili nevladinim, ambasadama, konzulatima i tako dalaje, što je dovelo do prekida investicionog fonda u našim krajevima, pa bih napomenuo približnu cifru cirka 10. miliona eura izgubljenih ovakvim pasivnim delovanjem sa izgubljenim za duži period ravonpravnaog razvoja, urbanizacije i podizanje kvaliteta života subruralnih i ruralnih naselja. Bez podizanje vrednosti objekata i zemljišta u sadašnjim prigradskim i seoskim područjima, zbog zakašnjenja sa izgradnjom infrastrukture i turističkoj suštini sadržaja, bez približavanja ruralnih fondova i grantova, nema razvoja naše države.

Bezprava da Župa, Gora i Vitimirice mogu dobiti povoljne kredite za javne radove i kapitalne investicije...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Koha e paraparrë prej 30 minutash për pikën e parë është përfunduar. Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputetja Alma Lama, nuk është këtu. Pyetja e dytë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi nuk është. Pyetja e tretë, deputetja Ganimete Musliu, pyetje për zëvendëskryeminstirin Hajredin Kuçi. Zëvendëskryeministri dhe ministri i Drejtësisë nuk është këtu. Do ta bësh pyetjen?

GANIMETE MUSLIU: I nderuar kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,
Mendoj që është bërë një gabim nga Administrata, sepse unë e kam parashtruar pyetjen në seancën e fundit të sesionit vjeshtor. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçin. Zëvendëskryeministri dhe ministri nuk është këtu. Nuk do ta bësh pyetjen. Deputetja Donika Kadaj-Bujupi nuk është këtu. Deputetja Lirije Kajtazi, pyetje për ministrin Memli Krasniqi. Deputete, e ke fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Kisha interesimin për fushën e trashëgimisë kulturore si një fushë mjaft e ndjeshme dhe mendoj se ministri këtu mund të përgjigjet. Shumë ngecje në këtë drejtim ka shkaktuar mungesa ose vonesa e ligjit të amendamentuar të trashëgimisë kulturore. E di që ministri më parë është deklaruar që çdo gjë është gati. Më intereson ta di, ngase ka qenë edhe në agjendën legislative, por ligji ende nuk vjen këtu dhe për këtë arsye shkaktohen mjaft minuse në fushën e trashëgimisë. Andaj, është kjo pyetje për vonesat e ligjit për trashëgiminë kulturore.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: E nderuara deputete, faleminderit për pyetjen!

Është evidente që ligji është vonuar dhe personalisht e kam shprehur këtë shqetësim.

Kur unë kam thënë se në qershor do të jetë në Kuvend, kam thënë se shpresoj që do të ndodhë kështu dhe për këtë jemi bazuar në planin e punës.

Ky ligj, besoj pajtoheni edhe ju, është mjaft i rëndësishëm dhe që ndërlidhet me shumë fusha, si dhe me një numër të konsiderueshëm të ligjeve ekzistuese.

Pikërisht për këtë edhe i është dashur grupit punues gjithëpërfshirës që të konsultohet me shumë mekanizma vendorë e ndërkombëtarë.

Tani ne presim që më 10 dhe 11 shkurt ta kemi një takim final me të gjitha palët e interesit për ta harmonizuar draftin e ligjit dhe për t'u siguruar që të përfsihien rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë që kanë punuar në ligj.

Pas kësaj, ne planifikojmë që sa më parë këtë projektligj ta procedojmë për miratim në Qeveri, në mënyrë që ai të vijë në Kuvend sa më parë. Mendoj se më e rëndësishmja është që këtu të sjellim ligje të mira, të cilat i adresojnë saktë dhe drejt sfidat dhe nevojat e fushës përkatëse.

Po ashtu, shtoj që mungesa e ligjit të ri në asnjë mënyrë nuk e ka penguar avancimin në fushën e trashëgiminë kulturore, meqenëse e kemi një ligj ekzistues dhe po ashtu një sërë aktesh nënligjore, të cilat janë në fuqi. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë? Jo. E ke edhe një pyetje tjetër.

LIRIJE KAJTAZI: Ndoshta kanë lidhshmëri se e trajtojnë fushën, problematikën e njëjtë të trashëgimisë kulturore, dhe për atë arsye edhe nuk pata pyetje shitesë tek e para. Ka qenë e pritur ndoshta përgjigja e ministrit se vonesa e ligjit nuk lë ndonjë vakum, apo probleme në fushën e trashëgimisë.

Ndërkohë që unë mendoj që po, ngase edhe në paraqitjet e veta publike, ministri e ka paraqitur këtë shqetësim të vetin dhe një segment në të cilin krijohen probleme është Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore. E dimë që ai është jashtë mandati dhe kur të themi jashtë mandatit, ndoshta nuk ka kuptim edhe të themi jashtë kompetencave, por një formacion i mbetur apo i vetëquajtur Njësia Operative e Këshillit vazhdon të ekzistojë me detyrat të cilat ia ka përshkruar vetvetes.

Më intereson relacioni i Ministrisë së Kulturës në këtë njësi dhe çfarë bëjnë ata, çfarë kompetenca kanë në njëfarë forme, ku e marrin legjitimitetin e punës së vet dhe po ashtu një problem, të cilin ministri e ka prezantuar - kompetencat e institucioneve të trashëgimisë. Sa ndërhyjnë në kompetencat e institucioneve ky këshill dhe para së gjithash po them relacionet me ministrin dhe me Ministrinë e Kulturës?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI MEMLI KRASNIQI: Faleminderit për pyetjen!

Këshilli i Kosovës për Trashëgiminë Kulturore është njëri nga institucionet e rëndësishme për ruajtjen dhe promovimin e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Është e vërtetë që ka kohë që këshilli është pa anëtarë, pasi atyre u ka skaduar mandati, por është në kompetencën e Kuvendit të Kosovës që të vendos nëse do t'i emërojë anëtarët e rinj dhe unë besoj që edhe në komisionin përkatës kemi pasur një pajtueshmëri që pas miratimit të ligjit të ri të procedojmë edhe me nominimet dhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj në këtë këshill.

Dua ta sqaroj që këshilli si i tillë nuk e ka një ndërlidhje varësie me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Sidoqoftë, me Njësinë Operative apo Sekretarinë e Këshillit në fjalë ne kemi bashkëpunim në aktivitetet e ndryshme, duke përfshirë bashkëpunimin në hartimin e ligjeve për trashëgiminë kulturore, strategjisë kombëtare për trashëgiminë kulturore, si dhe së voni edhe në bashkorganizimin e Konferencës së parë për trashëgiminë kulturore të nivelit rajonal, që ka trajtuar trashëgiminë e luajtshme dhe trafikimin e paligjshëm të njësive të trashëgimisë së luajtshme.

Sa i përket çështjet tjetër të ndarjes së kompetencave të institucioneve të ndryshme të fushës së trashëgimisë kulturore, është e vërtetë që ne po mundohemi që nëpërmjet draftit të ri të ligjit dhe akteve nënligjore që do të derivojnë nga ai, apo edhe atyre që do të plotësohen dhe ndryshohen të kemi një qartësim, meqenëse sipas ligjit aktual ka një paqartësi, ka një

ambiguitet dhe ne mendojmë se tek pas miratimit të ligjit të ri, që ne shpresojmë, siç thashë, në dy tre muajt e ardhshëm do të jetë për diskutim në Kuvendin e Kosovës, ta kemi një plan se si ato do të ndërthuren ndërmjet veti dhe cilat do të jenë kompetencat e sakta, qoftë te institucionet në nivelin qendror, siç është Instituti Arkeologjik, Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës, Muzeu i Kosovës, apo dhe qendrave rajonale për trashëgiminë kulturore, që funksionojnë në nivel rajonal. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë? Nuk ke. Por, megjithatë, unë po them që nuk është përgjegjësi e Kuvendit. Ligji e përcakton kush e propozon dhe Kuvendi pastaj e kryen obligimin e vet. Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Afërsisht për dy milionë banorë të Republikës së Kosovës janë vetëm 14 shtretër në Kujdesin Intensiv në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë.

Ky numër prej 14 shtretërve në Kujdesin Intensiv është shumë i vogël për nevojat e qytetarëve të Kosovës, të cilët kanë nevojë për trajtim për kujdesin intensiv.

Për fat të keq, Kujdesi Intensiv nuk është funksional prej spitaleve rajonale dhe kjo e vështirëson edhe më tepër punën në Qendrën Klinike Universitare.

Pyetja është: Çfarë hapash ka ndërmarrë ministria për rritjen e kapaciteteve në trajtimin në Kujdesin Intensiv në nivel të Kosovës?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar deputet Haxhiu,

Kjo është një prej çështjeve më prioritare me të cilin jam marrë gjatë tërë mandatit tim dhe atë që nga ditët e para. Është fakt se kapacitetet për Kujdesin Intensiv në vend janë jashtëzakonisht të ulëta. Kemi bërë përpjekje të jashtëzakonshme në këto tre vjet që t'i fuqizojmë fillimisht resurset e nevojshme profesionale për funksionimin e këtij shërbimi dhe në këtë drejtim e kemi bërë atë që ka qenë e mundur të bëhet, duke pasur parasysh edhe motivacionin e profesionistëve shëndetësorë që të merren me lëmi të ndryshme specialistike, që kanë të bëjnë me Kujdesin Intensiv.

Konkretisht, nuk e kemi asnjë anesteziolog, i cili është i motivuar për punë në sektorin publik, e që është i papunë. I kemi të punësuar 80 anesteziologë, në procesin e specializimit i kemi 24, dhe në konkursin e fundit që dje ka përfunduar do të ndajmë edhe 25 specializime të reja për këtë drejtim.

Natyrisht, krahas ndërtimit të kapaciteteve njerëzore, jemi munduar që ta përmirësojmë edhe infrastrukturën. Për këtë qëllim e kemi arritur realizimin e një projekti, i cili e

nënkupton Qendrën Klinike Universitare Emergjente në kryeqytet, projekt ky i cili është në vlerë prej 31 milionë euro, për të cilin është siguruar konstruksioni financiar i tri agjencive zhvillimore ndërkombëtare dhe i cili pres që të inkorporohet në kornizën afatmesme të shpenzimeve, që do të miratohet sivjet dhe të jetë pjesë e buxhetit 2015.

Si zgjidhje transitore, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë së Republikës Turqisë, kemi arritur që ta sigurojmë një donacion, i cili nënkupton themelimin e njësisë së re të Kujdesit Intensiv në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës me 27 shtretër, e cila do të pajiset tërësisht brenda këtij donacioni, dhe e cila brenda këtij programi e nënkupton edhe trajnimin e stafit të nevojshëm në institucionet shëndetësore të Republikës së Turqisë.

Procedurat për zbatimin e këtij projekti veç kanë filluar dhe ne presim që ky projekt të implementohet në muajt prill dhe maj të këtij viti. Me këtë do të gjendet një zgjidhje transitore, derisa të gjendet zgjidhja përfundimtare, e cila nënkupton praktikisht themelimin e Qendrës Klinike Universitare Emergjente në kryeqytet. Përndryshe, në vend nuk janë vetëm 14 shtretër në dispozicion për Kujdesin Intensiv, por janë 64 shtretër në tërësi. Momentalisht vetëm 8 shtretër në Spitalin e Mitrovicës, që është një prej njësive më bashkëkohore në rajon i kemi jashtë funksionit për shkak të trajnimit të stafit, që do të përfundojë brenda disa javësh.

Ndërsa të gjitha spitalet tjera rajonale ofrojnë shërbime në Kujdesin Intensiv deri në një shkallë të kujdesit shëndetësor, që nënkupton mundësinë e ofrimit të shërbimeve cilësore. Ndërsa për shërbimet e nivelit tretësor, atëherë ata udhëzohen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Edhe para dy vjetësh e kam ngrehur të njëjtin problem. Edhe atëherë patët premtuar se do të rregullohet kjo problematikë. Problematika nuk është rregulluar. Pacientët që kanë nevojë për trajtim në Kujdesin Intensiv, duhet të presin derisa dikush aty të vdesë në Kujdesin Intensiv, për ta liruar vendin për të tjerët. Kjo nuk do koment. Mendoj se është dashur t'i kushtohet më shumë rëndësi këtij sektori, në veçanti aty ku në çdo sekondë luftohet për jetë.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Unë thashë se ky projekt i Qendrës Klinike Emergjente Universitare ka qenë gati qysh vitin e kaluar, ka qenë pjesë e diskutimeve për buxhetin 2014. Nuk e ka gjetur mbështetjen e nevojshme politike dhe për këtë arsye ka mbetur i parealizuar.

Në ndërkohë janë zhvilluar kapacitetet në Kujdesin Intensiv në të gjitha spitalet rajonale dhe janë fuqizuar shërbimet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe thashë kjo

zgjidhje, e cila është gjetur dhe për të cilën është dashur të punohet po ashtu një kohë të gjatë, ky donacion që do të na vijë, mendoj se do ta lehtësojë situatën, por definitivisht është nevojë urgjente që ky konstruksion financiar dhe ky projekt investiv, i siguruar nga Ministria e Shëndetësisë, i mbështetur nga këto agjenci zhvillimore të huaja, bordet ekzekutive të tyre kanë marrë vendim që ky projekt të jetë pjesë e kornizës afatmesme të shpenzimeve 2014-2016. Faleminderit!

KRYETARI: Deputet, e ke edhe një pyetje.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Pyetja e dytë, i nderuar ministër, çështja ka të bëjë me atë që tani e disa vite është bërë praktikë që natën e Vitit të Ri zyrtarët më të lartë shtetërorë e komunalë ta vizitojnë Klinikën e Gjinekologjisë në kryeqytet dhe në qytetet tjera të Kosovës për të uruar për lindjet e para në vitin e ri. Kjo vizitë edhe mund të vlerësohet si veprim i qëlluar, sikur ky interesim të ekzistonte edhe për klinikat tjera, në veçanti për Kujdesin Intensiv dhe atë Emergjent, aty ku mjekët luftojnë çdo minutë e çdo sekondë për të shpëtuar jetë.

Pyetja është: Si ministër i Shëndetësisë, a do të ishte mirë që do të sugjeronit këshilltarët zyrtarë, zyrtarët e lartë shtetërorë dhe komunalë dhe edhe vetë të shkoni me ta dhe, përveç vizitës rutine në Gjinekologji, t'i vizitoni edhe emergjencat e spitaleve, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për pasojat e përdorimit të mjeteve piroteknike dhe të shtënat me armë zjarri me rastin e ndërrimit të moteve?

KRYETARI: Ministër, urdhëroni e keni fjalën, edhe pse pyetja duhet të bëhet pak më ndryshe.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti deputet!

Besoj se pajtoheni me mua që këto vizita në natën e Vitit të Ri me siguri se nuk janë momentet kryesore të vetëdijesimit të popullatës ose, në përgjithësi, të institucioneve për rëndësinë e ndalimit të përdorimit të mjeteve piroteknike dhe të të shtënave me armë zjarri. Ky është një proces gjithëpërfshirës, proces që duhet të jetë mirë i menduar, i përgatitur të zgjasë gjatë tërë viti, një proces afatgjatë i vetëdijesimit të popullatës, një punë e organizuar në komunitetin dhe jo çështje e një vizite.

Për këtë nevojiten plane mirë të përgatitura dhe është çështje e cila me të vërtetë meriton vëmendjen e gjithë opinionit, të të gjitha institucioneve të shtetit, sepse në natën e asaj feste e humbëm një qytetare, e humbëm zonjën Shpresa Kastratin në mënyrën më tragjike dhe mendoj se ky nuk është rast i izoluar. E dini mirë se kjo po ndodh nga viti në vit dhe kjo është çështje me të cilën të gjitha institucionet e vendit duhet të preokupohen në maksimum.

Ndërsa konkretisht kur është çështja e vizitës rutinore, siç e thatë edhe ju, simbolike, e pranisë së njërit prej autoriteteve shtetërore ose komunale në lindjen e fëmijës së parë, edhe vetë e vlerësuat se është një veprim i qëlluar. Unë, personalisht, natyrisht se do të ishte shumë e çuditshme që të jem i pranishëm në një ngjarje të tillë simbolike, e të mos jem i pranishëm aty ku ofrohen shërbimet për qytetarët. Unë vetë kam qenë personalisht

në orën e parë pas mesnatës në Qendrën Emergjente dhe kam qenë dëshmitar kur këto shërbime janë ofruar për qytetarë dhe kam qenë dëshmitar dhe personalisht e kam përjetuar dhimbjen e atyre njerëzve dhe të punëtorëve shëndetësorë, të cilët i kanë ofruar këto shërbime.

Mendoj se kjo duhet të jetë praktikë natyrisht e të gjithë zyrtarëve, edhe komunalë, edhe shtetërorë, që e kanë në kompetencën e tyre. Por, prapë po e theksoj se kjo çështje e meriton një vëmendje shumë më të thellë dhe një qasje shumë më të organizuar të institucioneve të vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Pyetje shtesë, deputet?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër!

E thatë edhe ju që keni qenë në Qendrën Emergjente, mirëpo natën e Vitit të Ri jo. Nuk e mbaj mend që doktorët keni qenë aty, mirëpo si do që të jetë do të ishte mirë që së bashku me Presidenten dhe me kryetarët e komunave, që pas urimit për të porsalindurin në natën e Vitit të Ri, sigurisht ndoshta ashtu me medie, do të ishte mirë që edhe Presidentja, por edhe kryetarët e komunave të ofroreshin edhe në hapësirat tjera të Repartit të Gjinekologjisë për t'i parë kushtet higjienike në të cilat punohet.

Në veçanti, pasi po deklaroni që keni qenë edhe vetë në Repartin e Emergjencës, besoj se aty keni mundur ta merrni informatën që CT-ja e atij reparti tani e një vit e gjysmë është jashtë funksioni dhe pacientët detyrohen të shkojnë në Klinikën e Neurologjisë për ta bërë atë, ose nëpër klinika private dhe sikur Presidentja dhe ju ta vizitoni bashkë me kamerat këtë problematikë, besoj se kjo ndoshta do të ndikonte në rregullimin e kësaj problematike dhe do t'u ofroreshin kushte më të mira mjekëve të Repartit të Emergjencës të paktën që të arrijnë t'i diagnostifikojnë problemet, me të cilat vijnë pacientët në Repartin e Emergjencës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar, zoti deputet!

Është mirë që kur bëni paraqitje publike, t'i verifikoni faktet. Kur thotë një ministër i Qeverisë se ka qenë në orën e parë pas mesnatës në Qendrën Emergjente dhe ka biseduar me pacientë dhe me punëtorët shëndetësorë, atëherë mendoj se duhet marrë pak me rezervë çfarëdo formulimi tjetër.

Unë kam qenë në Qendrën Emergjente, natyrisht se nuk i kam marrë mediet me vete dhe t'i bëj publicitet e pompozitet vetes se kam qenë aty, por kam biseduar me pacientë të cilët kanë qenë viktimë të mjeteve piroteknike dhe kam qenë dëshmitar i procedurave diagnostike rreth zonjës Kastrati dhe plumbave në kokën e saj. Kështu që, në këtë aspekt, hiqeni atë merak se nuk e keni ministrin, i cili shkon në Klinikën Gjinekologjike për ta promovuar veten, por unë jam shumë i përkushtuar që qytetarët e vendit ta ndiejnë dorën e pushtetit sa më shumë që të jetë e mundur. Krahas të gjitha vështirësive që i kemi në sektorin e shëndetësisë, këtë do të vazhdojmë ta bëjmë edhe në të ardhmen.

Kur e përmendet çështjen e kapaciteteve diagnostike dhe CT-së në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, po ashtu nuk është e vërtetë se ajo CT nuk punon një vit e gjysmë. Ajo ka pasur dëmtime teknike dhe e di mirë se çfarë problematike është kah e shoqëron mirëmbajtjen e pajisjeve teknike në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, por megjithatë janë duke u bërë përpjekje maksimale që ato të jenë në shërbim të qytetarëve brenda këtij sistemi shëndetësor, i cili unë shpresoj se do të fillojë të ndryshojë në momentin kur ju do ta miratoni Ligjin e sigurimeve shëndetësore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit ministër edhe deputet, edhe pse të sëmuret kanë nevojë për kushte më të mira, e jo për vizita. Vazhdojmë. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Mahir Jagxhilar.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Qeveria e Republikës së Kosovës, më 24.12.2012, e ka nxjerrë Rregulloren numër 33/2, e cila ka të bëjë me shtesat në pagë dhe kompensimet tjera për nëpunësit civilë, ku ndër të tjera në nenin 9 të saj thuhet: Në pajtim me nenin 18 të Ligjit për pagat e nëpunësve civilë për çdo vit pune, në shërbimin civil ose jashtë shërbimit civil, duke i përjashtuar vitet e përvojës në punën praktike, nëpunësit civilë do të marrin një shtesë prej 0,5% të pagës bazë.

Përvoja e punës sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të dëshmohet me dokumente përkatëse, ndërsa në nenin 24 të po kësaj rregulloreje thuhet: Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa neni 9 i kësaj rregulloreje fillon të zbatuari nga data 1 janar 2014.

Pyetja parlamentare është se a ka filluar të implementohet kjo rregullore nga dita e hyrjes në fuqi dhe cilat janë masat që i keni ndërmarrë për implemetimin e kësaj rregulloreje, saktësisht për nenin 9 të saj, pra që ka të bëjë me shtesat në pagë dhe kompensimet tjera për nëpunësit civilë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër Jagxhilar, e ke fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, i nderuari kratar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja Haxhiu,

Duke ju falënderuar për pyetjen tuaj, e cila ka të bëjë me zbatimin e Rregullores për shtesat në pagë dhe kompensimet tjera, më lejoni t'ju njoftoj: Rregullorja për shtesat dhe kompensimet tjera për nëpunësit civilë vërtet ka hyrë në fuqi më 19 dhjetor të vitit 2012. Përjashtim nga kjo, neni 9 i kësaj rregulloreje, bashkë me nenin 24, dhe paragrafi dy është paraparë të fillojë së zbatuari me datën 1 janar të vitit 2014.

Kjo rregullore derivon nga Ligji për pagat e nëpunësve civilë, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2010, ndërsa ligji ende nuk është duke u zbatuar komplet, bashkë me rregulloren. Shkaqet janë të ndryshme. Ende nuk ka përfunduar projekti i përbashkët me Bankën Botërore mbi sistemin e informatave të burimeve njerëzore dhe se të gjitha institucionet e

Republikës së Kosovës nuk kanë arritur ende që të përfundojnë riorganizimin, siç parashihet me Ligjin për Administratën Shtetërore. Gjithashtu nuk kanë përfunduar ende punët sa i përket klasifikimit të vendeve të punës.

Ministria e Administratës Publike disa herë u është drejtuar me shkrim institucioneve që t'i përfundojnë obligimet e tyre në lidhje me zbatimin e tyre ligjeve, përkatësisht të rregulloreve, por një gjë e tillë ende nuk ka përfunduar. Në takimin e fundit që ka pasur grupi i veçantë për reformën e Administratës Publike bashkë me Bashkimin Evropian në Bruksel, e kemi premtuar, faktikisht u dakorduar se riorganizimi dhe klasifikimi i vendeve të punës do të përfundojë më së largu në gjashtëmujorin e parë të këtij viti.

Dëshiroj të nënvizoj se zbatimi i Rregullores për shtesat dhe kompensimet tjera nuk mund të fillojë pa fillimin e zbatimit komplet të Ligjit për pagat e nëpunësve civilë, respektivisht pa përfundimin e klasifikimit të vendeve të punës, i cili klasifikimi e përcakton pagën bazë në shërbimin civil. Në bazë të pagës bazë, do të përcaktohet ose do të shtohet edhe 0,5%-shi. Në këtë aspekt jemi duke e vazhduar punën bashkë me Komisionin dhe Ministrinë e Financave që t'i përfundojmë të gjitha klasifikimet dhe të zbatohen të gjitha nenet ose dispozitat edhe nga Rregullorja për shtesat dhe kompensimet.

Unë dëshiroj të theksoj se kjo Rregullore ka qenë një prej rregulloreve për aprovim më e vështirë, sepse e ka një kosto buxhetore, por gjithashtu ka qenë edhe një debat me Ministrinë e Financave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Zoti Ministër, ky ka qenë edhe premtim elektorale i kryeministrit Thaçi. Pra, ai edhe një herë i mashtroi nëpunësit civilë në këtë rast. Ju e përmendet klasifikimin e vendeve të punës, mirëpo Rregullorja për klasifikimin e vendeve të punës është në fuqi qysh nga 2 marsi 2012. Pra, neni 34 i kësaj rregulloreje thotë se të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës janë të obliguara që ta bëjnë klasifikimin e vendeve të punës pas 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, që do të thotë klasifikimi i vendeve të punës është dashur të kryhet në dhjetor të vitit 2012, ndërsa tani jemi në vitin 2014, e kjo nuk është bërë.

Cilat janë masat që i keni ndërmarrë ndaj institucioneve lokale dhe qendrore për klasifikimin e vendeve të punës dhe pse po i mashtroni nëpunësit civilë, zoti ministër?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Nuk ekzistojnë, duhet të zbatohet, sepse sistemi është kompleks. Ne nuk mund ta zbatojmë një pjesë për një pjesë të institucioneve, ndërsa për një pjesë tjetër të institucioneve tjera të mos e zbatojmë. Nevojitet angazhimi i të gjitha institucioneve. Kërkoj përkrahje edhe nga Kuvendi që t'i realizojmë të gjitha kërkesat sa i

përket edhe ligjit, edhe pagave. Ka qenë çështje buxhetore, është çështje gjithashtu edhe hartimi i të gjitha klasifikimeve, sepse është një fushë e re, janë reformat komplekse, sepse të gjitha vendet e punës duhet t'i përmbledhin në 14 kategori.

Do të thotë të gjithë ata hapa bëhen për pozita me hapat mbi 30, e nuk do të jetë lehtë. Momentalisht kemi ndoshta mbi qindra pozita që t'i akomodojmë përafërsisht në 30, ose 35.

Në anën tjetër, është edhe aspekti teknik, sepse në projektin e Bankës Botërore për modernizimin e sektorit publik është aprovuar marrëveshja edhe në Kuvend. Duhet të përfundohet gjatë muajit shkurt, ndërsa pika konkrete sa i përket 0,5%-shit është fillimi nga 1 janari dhe ne besojmë që një shtyrje prej 6 muajsh nuk do ta dëmtojë procesin sa u përket pagesave shtesë për përvojën e punës.

KRYETARI: Deputeti Agim Kuleta, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi. Nuk dëshiron ta bëjë. Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja, i cili nuk është këtu dhe ka paralajmëruar që nuk mund të jetë. Do ta lexosh pyetjen?

AFRIM KASOLLI: Jo, pasi ka paralajmëruar që nuk mund të jetë, atëherë po e lë për javën tjetër.

KRYETARI: Deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. Ministri nuk është këtu. Deputet, do ta bësh pyetjen?

MUHAMET MUSTAFA: Unë po e bëj pyetjen, edhe pse ministri nuk është këtu, për shkak se çështja është mjaft urgjente dhe shpresoj që deri në mbledhjen e ardhshme edhe do të merren masa dhe do të marrim përgjigje nga ai.

Vitin e kaluar, para nëntë muajve, Kuvendi i Kosovës, me iniciativën e LDK-së, ka debatuar lidhur me situatën në 'Trepçë' dhe midis tjerash ka rekomanduar që brenda një periudhe tremujore Qeveria të përgatisë dhe të sjellë në Kuvend për aprovim një ligj të veçantë për këtë ndërmarrje, që do ta nxirrte atë nga një situatë shumë e rëndë dhe e paqartë.

Ky ligj ende nuk ka ardhur në procedurë, edhe pse afati siç po shihet ka kaluar për më tepër se 6 muaj.

Nga mediet mund të kuptohet se Ministria është duke e përgatitur një ligj, por në vend të ligjit të veçantë po e përgatit një ligj që të bëjë amendamente në Ligjin për ndërmarrjet publike. Në anën tjetër, këto ditë në media dolën informata për një aktivitet paralel të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila si duket do ta angazhojë një kompani, do ta kontraktojnë një kompani të jashtme për ristrukturimin e 'Trepçës', ku madje kanë shprehur interesim rreth 40 kompani të jashtme dhe si duket është para kontraktimit.

Pra, e kemi një aktivitet paralel, një situatë të paqartë, që mund të krijojë pasoja të rënda për iniciativat që ka nisur Kuvendi dhe LDK-ja. Kërkoj nga ministri i Zhvillimit që ta sqarojë këtë situatë, çfarë po përgatit Qeveria, çfarë po bën AKP-ja, cilat janë orientimet dhe çfarë do të ndodhë rreth 'Trepçës'? Kjo është çështje shumë urgjente. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Muhamet Mustafa, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Jo. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Të nderuar deputetë, pyes nëse keni vërejtje ne procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 19 dhe 26 dhjetor 2013.

Të pranishëm fizikë janë 57 deputetë, 100 me prani elektronike. Regjia, bjeri ziles që deputetët të kthehen në sallë.

Kemi menduar se gati një muaj ditë nuk jemi parë, e sot do të jeni më të vullnetshëm për të ndenjur në seancë, por po më duket se ka ndodhur e kundërta.

Tani të pranishëm janë 62 deputetë. Pasi nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 19 dhe 26 dhjetor 2013.

Pika e katërt e rendit të ditës:

4. Debat parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës

Grupi Parlamentar i Lëvizjes "Vetëvendosje" ka kërkuar debat parlamentar lidhur me privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës. Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që ta përgatisë një informatë lidhur me procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë informatë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka dërguar në Kuvend informatën e kërkuar. Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Visar Ymeri ,në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes "Vetëvendosje", në cilësinë e propozuesit të çështjes.

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës! Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Fabrika e Amortizatorëve, si dhe privatizimi i saj, që është udhëhequr nga AKP-ja, janë shënjtuesi më i mirë i së vërtetës për ekonominë e Kosovës.

Fabrika e Amortizatorëve, zhvillimi i saj, potenciali industrial që ajo paraqet, e tregojnë më së miri edhe rëndësinë e industrializimit të vendit, por edhe mundësinë e kapacitetit industrial e prodhues që e ka Kosova. Kjo ishte fabrika e vetme në rajon që prodhonte amortizatorë të llojeve të ndryshme. Në kohën para suprimimit të autonomisë së Kosovës, që u përcoll me masat e dhunshme, përjashtimin e punëtorëve shqiptarë nga puna, fillimin e shkatërrimit të ndërmarrjeve të Kosovës, amortizatorët e Prishtinës ishin prodhim i shumëkërkuar në tregun evropian.

Fabrika e Amortizatorëve prodhonte vetëm për eksport, ndërsa veturat franceze “Peugeot” pajiseshin me amortizatorët nga Prishtina. Si shumë fabrika të tjera të Kosovës që përbënin korpusin industrial të vendit, Fabrika e Amortizatorëve punësonte mbi 900 punëtorë dhe u sillte të ardhura të mëdha familjeve në Kosovë dhe avantazh në bilancin tregtar të vendit, atëherë krahinës autonome. Regjimi i Milosheviqit e ndërpreu këtë.

Pas luftës, punëtorët u kthyen në fabrikë dhe e sanuan atë. Gjatë viteve që kjo fabrikë funksionoi, aty u bënë hapa të rëndësishëm për rimëkëmbjen e saj. Punëtorët arritën në kushte shumë të vështira dhe pa mbështetje minimale nga institucionet publike të Kosovës ta sanonin gjendjen në fabrikë dhe ta fillonin prodhimin. Që në vitin 2001, Agjencia Evropiane për Rindërtim e Radhiti Fabrikën e Amortizatorëve në grupin e pesë ndërmarrjeve me potencialin më të madh në Kosovë për t’u rimëkëmbur dhe i ndau asaj një kredi prej 3 milionë markash gjermane, ose afërsisht 1,5 milion euro.

Po në atë kohë kolektivi i fabrikës arriti të vendosë kontakte edhe me partnerin e dikurshëm “Peugeot”, të cilët shprehën interesim për vazhdimin e bashkëpunimit. Kështu, ndërmarrja në pronësi shoqërore filloi gradualisht t’i bëjë hapat e parë drejt kthimit në potencialin e vet prodhues. Privatizimi nga AKP-ja e ndërpreu këtë.

Fabrika e Amortizatorëve u privatizua në vitin 2010. Ky proces i privatizimit e tregon më së miri se si ka shkuar procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës dhe çfarë dëmsh i ka shkaktuar ky proces potencialit ekonomik të vendit. Ky proces i privatizimit e ndali zhvillimin e ndërmarrjes dhe e ridestinoi atë nga fabrikë prodhuese në objekte dhe tokë. Në të vërtetë, vetë shpallja dhe dokumentet për shitjen e fabrikës që ishin hartuar nga AKP-ja e ndanin së pari Fabrikën në dy pjesë, pra në dy objekte dhe parcela, dhe pastaj në fabrikë i ofronin për shitje vetëm asetet e paluajtshme, por jo edhe ato të luajtshme, e që ishin makineritë, pajisjet tjera që shërbejnë për prodhim, prodhimet e gatshme, gjysmëprodhimet etj., gjithsej 1 000 sosh, që ishin vlerësuar ta kapin vlerën rreth 93 milionë e 600 mijë marka gjermane.

Kjo ndarje fizike e kompanisë dhe shitja formale e objekteve dhe tokës pa makineri e pajisje krijonte kompani pa prodhim, objekte pa punëtorë. Kjo dëshmon se fabrika prodhuese nuk u shkatërrua si rrjedhojë e gabimit gjatë privatizimit, por që privatizimi e kishte këtë shkatërrim të prodhimit si qëllim. Është e njohur në botë kjo mënyrë e shitjes së kompanive me qëllim të shpërbërjes së tyre dhe përfitimit nga kjo shpërbërje. AKM-ja, dhe pastaj AKP-ja, si pasardhëse e saj, i shiti fabrikat e Kosovës për pjesë, pra sikur makinën e vjedhur.

Por, në rastin e Amortizatorëve, kjo u bë edhe në kundërshtim me vetë procedurat, rregullat dhe ligjin që e rregullon këtë çështje. Fabrika është shitur në një proces tenderimi njëburimor, që është në kundërshtim me nenin 15.2 dhe pikën b të këtij neni, i cili e obligon Bordin e AKP-së që ta anulojë procesin e tenderimit, nëse në të nuk janë paraqitur më së paku 3 ofertues. Edhe atë nga ofertues, të cilët ishin nën hetime në kohën kur ofertonin për blerjen e ndërmarrjes. Pronarët e Kompanisë “Devolli” në vitin 2010, kur ofertuan dhe e fituan tenderin e blerjes së Amortizatorëve ishin nën hetime për përfshirjen e tyre në kontratën e “Z-Mobile” të nënshkruar me PTK-në. Më vonë, siç edhe e dini, këta u akuzuan zyrtarisht nga Prokuroria Speciale për këto vepra, për të cilat dyshoheshin.

AKP-ja asnjëherë nuk denjoi që ta bëjë hetimin e historikut të ofertuesve për blerjen e amortizatorëve, gjë që e ka pasur dhe e ka obligim ligjor. Natyrisht që ofertuesit, në këtë rast pronarët e kompanisë “Devolli Group” e kishin nxjerrë nga Gjykata Komunale në Pejë një vendim, në të cilin thuhej se ata nuk ishin nën hetime dhe as nuk ishin të akuzuar për ndonjë gjë, edhe pse në momentin kur këta ofertonin për blerjen e amortizatorëve ishin, pra siç ishte raportuar edhe në media, nën hetime dhe u bastiseshin edhe biznesi dhe shtëpitë për këto hetime. Ky mos-hetim nga AKP-ja është dështim i qëllimshëm nga AKP-ja për ta hetuar si duhet dhe për ta dërguar në vend si duhet procesin e privatizimit sipas rregullave, të cilave vetë ata u nënshtroheshin.

Në këtë proces të privatizimit ka dyshime edhe për kurdisje të tenderit, sepse të dyja këto objekte, të dyja këto ndërmarrje, të cilat janë të krijuara nga Fabrika e Amortizatorëve, janë blerë nga persona të cilët kanë lidhje ndërmjet vetes. Pra, lidhja është që në njërën fitues të tenderit kanë qenë pronarët e kompanisë “Devolli”, pra vëllezërit Devolli, ndërkohë që në anën tjetër kompania që e ka blerë pjesën tjetër të amortizatorëve, kompania “Enex Group” është po ashtu e pronësuar nga të punësuarit në kompaninë “Z-Mobile”, e cila është pra e pronësuar nga vëllezërit Devolli. Kjo lidhje e afërt e tyre zgjon dyshime për kurdisje të këtij tenderi dhe për marrëveshje ndërmjet këtyre dy palëve për ta blerë tërë fabrikën me dy emra të ndryshëm, pra për t’i pasur dy leva të mundshme të blerjes së fabrikës.

Me të blerë fabrikën, siç e keni parë edhe në raportin që e ka dorëzuar Sindikata e Punëtorëve të Fabrikës së Amortizatorëve, edhe pse pasuritë e paluajtshme të kompanisë asnjëherë nuk janë listuar se janë për shitje, aty shihet qartë se këto 1 000 pajisje janë përvetësuar nga blerësi i fabrikës dhe ato menjëherë i janë shitur nga po këta pronarë një biznesmeni turk, me ç’rast, siç thuhet nga Sindikata e Punëtorëve të Amortizatorëve, këta kanë përfituar diku rreth 7 milionë euro nga shitja. Kur e kemi parasysh se fabrika është blerë për 2 milionë e 50 mijë euro, atëherë ky përfitim e tregon qartë atë që e thashë në fillim, pra këtë blerje të kompanisë dhe shitje të saj për pjesë sikur një veturë e vjedhur.

Këto janë disa nga shkeljet që kanë dalë nga procesi i privatizimit dhe të cilat janë të listuara në mënyrë edhe më të detajuar në raportin e dorëzuar nga Sindikata, që u është shpërndarë të gjithë deputetëve, dhe që natyrisht këtu në kohën e kufizuar nuk mund t’i përmend të gjitha ato shkelje, të cilat kanë ndodhur gjatë këtij procesi të privatizimit.

Çështja tjetër për këtë ndërmarrje që është prapë në kundërshtim edhe me logjikën e privatizimit, edhe me rregullat e privatizimit, është ngjashmëria që ky privatizim e ka pastaj me Fabrikën e Tubave, për të cilën do të diskutojmë në pikën e pestë të rendit të ditës, që e kemi në këtë seancë, sepse edhe në këtë rast Gjykata Themelore në Prishtinë (atëherë Gjykata Komunale e Prishtinës) kishte vendosur në favor të punëtorëve për borxhin që ndërmarrja ua kishte punëtorëve në formën e pagave të papaguara gjatë kohës sa këta kishin qenë të përjashtuar fizikisht nga puna, por jo edhe juridikisht të konsideruar si të përjashtuar. Ky borxh arrin diku në nivelin e 20 milionë eurove, që kjo kompani ua ka punëtorëve me vendim të gjykatës, që kurrë nuk e ka parë dritën e përbarimit.

Pra, kurrë nuk është zbatuar, dhe tash e kemi një situatë kur borxhi ekziston edhe juridikisht i pranuar, ndërkohë që paratë nga shitja e ndërmarrjes nuk arrijnë as gjithsej në 7 milionë euro të vlerës për shitjen e dy pjesëve të ndërmarrjes. Borxhi, pra, është diku afro 18 milionë, ose më shumë se 18 milionë euro.

Pra, sikur në rastin e Fabrikave të Tubave, ekziston një borxh ndaj punëtorëve të Kosovës për ndërmarrjen e tyre, e cila u është shitur dhe, në anën tjetër, nuk ka para as AKP-ja, e as Qeveria e Kosovës, para të cilat i kanë përfituar nga shitja e ndërmarrjes, për ta paguar këtë borxh. Pra, në njëfarë mënyre, paratë publike, ose fondi publik i Kosovës është në borxh ndaj këtyre punëtorëve, siç ka qenë dhe siç vazhdon të jetë në borxh edhe ndaj punëtorëve të Fabrikës së Tubave.

Një çështje tjetër që është me rëndësi në këtë proces të privatizimit është edhe përmbushja e kushteve të kontratës të privatizimit me ‘spin off’-it special. Siç e dini Fabrika e Amortizatorëve është shitur me procesin e ‘spin off’-it special, që nënkupton se ka qenë e obliguar nëpërmjet kontratës që për pesë vjet pas blerjes ta vazhdojë afarizmin e njëjtë me atë që e ka pasur.

Ndërkohë që në raportin që na e ka dorëzuar AKP-ja, me gjithë atë që është dashur të raportojë për këtë zbatim të kontratës nga blerësi, asnjë fjalë nuk thuhet për këtë çështje. Pra, raporti i AKP-së ka mundur edhe të mos dorëzohej fare në Kuvend, sepse në të nuk kemi mësuar asgjë të re, përveç se edhe një herë i kanë listuar rregullat, shpalljet, proceset, dhe thirrjet në nenet e ligjeve që e rregullojnë punën e AKP-së, pra të Bordit të AKP-së, por nuk ka asgjë të re për atë se çfarë ka bërë blerësi me ndërmarrjen dhe çfarë numri të punëtorëve ka mbajtur në punë, a e ka dhe në çfarë mënyre e ka vazhduar afarizmin. Pra, përgjithësisht, deri në ç’masë blerësi e ka respektuar kontratën që e ka nënshkruar me AKP-në për ‘spin off’-in special.

Pra, këto nuk figurojnë fare dhe këto AKP-ja nuk na i ka dhënë si përgjigje që është dashur ta japë në kërkesën që i është dorëzuar nga Kuvendi.

Të gjitha këto dhe shumë të tjera, që besoj ju deputetët do të keni shumë për të thënë për këtë proces të privatizimit, e dëshmojmë që ky proces i privatizimit është një proces që, përveç se e ka dëmtuar rëndë interesin ekonomik të Kosovës dhe të punëtorëve të fabrikës, është edhe një proces që e ka shkelur secilën rregull dhe secilin ligj të mundshëm që e mbulon çështjen e privatizimit dhe si i tillë natyrisht që duhet me një

vendim të Kuvendit të suspendohet dhe të hetohet mirëfilli për ta kuptuar saktësisht se çfarë ka ndodhur me këtë proces të privatizimit.

Prandaj, ju kisha ftuar që rekomandimet që i kemi paraqitur t'i votoni në fund të këtij debati. Faleminderit!

KRYETARI: Qeveria nuk është e disponuar për ta marrë fjalën. Tani shkojmë sipas grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

S'do mend që procesi i privatizimit po përcillet me debate të tilla dhe si proces ka ngjallur gjithherë vëmendjen, jo vetëm të opinionit, por edhe të deputetëve, por po ashtu po përcillet edhe me ankesa të ndryshme nga punëtorët e ndërmarrjeve të ndryshme të privatizuara. Këto ditë, ne përveç që kemi pika të rendit të ditës - debate për privatizimin e dy ndërmarrjeve, që kanë qenë jashtëzakonisht të rëndësishme për ekonominë e vendit tonë, po ashtu kemi pasur edhe protesta të punëtorëve që e kontestojnë në një mënyrë apo tjetër privatizimin, ose e kërkojnë të drejtën e tyre, ose kompensimin e tyre.

Partia Demokratike këtë proces e sheh si të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe ne i inkurajojmë të gjithë, edhe deputetët, edhe të tjerët, që në mënyra të ndryshme të kontribuojnë që procesi i privatizimit të shkojë sa më mirë, të përmbyllet sa më mirë dhe t'i kontribuojë sa më mirë gjithë procesit të zhvillimit sa më normal të vendit.

Kërkesa për debat parlamentar s'do mend që mund të jetë një kontribut. Ne si deputetë kemi obligim që të kujdesemi për të drejtën e punëtorëve. Këtu e kemi edhe një letër të Sindikatës së Punëtorëve të Fabrikës së Amortizatorëve, një letër e cila u është dërguar të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Unë nuk e pashë nëse figuron ndonjë informatë që është dërguar në dhomën e posaçme, e cila merret konkretisht me ankesat e punëtorëve dhe e tyre që e kontestojnë procesin e privatizimit dhe e kemi po ashtu një informatë nga Agjencia e Privatizimit si organ përgjegjës për gjithë procesin.

Mendoj që ne duhet, edhe nga ato që u sollën në letër, edhe në fjalën e përfaqësuesve që kanë nxjerrë këtë debat, unë mendoj që duhet t'i ndajmë në dy segmente.

E para, si proces i privatizimit a duhet, a është i kontestueshëm e a duhet ta nxjerrim nga fillimi këtë proces disavjeçar, i cili ka filluar edhe nga institucionet ndërkombëtare dhe së dyti, informacione që nganjëherë ngjajnë në informacione të cilat janë për organe të pavarura të drejtësisë. Edhe këto informacione janë të rëndësishme. Ne duhet të gjitha informacionet që i kemi për shkeljet eventuale në këtë proces t'i deponojmë në institucionet e drejtësisë, në mënyrë që të mos shkelen të drejtat e punëtorëve, pasuria e vendit, e tjerë, dhe në mënyrë abuzive të mos bëhet ndonjë proces dhe për këtë kemi dhe ligjet në fuqi.

Mendoj që rasti në fjalë nuk është i vetëm. Unë dhe deputetë të tjerë kemi kontaktuar këto ditë edhe përfaqësues të "Ballkanit" të Suharekës. Ata njëkohësisht edhe kërkojnë kompensimin e tyre, po ashtu kontestojnë edhe privatizimin. Mendoj që ka rrugë ligjore për kontestimin, ose që të ndiqen nga të gjithë ata që mendojnë se ka pasur ndonjë shkelje.

Mendoj që nuk duhet të bëjmë krahasime të tilla, të cilat janë në imazhin e atyre që kanë punuar, ta zëmë punëtorët e Fabrikës së "Ballkanit" të Suharekës, nuk u ngjan fabrika e tyre si në kohën kur ka shkëlqyer, një kohë kur ka qenë një ekonomi tjetër, ku ata kanë pasur një prodhim të sigurt, e tjerë dhe, po ashtu pritjet e tyre nuk janë të tilla siç mendojnë ata, se do të kishin mundur të punojnë më shumë, më mirë dhe të kishin pasur treg, teknologji më të mirë e tjerë. Por, është një proces i cili ka filluar, është në përputhje me ligjet që i kemi në fuqi dhe nëse diçka e tillë kontestohet, ne duhet t'i nxjerrim, t'u kërkojmë organeve të pavarura.

Në foltore mund të sjellim shembuj të ndryshëm. Ne si komision para dy vjetësh kemi vizituar edhe një fabrikë tjetër, një pjesë të "Trepçës", që prodhon bateritë dhe kemi parë që është një teknologji e re e cila ka prodhuar bateri të cilat asnjëherë nuk janë shitur në treg. Me të filluar lufta janë ndërprerë të gjitha dhe ato bateri edhe po të fillojë tash, nuk ka asnjë përdorues, sepse teknologjitë në mënyrë dramatike kanë ndërruar dhe janë të papërdorshme. Pra, imponohet gjithsesi që procesi i privatizimit t'u hapë rrugë investitorëve të huaj, t'u hapë rrugë investitorëve vendorë, t'u hapë rrugë që këto fabrika sa më shpejt të funksionalizohen.

Për rastin në fjalë, mendoj që ne duhet të kemi kujdes të mos përzihemi në organet që duhet t'i hetojnë rastet. Nëse kemi një rast kontestimor ose për ndonjë shkelje, duhet të kërkojmë nga gjykata e Dhoma e Posaçme dhe institucionet tjera të drejtësisë, të hetimit, të merren me këto. Dhe po ashtu, ne si deputetë të martën kemi një vizitë në Agjencinë e Privatizimit, duhet t'i shtrojmë të gjitha partitë politike, të gjitha pyetjet e mundshme për të gjitha rastet e privatizimit, në mënyrë që të kemi informacione nga dora e parë për këto çështje.

Po ashtu, dëshiroj të theksoj që kemi një ligj i cili është kërkuar, Agjencia e Privatizimit ka kërkuar plotësim-ndryshimin e ligjit. Ju e dini që ka qenë edhe informata publike që Kuvendi i Kosovës e ka zvarritur mosndryshimin e ligjit dhe si pasojë mospagesën e obligimeve të punëtorëve. Ju e dini, që ka kohë që mungon një anëtar ndërkombëtar në bord atje, ku është pengesë për kryerjen e obligimeve të punëtorëve.

Ne si Kuvend duhet të shohim sa më shpejt t'i thërrasim të gjitha institucionet relevante, në mënyrë që ashtu siç e kemi ndryshuar ligjin para një viti, ta bëjmë ndryshimin e ligjit ose të ligjeve edhe këtë vit. Këto ditë në Kuvendin e Kosovës ka ardhur Projektligji për Dhomën e Posaçme, për ndryshim. Unë kërkoj që të gjitha institucionet të shikojnë mundësinë që edhe Ligji për privatizimin në paket të shikohet tash, në mënyrë që të mos bëjmë vetëm ndryshime kozmetike, po është kompetencë jonë që këtë proces ta drejtojmë në mënyrën sa më të mirë, duke i shikuar ligjet sa më mirë, duke shikuar po ashtu edhe zbatimin e ligjeve sa më mirë.

Ne do të jemi të gatshëm të kontribuojmë në çdo rast, në çdo moment në të mirë të zhvillimit sa më të mirë të këtij procesi dhe të hulumtimit, nëse kemi ndonjë shkelje të procesit, ose të drejtave të punëtorëve. Ne jemi deputetë, përfaqësues që kemi kompetencë jo vetëm për të drejtat e punëtorëve, por kemi kompetencë dhe përgjegjësi për krejt procesin dhe po ashtu, për zhvillimin normal të institucioneve dhe për përkujdesjen e pavarësisë së institucioneve të cilat funksionojnë në bazë të ligjit në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Të nderuar kolegë deputetë,
Tema e privatizimeve dhe futja e privatizimit në funksion të ekonomisë në Kosovë është një temë e cila shpesh është diskutuar këtu dhe në forume të ndryshme, sa i përket efektit që po japin këto privatizime në ekonomi dhe gjithmonë ka rezultuar një konkluzion i përbashkët, se pritshmëritë dhe efektet nuk janë në të njëjtën linjë dhe realisht, pasoja që është prodhuar nuk ka qenë në funksion të ekonomisë dhe të interesave të punëtorëve dhe qytetarëve të Kosovës.

Si rezultat i kësaj kemi një gjendje ku ekonomia e Kosovës sot është në një situatë të vështirë dhe institucioni i cili është dashur të merret me formatizimin dhe riformatizimin e kompanive, ndërmarrjeve publike, ndërmarrjeve shoqërore e tjerë nuk ka mundur të japë rezultat. Në këtë rast, Qeveria e Kosovës për ndërmarrjet publike dhe Agjencia për Privatizim e Kosovës për ndërmarrjet shoqërore.

Ne jemi në situatë sot, ku po diskutojmë për një kërkesë konkrete të bërë nga Lëvizja “Vetëvendosje”, për ta shqyrtuar një proces të privatizimit. Si princip, shqyrtimi i procesit të privatizimit në nivele politike është i papranueshëm, mirëpo, realisht jemi në një situatë ku Agjencia për Privatizim si një organ i tejpolitizuar dhe jofunksional ka futur në krizë edhe ndërmarrjet shoqërore, por edhe ekonominë e Kosovës.

Dhe, le të kthehemi te pika kryesore që kemi për diskutim sot këtu dhe funksioni që unë kam marrë sot, që në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, t’i jap vlerësimet lidhur me rekomandimet që kanë dalë nga Lëvizja “Vetëvendosje” dhe qëndrimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Mendoj se rekomandimi i parë, ku kërkohet që të bëhet auditim ligjor dhe financiar nga një subjekt ndërkombëtar është problematik në vetvete, sepse nuk caktohet qartë se kush do ta rekrutojë Agjencinë Ndërkombëtare, kujt do t’i japë llogari kjo agjenci ndërkombëtare dhe kush do ta paguajë këtë agjenci ndërkombëtare?

Pika e dytë, që kërkon që Agjencia Kosovare e Privatizimit të pezullojë kontratën e tenderimit të privatizimit me ‘spin off’ special për ndërmarrjen shoqërore Fabrika e Amortizatorëve, mendoj që është kompetencë e Gjykatës dhe nuk mund të bëhet nga niveli politik, siç është Kuvendi i Kosovës.

Dhe pika e tretë, propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” që Kuvendi i Kosovës të ngre Komision Hetimor Parlamentar, mendoj se seanca nuk mund të ngre Komision Hetimor parlamentar në këtë mënyrë. Mirëpo, parimisht ne jemi dakord që të marrim veprime dhe bashkërisht konkluzionet të riformulohen kështu:

- Të formohet Komision Hetimor Parlamentar për hetimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore Fabrika e Amortizatorëve dhe ndërmarrjes shoqërore Amortizatorët, Ndërtesa Administrative; ndërsa, pika dy të formulohet kështu: “Të auditohet dhe vlerësohet nga Auditori Gjeneral si auditor i autorizuar procesi i privatizimit të ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve, Prishtinë dhe ndërmarrjes shoqërore Amortizatorët, ndërtesa administrative, të gjeturat e auditorit të vihen në funksion të Komisionit Hetimor Parlamentar, para se procesi i hetimit parlamentar të përfundojë”.

Në këtë mënyrë, ne krijojmë lidhjen logjike, formojmë Komision Hetimor parlamentar për të cilat ne si grup parlamentar japim nënshkrimet dhe në të njëjtën kohë bëjmë auditim dhe caktojmë, se kush është auditori i autorizuar në Kosovë për të bërë auditim edhe ligjor edhe financiar, nëse ka nevojë, çfarëdolloj auditimi. Dhe, këto të gjeturat e auditorit vihen në funksion të Komisionit Hetimor. Kështu kemi rrjedhë logjike, kemi edhe qëndrueshmëri në aspektin logjik, logjistik dhe ligjor dhe kemi një pasojë, e cila pastaj mund të prodhohet. Dhe, pasoja që mund të prodhohen janë konkluzionet e auditorit, të cilat i bashkëngjiten raportit të Komisionit Hetimor, i cili vjen në Parlament dhe Parlamenti vendos se çka do të rekomandojë në fund si masë finale.

Ndërsa, mënyra se si është propozuar, mendoj se është e gabueshme, sepse nuk dihet se kush do ta rekrutojë një agjenci ndërkombëtare e cila do të bëjë vlerësimin, kush do ta paguajë, kujt do t’i japë llogari dhe po ashtu, pezullimi i kontratave është kompetencë gjyqësore e jo kompetencë politike. Dhe, në këtë rast mendoj se ky formulim, besoj edhe në mirëkuptim me “Vetëvendosjen” do të përkrahet, ndoshta, munde të ketë ndonjë finesë, që dakordohet më tutje dhe bashkërisht të bëjmë një komision hetimor parlamentar, t’i kërkojmë Auditorit Gjeneral të bëjë auditimin e kompanisë dhe ngjarjeve që kanë ndodhur edhe në aspektin ligjor dhe atë financiar, t’i kemi bashkërisht këto, të nxjerrim konkluzionet, sepse kështu veç po e paragjykojmë paraprakisht.

Mendoj se konkluzionet, rekomandimet që i lexova këtu në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës janë të qëndrueshme dhe besoj që bashkërisht mund të ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, e ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Fillimisht, më duhet të them se është lehtë që të dalim në foltore të Kuvendit dhe të flasim se sa keq ka shkuar privatizimi, kjo është puna më e lehtë. Mund t’ju them se në shumicën e rasteve të ndërmarrjeve shoqërore të privatizuara ka probleme, në shumicën e

rasteve ka ndërhyrje dhe në shumicën e rasteve ne mund të themi, se privatizimi nuk ka shkuar ashtu siç kemi dëshiruar të gjithë që të shkojë.

Përgjigjen kryesore që e kemi marrë në shumicën e rasteve, është se kjo është ekonomi e tregut dhe çmimin e cakton tregu. Në shumë raste asetet që janë gjetur brenda ndërmarrjeve e kanë tejkaluar shumëfish vlerën e shitjes të ndërmarrjes. Nuk është vetëm ky rast, ka edhe raste të tjera, kur ata që e kanë ble, po them kushtimisht, një ndërmarrje, kur kanë hy brenda kanë gjetur pajisje, asete dhe mall që ka tejkaluar vlerën e blerjes. Është e vërtetë, krejt është e vërtetë!

Mirëpo, ne këtu duhet të japim përgjigje. Kuvendi duhet të jep përgjigje, se çfarë ka ndodhur me privatizimin. Mund të diskutojmë, por ne i kemi disa probleme që janë parimore, disa u përmendën më përpara.

Çështja e parë është kjo, pa hyrë në aspekte juridike, nëse Kuvendi ndërton praktikë që e zgjedh një ndërmarrje, shembull ta marrim, një grup parlamentar e zgjedh një ndërmarrje sot, një grup tjetër parlamentar zgjedh një ndërmarrje nesër, një grup tjetër zgjedh një ndërmarrje të tretë një ditë tjetër dhe ne zgjidhim nga një ndërmarrje dhe fillojmë ta hetojmë atë ndërmarrje. Disa probleme na dalin, nëse ne do të lëshohemi në këtë drejtim, problemi i parë është që do t'i frikësojmë njerëzit për të investuar, ose për të blerë, se ende ka ndërmarrje që nuk janë privatizuar, edhe nëse janë të ndershëm, për shkak se një debat parlamentar për një ndërmarrje, tash nuk e kam fjalën për ndërmarrjen në fjalë 'Devolli Company', por një ndërmarrje e sheh veten në televizor duke u hetuar prej Kuvendit, edhe nëse ka qenë e ndershme ndihet keq, ndërsa ndërmarrjet tjera kanë për t'u frikuar se një grup parlamentar, për shembull ta marrim, sot e kemi "Vetëvendosjen", nesër Aleanca, ose Lidhja Demokratike, ose Partia Demokratike, vendos për ta hetuar një privatizim, një rast të privatizimit. Ky është problem më vete, kemi të drejtë ta hetojmë të gjithë procesin e privatizimit, por nëse i ndajmë rastet një nga një, atëherë ne bëjmë gabimin e dytë, që po më sjell te gabimi i dytë, Kuvendi nis të marrë role të gjyqësorit. Dhe, prapë është problem, është problem, thotë një fjalë: "për ata që të vetmin mjet të punës e kanë çekiçin, të gjitha mjetet u duken si gozhda".

Shikoni, ky është organi më i lartë përfaqësues në Kosovë, mirëpo nuk mund të marrë rolin e gjyqësorit, nuk mundet. Te rekomandimet të cilat i kemi marrë para vetes sot, ka elemente të cilat lirisht mund të quhen "aktvendim", jo "rekomandim". Domethënë, ka elemente të cilat janë aktvendime dhe Aleanca nuk është e gatshme të lëshohet në këtë drejtim. Nëse rifrazohen, u dhanë këtu disa propozime, rekomandimet, ne jemi të interesuar që procesi i privatizimit të paktën të fillojë të duket transparent. Por, nuk jemi të gatshëm që të marrim ose t'i mbështesim vendimet të cilat Kuvendin e vendosin në pozitë të marrjes së aktvendimeve, për shkak se janë shumë problematike për ne, pra ne mendojmë se janë problematike.

Çështje tjetër është se ne do të diskutojmë për privatizim sot prapë, është edhe një ndërmarrje tjetër. E dimë çka ka ndodhur aty, e kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, por ne prapë po provojmë ta përdorim këtë mjet të punës që kemi, Kuvendin, për të zgjedhur diçka, që është problematike për t'u zgjidhur. Ne do të flasim edhe për atë

proces. Ka qenë proces brutalisht i gabueshëm, mirëpo, po më duket që jemi duke e përdorë Kuvendin për punë të cilat nuk i takojnë, për shkak se instrumentet tjera të shtetit nuk po punojnë.

Ne po propozojmë që ta përdorim Kuvendin që t'i bëjmë ato instrumente që të punojnë. Unë po e them një fjalë kështu: kam provuar ta shoh gjatë dy ditëve të kaluara të informohem pak për procesin e privatizimit në ish- vendet komuniste dhe kam vërejtur që në shumicën e vendeve ish- komuniste të Ballkanit të paktën, pa përjashtim, pas procesit të privatizimit dikush ka shkuar në burg.

E kam një ndjenjë të fuqishme, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, që Kosova nuk do të bëjë përjashtim në këtë rast. Dikush një ditë, një prokuror ka me qenë më i zoti dhe më trim, do të dalë ai prokuror, edhe ka me qenë një gjykatës më i ndershëm, më i zoti dhe më trim, dikush ka për t'u akuzuar dhe ka për të shkuar në burg, jam i bindur për këtë punë.

Por, nuk është Kuvendi ai që çon njerëz në burg. Do të isha shumë i lumtur që një ditë t'i shoh njerëzit të cilët e kanë vjedhur vendin, me duar të lidhura, jashtëzakonisht shumë i lumtur, por nuk kisha dashur ta shndërrojmë Kuvendin në atë që e bën këtë punë, Kuvendi duhet t'i bëjë instrumentet tjera të shtetit të funksionojnë. Në fund të fundit, më duhet t'ju them se nëse grupet parlamentare arrijnë t'i rifrazojnë rekomandimet në mënyrë që ta kryejmë punën tonë, ta hetojmë të gjithë procesin e privatizimit si proces, nëse është nevoja, krejt materien që e kemi për këtë rast edhe për rastin i cili do të diskutohet në pikën tjetër të rendit të ditës, t'ia përcjellim tubë si dosje Gjykatës, por jo Kuvendit. Ky është problemi jonë. Ne pajtohem që Kuvendi të thotë, po ia përcjellim gjykatës, ajo le ta kryejë punën e vet, Prokuroria le ta kryejë punën e vet.

Edhe njëherë po e përsëris, për ne është jashtëzakonisht e dëmshme. Mund të na duket që në afat të shkurtër po e kryejmë një punë, mund të na duket që në afat të shkurtër ne po u themi atyre punëtorëve: "shikoni, Kuvendi po kujdeset për ju", është krejt në rregull, s'ka lidhje nëse e ka një dozë të popullizmit, në tërë botën bëhet populizëm në Kuvend, ama nëse e fusim Kuvendin në këtë drejtim, atëherë dëmi që e bëjmë në afat të gjatë, është shumë më i madh se sa një efekt pozitiv, çfarëdo qoftë ai efekt pozitiv afatshkurtër.

Këto janë qëndrimet e Aleancës, këto janë mendimet e Aleancës, nuk kam se si të mos e përmend edhe njëherë, se në parim ne jemi për privatizim, nuk jemi kundër privatizimit. Ne mendojmë se kapitali privat duhet të operojë si biznes në Kosovë, jo kapitali publik. Shembuj për këtë ka në tërë botën, Kosova nuk ka nevojë ta shpikë rrotën. Është zbuluar ajo rrotë dhe dihet se ku kanë shkuar vendet që c kanë insistuar të mbajnë sistem të ndërmarrjeve shoqërore. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Përsëritet për deputetët dhe për punëtorët të cilët gjenden këtu.

Çështja e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është një çështje që ndoshta duhet të debatohet në Kuvendin e Kosovës, se Kuvendi është vendi ku duhet të zhvillohen debatet, mirëpo, jo debate në atë formën e prerë, që të merren vendime të cilat nuk i takojnë Kuvendit të Kosovës.

U fol edhe nga parafolësi i cili potencoj çështjet e privatizimit dhe çështjet e vendimeve të cilat duhet të merren në Kuvend të Kosovës, mirëpo në bazë të ligjit të AKP-së.

Në dosjen të cilën e ka sjell Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, në lidhje me debatin parlamentar për çështjen e Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës dhe në një material tjetër të cilin e ka sjellë kryetari i Kuvendit, të bashkëngjitur me informatat lidhur me çështjen e procesit të privatizimit, të cilën e ka dërguar Sindikata e kësaj ndërmarrjeje, mund të themi se në këtë material gjendet çështja, që kjo sindikatë i është drejtuar Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Zyrës së Bashkimit Evropian, ambasadave të vendeve të BE-së, kryeprokurorit të EULEX-it, shoqërisë civile, medieve të Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera.

Ne duhet të mbështesim çështjen e privatizimit në bazë të Ligjit të AKP-së, mirëpo çka ndodh te çështja e privatizimit, si në këtë rast për debatin i cili është kërkuar nga Lëvizja “Vetëvendosje” lidhur me Fabrikën e Amortizatorëve, mund t’ju them shumë hapur se unë kam qenë një fëmijë i cili edhe babai im i ndjerë ka punuar në atë fabrikë, mirëpo ne mund të themi se ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe duhet të jemi në viza-vijë me ligjet që i kemi miratuar në Kuvend të Kosovës. Ne e dimë që kemi pasur probleme në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore jo vetëm në këtë rast që ka qenë privatizim me ‘spin off’ special, por ka edhe raste të tjera të ndërmarrjeve shoqërore, të cilat kanë probleme.

Mirëpo, këto probleme duhet të kërkojnë brenda AKP-së, ndërsa AKP-ja si agjenci e cila i raporton Kuvendit të Kosovës të vjen, ndoshta me rekomandime të cilat duhet t’i drejtohen edhe gjykatave në këtë rast, se Kuvendi është vend ku bëhen ligjet, monitorohen ligjet, po jo vend ku merren vendimet e gjyqësorit.

Më vjen shumë keq të them se këtu janë bërë disa rekomandime dhe më vjen keq prej Sindikatës, e cila gjendet këtu, se ne jemi përpunues të ligjit dhe amendamentues të ligjeve në Kosovë, mirëpo rekomandimet të cilat janë nxjerr, unë mund të them haptazi se ne nuk kemi të drejtë që të kemi kompetenca në gjyqësor, për arsye se Kushtetuta jep shumë qartë si janë të ndara pushtetet në Kosovë.

Në rast se Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” së bashku me grupet tjera parlamentare është që këto rekomandime të riformulohen dhe unë jam pjesë e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, kemi kërkuar që nga AKP-ja të kemi një raport të privatizimit të gjitha ndërmarrjeve shoqërore që kanë ndodhur në Kosovë, se si janë duke u plotësuar këto kontrata, si është duke shkuar çështja e këtij privatizimi, kthimi i mjeteve të punëtorët, atëherë mund të themi se si Kuvend e kemi të drejtën ekskluzive ta thërrasim Agjencinë Kosovare të Privatizimit në një debat me një material shtesë dhe të nxjerrim rekomandime për të gjitha ndërmarrjet shoqërore.

Ne kemi edhe pas kësaj pike edhe një debat për një ndërmarrje tjetër. Ju kisha thënë në mënyrën, ndoshta më të sigurtë se duhet të kemi kujdes me qytetarët tanë, jo të debatojmë sot për një ndërmarrje, nesër për një ndërmarrje.

Ne jemi deputetë që kemi marrë votën nga të gjithë qytetarët e Kosovës, ndoshta edhe nga të gjithë punëtorët e secilës ndërmarrje shoqërore, jemi për çështjen e privatizimit, një privatizim të mirëfilltë, një privatizim transparent dhe një privatizim i cili u sjell qytetarëve të mira, mirëpo jo të bëjmë fushatë me çështjen e ndërmarrjeve të caktuara.

Si Koalicion për Kosovën e Re jam për një privatizim, po për një privatizim të mirëfilltë, mirëpo jo me vendime të gjykatave, se ne nuk jemi gjykatës, ne jemi deputetë dhe dihen kompetencat tona në bazë të Kushtetutës. Dhe, kërkoj që në rast se Lëvizja “Vetëvendosje” mendon që këto rekomandime të përmirësohen nga grupet tjera parlamentare, jam në gjendje t’i përkrahim dhe të kërkojmë raport nga AKP-ja për të gjitha ndërmarrjet shoqërore, të cilat janë privatizuar në Kosovë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e merr kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI: Të nderuar deputetë!

Vërtet nuk është hera e parë që Kuvendi me disa debate që organizon, ndoshta edhe të keqkuptohen si një përzierje në organet përkatëse që duhet të merreshin me lëndët e caktuara.

Por, konsideroj që ne jemi institucion që kemi tri përgjegjësi të njohura mirë. Jemi institucion përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, jemi institucion ligjvënës dhe mbikëqyrës i institucioneve që i zgjedhim dhe i Ekzekutivit. Qytetarët tanë ose një pjesë e qytetarëve tanë duke mos hasur në mirëkuptim në organet përkatëse dhe përgjegjëse për ankesat e tyre, ata na janë drejtuar neve dhe atëherë, ne si Kuvend, çfarë mund të bëjmë?

Ne si Kuvend mund të debatojmë, mund të diskutojmë dhe mund t’ua qajmë hallet atyre, por nëse vërtet institucionet përkatëse nuk i kryejnë obligimet e tyre, e drejta e njerëzve për të pritur diçka më tepër nga përfaqësuesit e zgjedhur të tyre, është krejt normale.

Një gjë mendoj se të gjithë e kemi të qartë, të qartë e ka edhe opinioni, procesi i privatizimit jo vetëm në rastin e Fabrikës së Amortizatorëve, për të cilën po flasim sot, por edhe shumë ndërmarrje të tjera shoqërore dhe publike, është përcjell me vërejtje të shumta.

Tash, sigurisht që edhe ne dhe shumëkush mund të jenë para dilemave, mos me debatin tonë në Kuvend po i frikësojmë investitorët e mundshëm, qoftë të jashtëm, qoftë të brendshëm në Kosovë.

Unë konsideroj që kërkesa e Kuvendit dhe e deputetëve për të debatuar dhe për t'i shfaqur shqetësimet e kërkesat e veta, me privatizimet e bëra kundër bazës ligjore, kundër ligjeve në fuqi, nuk duhet t'i frikësojë investitorët. Investitorët duhet t'i frikësojë fakti se privatizimi është bërë pa ligje, i paligjshëm, prandaj nuk e shoh të arsyeshëm që ky debat që kërkon rregullsi dhe ligjshmëri në procesin e privatizimit, t'i frikësojë investitorët.

Investitorët që kërkojnë sundim të rendit dhe të ligjit, investitorët që i bëjnë njëqind marifete të tjera, sigurisht që kanë dhe nëse funksionon ligji, ata duhet të frikësohen. Duhet të frikësohen për paligjësitë që i kanë kryer në koordinim me ata që ua kanë mundësuar.

Është edhe një fat tjetër, shumë vende të Evropës që kanë kaluar nëpër transicion i janë kthyer rivlerësimit të procesit të privatizimit dhe aty ku ka pasur parregullsi, realisht është krejt normale që të përsëritet procesi i privatizimit nga fillimi.

Ne nuk po diskutojmë për ndërmarrjet që janë privatizuar mbi bazën e ligjit, po ne e kemi një CD, e kemi një material, që ka renditur disa argumente se ky privatizim, si dhe disa privatizimi të tjera, janë bërë në mënyrë të parregullt, të paligjshme dhe si të tilla realisht, Kosovës i duhet ta krijojë një Agjenci, e cila mbikëqyrë procesin e privatizimit. Ai proces që ka shkuar në rregull, ka shkuar në rregull, aty ku shihen qartë parregullsitë, duhet të ketë një vlerësim dhe një kthim në pikën zero.

Kjo lëndë që ne po e diskutojmë sot me kërkesën e Sindikatës së Amortizatorëve, është e qartë se a ka shkuar në organet përkatëse? Por, si duket organet përkatëse, ne nuk e dimë për çfarë arsyeje, por konsideroj që organet përkatëse është dashur ta shqyrtojnë këtë lëndë dhe të japin vlerësimin e tyre, qoftë pozitiv, qoftë negativ.

Edhe punëtorët nuk po kërkojnë gjë, po kërkojnë që sistemi i drejtësisë në Kosovë, duke përfshirë dhe EULEX-in, ta shqyrtojë këtë lëndë, ta shqyrtojë ankesën e punëtorëve, ta shqyrtojë ofertën dhe kontratën e lidhur me këtë rast dhe a ka shkelje apo s'ka shkelje? Nëse ka shkelje, duhet të ketë përgjegjësi, nëse nuk ka shkelje, s'ka nevojë të frikësohet askush.

Por, edhe një gjë tjetër të gjithë e dimë, nga procesi i privatizimit nuk janë arritur efektet e dëshiruara. Kosova nuk ka zhvillim ekonomik, Kosova nuk ka fituar në punësim, vende të punës dhe pasuria ekzistuese sipas materialit gjithnjë që e kemi, shihet se ka kapërcyer edhe rrugë ilegale. Dhe, unë mendoj se këto çështje vërtetë nuk janë për Parlamentin, por askush nuk mund t'ia marrë të drejtën Parlamentit që të kërkojë nga Qeveria, nga institucionet e shtetit ta formojnë një agjenci që e mbikëqyrë ose që e shikon këtë proces. Dhe, edhe njëherë po them, nëse procesi ka qenë në rregull, nuk ka nevojë askush të frikësohet nga debati që po zhvillohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Krasniqi! Fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Siç u tha edhe nga parafolësit tjerë, ne sot po debatojmë për privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve, nismë kjo nga Lëvizja “Vetëvendosje”.

Procesi i privatizimit pas luftës në Kosovë ka qenë një nga segmentet më të rëndësishme të kalimit të ekonomisë në ekonominë e tregut. Dihet tani nga të gjithë se ky proces i filluar me ndihmën e çmuar të ndërkombëtarëve dhe më pas i vazhduar nga institucionet e Kosovës, padyshim që ka qenë tema më e nxehtë e debatit dhe kritikës përgjatë gjithë zhvillimit të saj.

Në këtë kontekst dhe për të evituar perceptimet negative të opinionit publik lidhur me dyshime aferash dhe keqpërdorimesh, siç kam thënë edhe në seancën e dhjetorit të vitit që lamë, është i nevojshëm një konsultim paraprak me të gjithë ju, kolegë deputetë, dhe do të kishte qenë mirë formimi i një komisioni hetimor për të vlerësuar të gjithë procesin e privatizimit, që nga themelimi i AKM-së, por me rëndësi të veçantë do të ishte ai i procesit të privatizimit nga ana e AKP-së, që mendojmë që është degraduar në masë të madhe në të gjitha drejtimet.

Tanimë i gjithë opinionit i gjerë në Kosovë flet dhe dëshiron të dijë, se çka është ndërmarrë deri tani nga ana e Prokurorisë së Shtetit, përcjellja me probleme e transformimit nga AKM-ja në AKP, e përcjell me zhdukjen dhe djegien e dokumentacioneve zyrtare të privatizimit. Qytetarët e Kosovës besojnë se AKP-ja qëllimisht nuk ka pasur një bashkëpunim me Policinë e Kosovës në drejtim të përmbushjes me kohë të kriterit për verifikimin e blerësve të ndërmarrjeve shoqërore.

Kur jemi te kjo çështje, dua të theksoj se në Kosovë flitet se janë blerë dhe privatizuar shumë ndërmarrje shoqërore nga pronarë të cilët kanë pasur ndjekje penale, siç është rasti i blerësit të Fabrikës së Amortizatorëve, apo të atyre paratë e të cilëve e kam thënë edhe në seancën e kaluar, që janë me prejardhje të dyshimta, si ato nga prostitucioni, droga, korrupsioni dhe krimi i organizuar.

Duke pasur parasysh përgjegjësinë time si deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, konsideroj se vetëm një debat i tillë nuk mjafton për AKP-në, kur kemi parasysh përgjegjësinë totale të këtij bordi të drejtorëve dhe këtij menaxhmenti, i cili është i korruptuar dhe i cili ditë e më tepër po e dërmon ekonominë e vendit.

Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i AKP-së duhet të na sqarojë se cilat kanë qenë arsyet e ndryshimit të rregullave të tenderit me rastin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve, kur ofertuesi fitues ka qenë në ndjekje penale dhe i dënua për vepër penale? Është shumë e habitshme se si i njëjti blerës i ndjekur penalisht, shpallet ofertuesi fitues në kundërshtim me rregullat e tenderit, të cilat ndryshohen në ndërkohë nga Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i AKP-së.

Janë të dyshimta shumë nga rastet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, siç janë fabrika e “Ballkanit” të Suharekës, Fabrika e Radiatorëve në Gjilan, “Sharri” në Han të Elezit e të tjerë. Këto shitje të kundërligjshme i vërteton edhe raporti i ZAP-it se i tërë

procesi i privatizimit të këtij gjiganti ekonomik ishte përcjellë me shkelje ligjore serioze dhe në dëm të shtetit të Kosovës.

Shitjet me anë të ‘spin off’-ëve specialë kanë shkaktuar skandale të mëdha, siç është edhe ky i fundit i Grand Hotelit. Nuk dihet se si është bërë rishitja e ndërmarrjes shoqërore e Fabrikës së Duhanit në Gjilan, pa tender dhe pa procedurë transparente e konkurruese. Po ashtu, kemi një prej privatizimeve më kontestuese gjatë vitit 2012, atë të shitjes me negociata dhe pa tender të aseteve të ndërmarrjes Kosova Elektro në qendër të Prishtinës. Kontrata e shitjes ende nuk është finalizuar, vetëm për arsye të hetimeve të cilat janë duke u zhvilluar në këtë rast. Si faktor kyç të këtij procesi, me të cilin është dëmtuar dhe po dëmtohet në vazhdimësi ekonomia e vendit në përgjithësi viteve të fundit, është menaxhmenti aktual.

Dihet haptazi, se të gjitha privatizimet me negociata kanalizohen nga menaxhmenti, i cili në mënyrë të vazhdueshme ka probleme me ligjin e sidomos në aferat korruptive. Përndryshe, i pari i menaxhmentit me mandat pothuajse të skaduar, kishte ndërmarrë veprime antiligjore të njohura tanimë për opinionin. Ata kundërligjshëm ia vazhduan marrëdhënien e punës njëri-tjetrit, apo thënë më saktë, vetvetes në muajin shkurt 2013, duke i nënshkruar njëri-tjetrit kontratat dhe duke bërë në këtë rast tejkalimin e kompetencave dhe falsifikim të dokumenteve për datat që janë vendosur në to dhe për të cilat janë përpiluar dhe nënshkruar në gjysmën e dytë të muajit shkurt e të njëjtëve u figuron data e fillimit të muajit janar.

Lidhur me këtë, një IT pa ndonjë përvojë të madhe, mund të verifikojë dhe vërtetojë një gjë të tillë, ndërsa dihet se për këtë fakt vendos Bordi i Drejtorëve. Përveç përdorimit të detyrës zyrtare, për të cilën dyshohet menaxhmenti i këtij institucioni, kohëve të fundit abuzimi i detyrës zyrtare, pasi marrëdhënia e punës menaxhmentit të AKP-së i kishte skaduar më 26 janar 2013. Me këtë rast, drejtori i njësisë së auditimit në AKP kishte marrë mbi supet e tij edhe dhënien e interpretimeve të dispozitave ligjore, që burojnë nga sfera e legjislacionit, që rregullon marrëdhënien e punës si shpërblim për mungesën e punës, pothuajse gjatë gjithë vitit që i njëjti gjithashtu kandidat, i cili iu ka futur procesit të rekrutimit për këtë pozicion, pra për atë të drejtorit menaxhues.

Se kemi të bëjmë me një mori shkeljesh në këtë institucion dëshmon edhe ajo që AKP deri më tani nuk ka bërë asnjë gjë në drejtim të krijimit të një plani konkret për investimet e fondeve që gjenden në mirëbesim e kur dihet se brenda strukturës organizative të AKP-së ekziston Njësia për menaxhimin e fondeve.

Të nderuar deputetë,

Kemi parasysh se AKP menaxhon fondin e privatizimit në fund të vitit 2013 ka arritur shumë prej 549.4 milionë euro. Agjencia obligohet me ligj për ruajtjen menaxhimin dhe shtimin e vlerës së fondit të privatizimit. Çfarë ka bërë Bordi i Drejtorëve dhe menaxhimi i AKP-së në pikëpamjen e përgatitjeve dhe vetë planit të riorganizimit? Mund të thuhet që nuk është bërë asgjë. Është themeluar Njësia për “Trepçën”, e përbërë nga katër zyrtarë dhe në opinion, po ashtu edhe brenda AKP-së, mbizotëron një bindje e përgjithshme se ky numër është më tepër se simbolik për menaxhimin e këtij procesi.

Siç jeni në dijeni, Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurive të tyre, ligji numër 04/L-035 ka përcaktuar se AKP është administrator i ndërmarrjes shoqërore “Trepça”. Ky ligj ka hyrë në fuqi në muajin shtator të vitit 2011. Sipas ekspertëve, janë disa çështje të cilat kanë rëndësi të madhe në këtë proces, për të cilat AKP-ja është drejtpërdrejt përgjegjëse.

Regjistrimi i aseteve, inventarit të “Trepçës”, domosdoshmërisht duhet të dihet vlera e aseteve si të luajtshme, po ashtu edhe të paluajtshme. Edhe pas katër vjetësh të administrimit nuk është bërë ndonjë regjistrim dhe vlerësim i aseteve të kësaj ndërmarrjeje të AKP-së.

Të nderuar kolegë deputetë, pjesët tjera do t’i dorëzoj për transkriptim. Faleminderit!

Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim

- Vlerësimi i rezervave të xeheve - çdo administrator duhet ta ketë një vlerësim të përafërt të rezervave. AKP-ja, edhe pas 4 vjetëve të administrimit, nuk e ka iniciuar këtë çështje.
- Nuk është bërë angazhimi i ekspertëve për shqyrtimin e kërkesave të kreditorëve dhe pretendimeve pronësore ndaj ndërmarrjes;
- Nuk është bërë angazhimi i ekspertëve, të cilët do të bëjnë vlerësimin e rezervave minerare natyrale;
- Nuk është bërë angazhimi i ekspertëve për vlerësimin e industrive të metalurgjisë dhe metaleve të rënda se sa i suksesshëm apo sa i mundshëm mund të jetë riorganizimi që u përgjigjet interesave të shtetit të Kosovës;
- Nuk është bërë angazhimi i ekspertëve të çështjeve ambientale që do ta trajtojnë historinë e mbetjeve dhe procesi i rehabilitimit të vendeve ku ndodhen minierat dhe mbetjet e procesit teknik dhe teknologjik;
- Nuk është bërë angazhim i duhur në gjetjen e donatorëve eventuale, të cilët i financojnë projektet në fjalë, sepse kostoja e këtyre projekteve është jashtëzakonisht e lartë. Ndërmarrja nuk ka buxhet që mund t’i financojë këto projekte.
- Nuk është bërë involvimi i punëtorëve të ‘Trepçës’ në këto procese si akt i domosdoshëm. Duke marrë parasysh se asgjë nuk është bërë në riorganizimin e ‘Trepçës’ edhe për sa i përket çështjes së involvimit të punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje në këtë proces, AKP-ja është në pikën zero.
- Sipas ligjit të lartpërmendur, çdo kreditor apo grup i kreditorëve të kualifikuar mund të dorëzojë plan alternativ të riorganizimit të ‘Trepçës’. Ky plan alternativ i dorëzohet gjykatës dhe AKP-së. Pra, në rast se AKP-ja nuk përgatit plan serioz të riorganizimit të ‘Trepçës’, ekziston rreziku që kreditorët individualisht apo si grup të paraqesin plane alternative, të cilat patjetër shqyrtohen nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

Duke pasur në konsideratë se AKP-ja deri me tani asgjë nuk ka bërë në drejtim të riorganizimit të ‘Trepçës’, pritjet janë shumë modeste se do të përgatitet një plan serioz i riorganizimit dhe rreziku nga plani alternativ duhet të theksohet.

Menaxhmenti i AKP-së as edhe një herë nuk e ka ndërmarrë një veprim më të vogël për krijimin e platformës për funksionimin e ‘Trepçës’ në të ardhmen si një gjigant i ekonomisë kosovare, sepse në të kundërtën kjo ndërmarrje rrezikon të shkojë në shitje

nëpërmjet procedurës së likuidimit dhe të shkatërrohet ekonomia e qytetit të Mitrovicës dhe një pjesë e ekonomisë së vendit në përgjithësi, pasi vlera minimale e saj llogaritet rreth 5 miliardë euro.

Gjithashtu, AKP-ja deri më tani nuk ka bërë asgjë në drejtim të krijimit të një plani konkret për investimin e fondeve që gjenden në mirëbesim, e kur dihet se brenda strukturës organizative të AKP-së ekzistojnë edhe njësia për menaxhimin e këtyre fondeve, pra kemi të bëjmë me një mori shkeljesh në këtë institucion.

Ndërsa ky bord i AKP-së akoma nuk ka bërë asgjë lidhur me këto fakte:

- 1.) Profesionalizmin dhe përgjegjësinë lidhur me punën (pra, pozitat e larta drejtuese duhet ta kenë edhe profesionin përkatës),
- 2.) Anulimin i procesit të ristrukturimit në përputhje me rekomandimet e KPM-së, në përputhje me rregulloren për klasifikimin e vendeve të punës,
- 3.) Amendamentimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme sa i përket përfaqësimit të zyrtarëve të AKP-së në lëndët gjyqësore që kanë lidhje me AKP-në dhe ndërmarrjet shoqërore,
- 4.) Përshejtimin e punës nga autoriteti i likuidimit në përputhje me shtojcën e Ligjit për AKP-në.
- 5.) Rishikimin e të gjitha shitjeve - privatizimeve me negociata të drejtpërdrejta, sepse kjo është formë joligjore sa i përket shitjes së aseteve të NSH-ve,
- 6.) Riorganizimin i 'Trepçës' në përputhje me ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara,
- 7.) Rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit në administrimin e NSH-ve, nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKP-së,
- 8.) Monitorimin dhe rishikimin e kushteve të vendosura nga AKP-ja për ndërmarrjet nën komercializim dhe privatizim me 'spin off' special,
- 9) Rritja e efikasitetit në zyrat rajonale të AKP-së në identifikimin dhe mbrojtjen e aseteve të NSH-ve etj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Deputetë shumë të respektuar,

Temë diskutimi është debati për procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës. Unë e di që ju po përpiqeni ta lidhni fenomenin përtej kësaj dhe e kuptoj këtë, por meqë temë është kjo, ju lus shumë përqendrohuni në temën.

Nëse duhet të flitet për Agjencinë Kosovare, kurrkush nuk e ndalon Kuvendin të flitet, dhe duhet, ju kisha lutur koncentrohuni në temën që e kemi sot.

Fjalën e merr deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Në fakt, disa edhe u theksuan si përmbajtje dhe si procedurë, se çka do të duhej të bënte Kuvendi në trajtimin e këtyre temave që për mua janë të rëndësishme, por pavarësisht

faktit se si Kuvend dhe si fuqi politike dhe vendimmarrëse ne nuk mund të anashkalojmë edhe preokupimet që janë më të përgjithshme, të përgjithësuara edhe nga ato që u theksuan këtu nga disa kolegë deputetë.

Është më se e qartë se shumica e fabrikave të privatizuara në Kosovë tanimë është bërë evidente që janë shitur me çmime jo të favorshme dhe të cilat nuk kanë ndikuar për të mirë në zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Dhe, kjo është e para që mendoj se edhe Kuvendi përmes legjislacionit, po edhe përmes vendimeve dhe rekomandimeve duhet të merret dhe të trajtohet kjo çështje.

E dyta, mënyra e shitjes së këtyre fabrikave, çdo ditë e më shumë po lë vend për dyshime, afëra korruptive, klanore dhe të mbështetura nga njerëz të politikës. Çmimet e manipuluar me tenderë, favorizimi, janë pjesë e këtyre privatizimeve. Ndërmarrjet shoqërore dhe diçka që po lihet në periferi dhe që lidhet shumë me këto fabrika ka të bëjë edhe me tokat bujqësore apo pronat që ndërlidhen me to.

Unë mendoj se ne duhet t'i qasemi edhe këtij problemi. Çka ka ndodhur me tokën bujqësore në Kosovë, kush janë ata që i kanë privatizuar këto pronë, për çka janë të ridestinuara tani, a janë deputetë të Kuvendit të Kosovës, a janë ministra, a kanë funksione publike?

Të gjitha këto pyetja janë tema që përfliten çdo ditë në media dhe ka edhe dëshmi publike nga njerëz dhe Prokuroria nuk e bën as hapin më të vogël që t'i trajtojë në mënyrë shumë serioze. Prandaj, pa anashkaluar faktin se temat e ngritura, siç ka të bëjë me Fabrikën e Amortizatorëve apo edhe "Ballkani", i cili pritet shumë shpejt të diskutohet dhe shumë të tjera, pa dashur për të interferuar në tregtinë e lirë, pa dashur që të kemi qasje negative ndaj investitorëve seriozë. Unë mendoj se këto nuk duhet të anashkalojnë.

Njerëzit e politikës, duke filluar këtu nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, që i kanë futur duart në privatizim, që janë pronarë të tokave dhe fabrikave dhe që janë pjesë e këtyre manipulimeve, Prokuroria dhe publiku duhet t'ua thotë dhe nëse është keqpërdorur, nëse ka afëra korruptive, ta marrin dënimin e merituar. Nuk mund kurrkush të fshihet as pas subjektit politik, nuk mund kurrkush të fshihet as pas ngritjes së interpelancave, nëse në subjektet e caktuara ka njerëz që janë pjesë e këtyre aferave korruptive, janë pjesë e keqpërdorimit të pronës shoqërore, e ndërmarrjes shoqërore e pronës publike.

Andaj, Kuvendi duhet ta ketë guximin ta thotë, por ajo që duhet të merr masa është Prokuroria e Shtetit, janë gjykatat të cilat fatkeqësisht këto gjëra i kalojnë vetëm në periferi dhe këto pasoja do të jenë afatgjata për vendin dhe për qytetarët e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka deputeti Albin Kurti, kryetar i "Vetëvendosjes".

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ne jemi të interesuar që të zhvillojmë debate parlamentare për privatizimin e të gjitha fabrikave në Kosovë.

Fakti që në këtë vit kemi filluar me Fabrikën e Amortizatorëve nuk duhet të interpretohet se çdo privatizim tjetër është më pak i rëndësishëm se ky, se ta zëmë privatizimi i ‘Ferronikelit’ paska peshë më të vogël. Sigurisht që jo! Mbase filluam me amortizatorët, sepse amortizatorët fillojnë me shkronjën “A”. Kaq!

Por, e kemi ndërmend dhe e konsiderojmë të drejtë dhe të duhur që të merremi me privatizimin e të gjitha fabrikave, privatizim ky i kryer nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, e më herët nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit. Më vjen mirë që gjuha e punëtorëve që na e dërguan materialin ka nisur t’i përdorë shprehjet e duhura. Si për shembull “kriminalitet i jakave të bardha” dhe “kapje e shtetit”, se me të vërtetë është kështu. Bëhet fjalë për kriminalitet të “jakave të bardha” dhe bëhet fjalë për “kapje të shtetit” dhe kur punëtorët ankohen se është kapur shteti, t’u thuash ‘shkoni te gjykatat’ është në rastin më të mirë cinizëm.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, jo vetëm që e ka lejuar privatizimin, por ajo e ka nxitur, organizuar dhe ekzekutuar atë. Kriminaliteti i “jakave të bardha” nis me AKP-në, por nuk përfundon me të. Sigurisht që kur po bëhen privatizimet në Kosovë përgjithësisht nuk po përfillen rregullat, mirëpo para se ta arrijnë këto e kemi vetë privatizimin që është ilegal, meqenëse as sot e kësaj dite nuk kemi Ligj mbi privatizimin. Prandaj, me të drejtë është më e drejtë është që privatizimi të quhet “shitje” se sa “privatizim”.

Mirëpo, edhe shitja e këtillë që nuk është privatizim, kur i kemi parasysh çmimet e shitjes, na del që është falje dhe jo shitje.

Ndërkaq, kur i shohim asetet e shitura del që nuk është as falje, por dhënie e mënyrës, që populli ynë e quan “më lirë se badihava”. Njëra pjesë e ndërmarrjes së ndarë në dysh nga AKP-ja u dha për 2 milionë euro, e pjesa tjetër për 5 milionë euro, ndërkohë që Sindikata e Punëtorëve i referohet një raporti, sipas të cilit vetëm vlera e 1 mijë aseteve të luajtshme, të cilat fare nuk janë regjistruar, kap shumën prej 93 milionë markash gjermane.

Në këto të paregjistruarat bëjnë pjesë makineri dhe pajisje të tjera që shërbejnë në procesin e prodhimit, prodhime të gatshme dhe gjysmë prodhime, si dhe pasuri të tundshme. Nga pikëpamja e këtij privatizimi të AKP-së me rastin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve, pasuria e luajtshme nuk është pasuri, sepse thjesht ajo që lëviz nuk është. Vetëm ajo që nuk lëviz është. Privatizimi i këtillë është nihilist ndaj prodhimit, sepse ua mohon edhe vetë ekzistencën makinerive prodhuese.

Pra, së pari nuk kemi privatizim, por kemi shitje. Së dyti, nuk kemi as shitje, por kemi falje dhe, së treti, nuk kemi as falje, por dhënie më lirë se badihava.

Nga mënyra e AKP-së që pas pavarësisë e vazhdoi atë të AKM-së nuk është përjashtuar e nuk është kursyer as Fabrika e Amortizatorëve. Tjetërsimi i këtillë i ndërmarrjes, ku çmimi i shitjes nuk krahasohet me atë të aseteve, pra të pasurive që përmban ndërmarrja, nuk mund të bëhet pa një zhvlerësim paraprak. Akti kryesor i zhvlerësimit është ndarja e ndërmarrjes, ndarja e ndërtesës administrative prej fabrikës. Pra, ndërmarrja si trup ekonomik së pari copëtohet dhe mandej i shiten gjymtyrët pors i një kufome.

Kjo që u quajt “privatizim” e nënkupton vrasjen paraprake të ndërmarrjes, e cila nga një jetë ekonomike shndërrohet në trup të vdekur e të ndarë sipas gjymtyrëve. Dikush mund të thotë që fabrika është shitur pjesë-pjesë si një automobil, mirëpo këtu ka një gjë që nuk duhet ta harrojmë dhe një keqinterpretim që e zhbën këtë analogji. Së pari, njëmend një automobil mund të shitet pjesë-pjesë, por jo që të bëhet sërish automobil, por që t’u shërbejë automjeteve të tjera dhe, së dyti, fabrika nuk mund të krahasohet me automobilin meqenëse fabrika e prodhon automobilin e nuk është vetë automobil.

Automobili është mall, fabrika prodhon mallra. Kjo do të thotë që AKP-ja dhe kjo Qeveri fabrikat i ka konsideruar gabimisht dhe unë besoj me dashakeqësi si mallra. Prandaj, këto privatizime të AKP-së nuk mund ta dinamizojnë ekonominë tonë, sepse ato, në vend se ta shndërrojnë pronën në kapital, në fakt e shndërrojnë kapitalin në pronë.

Kjo dhënie më lirë se badihava ngjan për tri arsye kryesore.

E para, pasuria e Kosovës konsiderohet më shumë si barrë se sa si shans. E dyta, ndërmarrjet prezantohen si aset që mund t’i ndërrohet destinimi, e jo si kapacitet zhvillimor apo organizatë e punëtorëve. Dhe, e treta, privatizimi nuk është pjesë e ndonjë vizioni më të gjerë e më afatgjatë zhvillimor, por privatizimi është principi i instaluar në formën e një të vërtete universale. Privatizimi i këtillë është bindje ideologjike.

Pra, ata që po privatizojnë janë ideologjikë në ndërmarrjen e tyre të eliminimit të ndërmarrjeve shoqërore-publike, e jo ne që po e kundërshtojmë këtë privatizim, të cilit nuk po ia shohim as drejtësinë, e as dobinë.

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ky material voluminoz që na e kanë sjellë ne deputetëve punëtorët e Fabrikës së Amortizatorëve është i njëjti material që ju e keni nëpër CD-të, të cilat gjithashtu u janë shpërndarë dhe ky material është krejt çka i nevojitet Prokurorisë. Në vendet e zhvilluara demokratike perëndimore, prokuroritë hetojnë e hulumtojnë gjerë e gjatë e shumë thellë, në mënyrë që ta ndërtojnë rastin e tyre. Prokuroritë në Kosovë nuk kanë nevojë as të hetojnë, as të hulumtojnë. Ja ku e kanë materialin! Thjesht nga zyra e tyre do të mund ta kryejnë krejt punën, por ja që nuk e bëjnë një gjë të tillë, sepse thjesht, edhe Prokuroria, edhe Gjyqësia jonë, si ajo vendore, po ashtu edhe ndërkombëtare, nuk udhëhiqet nga logjika e drejtësisë për qytetarët dhe të drejtat e qytetarëve, por nga ajo e menaxhimit të krizës dhe stabilitetit afatshkurtër politik.

Nga këto tre vjet sa jam në Kuvendin e Republikës së Kosovës është përshtypja ime e fuqishme që deputetët e Kuvendit kur nuk duan të merren me një padrejtësi, ose le të

themi kur nuk janë mjaftueshëm të zemëruar me një padrejtësi, ose kur nuk e përfaqësojnë sinqerisht interesin publik, thonë se kjo gjë u përket gjykatave. Ndërkohë, që të gjithë e dinë që gjykatat përgjithësisht po merren me drejtësinë. Sindikata e Punëtorëve këtu tregon qysh as gjykata, as Prokuroria, as Qeveria, as faktorët ndërkombëtarë nuk po e kryejnë detyrën e tyre dhe shpresa e fundit e kësaj sindikate është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Prandaj, edhe këtu e kemi nisur këtë debat. Ndërkaq, të gjithë ata që u thonë tash punëtorëve “shkoni në gjykata”, po e harrojnë një gjë, ose s’po duan ta kuptojnë një gjë, se në atë stacion tashmë kanë qenë punëtorët, e kanë kaluar atë stacion. Ata kanë ardhur te Kuvendi, sepse institucionet kompetente s’po funksionojnë dhe Kuvendi është organi më i lartë në Republikën tonë parlamentare.

Prandaj, është më shumë se legjitime që ne të merremi me këtë çështje dhe le të mos harrojmë që e kemi edhe situatën tjetër me pasojën e njëjtë. Merr vendim gjykata, por nuk zbatohet! Nganjëherë s’merr vendim e nuk vepron, e nganjëherë merr vendim të duhur, por ja që nuk zbatohet ai, dhe sërish punëtorët s’kanë se ku të shkojnë tjetër kund, përveçse në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Për shembull, shikoni pikën 36 në material, në faqe 11, ku tregohet shumë mirë qysh punëtorët paditës të ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, në gjykatën kompetente kanë paraqitur padi për kompensime të të drejtave të punës nga suspendimi i tyre, nga përjashtimi nga puna, që e kanë përjetuar pas suprimimit të autonomisë së Kosovës, në mars të vitit 1989, dhe Gjykata Komunale në Prishtinë, në aktgjykimin e datës 17 nëntor 2010 e ka aprovuar kërkesën e punëtorëve paditës në shumën totale të kërkesave të tyre prej mbi 18 milionë euro.

Më pas, kishim edhe dy procedura të tjera nga marrëdhënia e punës. Përlllogaritur bashkë detyrimet e ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve dhe AKP-së ndaj punëtorëve arrin shumën mbi 22 milionë euro. Mirëpo, e dini çka? Krejt kjo është shitur për 7 milionë! Tash punëtorëve ua kanë borxh 22 milionë. Ku të merren 15 milionë euro?

Dhe, ku të vijnë këta punëtorë për këtë diskrepancë prej 15 milionë eurove? Po sërish në Kuvendin e Kosovës. Ku tjetër?! Dhe, nëse ne themi që Gjyqësori duhet të jetë i pavarur, ai nuk duhet të jetë i palidhur nga Kuvendi e nga Qeveria, sepse mos harroni - gjykatësit kanë dhënë betim te Presidentja, e cila është presidente e një republike parlamentare, që është zgjedhur këtu.

Gjërat janë të lidhura dhe gjykata është e pavarur nga Ekzekutivi, mirëpo mos harroni që ajo nuk është e pavarur nga shteti. E këtu sot po flasim për shtetin, çfarë shteti duam. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti! Fjalën e ka deputeti Ramiz Kelmendi.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryesues!
Kolegë deputetë,

Privatizimi i kësaj ndërmarrjeje shoqërore është bërë në vitin 2010, kurse procesi i privatizimit ka filluar në vitin 2004, ndërsa procesi i shkatërrimit dhe i rrënimit të industrisë së Kosovës ka filluar në vitin 1989 dhe deri në vitin 1999, në mungesë të punëtorëve shqiptarë, fabrikat janë amortizuar dhe janë demoduar.

Në këtë fabrikë e kemi një industri të vjetruar, e cila ka prodhuar amortizatorë për automjete, të cilat sot nuk janë në treg. Tregu ka humbur nga kjo kompani për 20 vjet me radhë dhe besueshmëria e ndërmarrjeve në shtetet me kapitalizëm në ndërmarrjet shoqërore që kanë rrjedhur nga një shtet socialist. Pra, shumë biznese të shteteve të Evropës dhe të tjera të botës nuk kanë pasur besueshmëri në blerjen e këtyre produkteve për arsye se s'është ditur titullari dhe pronari e përgjegjësia ka qenë e askujt.

Me këtë tregohet se edhe bankat vendore nuk kanë shprehur dhe nuk kanë financuar në asnjë moment ndërmarrjet shoqërore, duke mos e ditur titullarin, sepse kanë qenë pa titullar.

Në shumicën e vendeve, këto objekte janë shitur edhe me një euro, në mënyrë që ai ta aktivizojë dhe ta fillojë procesin e prodhimit.

Të nderuar deputetë,

Është keq kur luhet me ndjenjat e punëtorëve, të cilët e kanë gjendjen e papunësisë, duke vajtuar për kohën e kaluar komuniste si një paravan i punësimit masiv. Ne edhe sot kemi shumë shembuj të privatizimit apo privatizimit të pranuar, siç është Fabrika e Elektromotorit dhe ju mund të kaloni pranë asaj fabrike dhe ta shini që është bërë si fantazmë. Shumë fabrika në Kosovë e kanë ndryshuar destinacionin dhe janë shitur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe janë paguar para, të cilat qëndrojnë sot jashtë dhe financohen kompanitë e ndryshme, apo bizneset jashtë Kosovës.

Është shumë për të ardhur keq, të nderuar deputetë, ne edhe sot e kemi gjendjen në legjislacionin jo të duhur dhe jo të mjaftueshme që t'i zhvillojmë bizneset vendore e t'i thithim biznese ndërkombëtare, prandaj ne duhet të punojmë maksimalisht që ta ndryshojmë edhe legjislacionin ekzistues në funksion të zhvillimit ekonomik.

Me këtë, të nderuar deputetë, qëndroj në atë që po qe se ka pasur devijim nga procesi ligjor i privatizimit, që kjo të bëhet jo në mënyrë parciale, por të përfshihen të gjitha dyshimet që ndodhin dhe të jetë gjithëpërfshirëse, e të mos jetë vetëm individuale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zotërinj deputetë, ju njoftoj që do t'i thërras me rend. Janë deputetë të “Vetëvendosjes”, Afrim Hoti, Albulena Haxhiu, Albana Gashi, Rexhep Selimi, Afrim Kasolli, tani u shfaq edhe një emër, nga KKR - Jeton Svirca. Afrim Hoti e ka fjalën. Po merrini kartelat, mos flitni me emër të huaj! Faton Topalli, besoj që s'e ka ende kartelën. Urdhëro!

FATON TOPALLI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Ministrat sot s'paskemi rast t'i përshëndetim, sepse si duket nuk janë zgjuar nga gjumi i ariut.

Mendoj që Kuvendi është pikërisht organi, pikërisht vendi ku duhet të diskutohen problemet, ku duhet të diskutohen çështjet atëherë kur Qeveria nuk punon, atëherë kur institucionet tona dështojnë prej Prokurorisë, e kështu me radhë.

Procesi i privatizimit të ndërmarrjes shoqërore "Amortizatorët" në Prishtinë, pra nuk po flas për faktin se duhej apo nuk duhej të privatizohej kjo fabrikë, së paku sipas të dhënave që ne i posedojmë duket të jetë një vepër kriminale e planifikuar, e organizuar mirë dhe me hollësi me të gjitha siguresat e mundshme që rezultati përfundimtar të jetë vetëm ai që është planifikuar. Pra, që Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, me 25 arë objekte të ndërtuara, me 13,5 hektarë tokë në pjesën më të mirë të Zonës Industriale të Prishtinës dhe makineritë dhe mall brenda saj në vlerë prej 46 milionë euro t'i falet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit korporatës "Devolli" për një çmim prej 0,0 euro.

E gjithë kjo në kurriz të 900 punëtorëve të kësaj fabrike, në kurriz të buxhetit të Kosovës dhe në dëm të ekonomisë së brishtë të vendit tonë.

Në fakt, fabrika u dha për 7,17 milionë euro si tërësi, por kishte brenda saj mall dhe makineri në vlerë prej 46 milionë euro. Kjo korporatë ua shiti asetet e luajtshme të fabrikës që nuk ishin pjesë e tenderit një biznesmeni turk dhe disa të tjerëve për 7 milionë euro, duke fituar sa çel e mbyll sytë 13,5 hektarë tokë në zonën më të mirë industriale të Prishtinës me një çmim prej 0 eurosh.

Është pra ky një fitim marramendës, i cili i kalon përmasat natyrale të parafytyrimit të përfitimit që mund ta kenë shumica e qytetarëve të Kosovës.

Ajo që dihet është dhe që është dokumentuar është fakti se Fabrika e Amortizatorëve u privatizua në kundërshtim me Ligjin për privatizim. Dihet gjithashtu që përfitues legalë të tenderit të Fabrikës së Amortizatorëve janë korporata "Devolli" dhe ndërmarrja NPT "Euronext", që në instancën e fundit edhe kjo e dyta duhet t'u takojë vëllezërve "Devolli".

Po ashtu, është e njohur si pjesë e kësaj vepre kriminale u bën zyrtarët e AKP-së, të Gjykatës Komunale në Pejë dhe të Ministrisë të Punëve të Brendshme në Prishtinë. Në fakt, çfarë ndodhi? Në kundërshtim me rregullat e tenderit, korporata e fshehu faktin se ishte shumëfish e përfshirë në hetime. Para AKP-së dorëzoi dokumente të falsifikuara të Gjykatës Komunale në Pejë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme që fshihnin këto fakte. Ajo bashkëpunoi për tenderin me ndërmarrjen NPT "Euronext", që në instancë të fundit u takon gjithashtu vëllezërve Devolli.

Të gjitha këto janë elemente, të cilat në pajtim me ligjin do t'i pamundësonin kësaj ndërmarrjeje pjesëmarrjen në tender, respektivisht tenderi do të duhej të anulohet. Zyra e Agjencisë Kosovare e Privatizimit u përfshi në këtë akt kriminal, duke u bërë pjesë e

planifikimit të krimit dhe duke vepruar në kundërshtim me rregullat që kishte paraqitur vetë.

Ata e ndanë Fabrikën e Amortizatorëve në dy ndërmarrje të reja në mënyrë fiktive duke pamundësuar që një blerës serioz të mund të blinte një pjesë të ndërmarrjes pa pasur implikime serioze në ndërmarrjen tjetër.

Për korporatën “Devolli” kjo nuk paraqiste ndonjë problem, sepse fituesi efektiv i tenderit do të ishte korporata “Devolli” dhe askush tjetër. AKP-ja, edhe pse dinte nga mediat që ndaj pronarëve të korporatës “Devolli” po bëheshin hetime, qëllimisht nuk u angazhua për të hetuar nëse kjo ishte vërtetë apo jo. AKP-ja e shpalli tenderin për dy ndërmarrje, por nuk e futi në tender pasurinë e paluajtshme në vlerë prej 46 milionë eurosh, edhe pse në të njëjtin rund të privatizimit e kishte futur në një ndërmarrje tjetër pasurinë e luajtshme.

Me fjalë të tjera, ajo e tha “ne e shesim një qyp të ndarë në dy pjesë, kush do ta blejë”, por ajo nuk saktësoi se pasuria e vërtetë nuk ishte vetë qypi, por pasuria e luajtshme prej 46 milionë eurosh brenda tij. AKP-ja i shkeli rregullat e tenderit duke shitur Fabrikën e Amortizatorëve tani të ndarë në dy ndërmarrje, edhe pse nuk ishin paraqitur tre ofertues. Sipas ligjit, tenderi do të duhej të anulohet. AKP-ja e shkeli ligjin duke shitur dy ndërmarrje, të cilat nuk ekzistonin. Ato u regjistruan në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë më 3 dhjetor 2010, pra vetëm pas privatizimit tyre. Pra, u privatizua diçka që nuk ekzistonte.

Mosregjistrimi i dy ndërmarrjeve të shitura nuk ishte rastësi. Ishte thjesht siguresë për rastin nëse plani nuk do të shkonte ashtu siç ishte paramenduar, nëse do të paraqiteshin edhe tenderues të tjerë, nëse çmimi i konkurrimit të tjerëve do të ishte më i lartë, në këtë rast AKP-ja do të thoshte “më falni, ne e kemi një gabim hapash, një gabim administrativ dhe tenderi duhet të anulohet”. Meqë plani funksionoi, tenderi nuk u anulua.

Ndërmarrja e re Fabrika e Amortizatorëve u shit me ‘spin off’ special. Përfituesit e tenderit nuk iu përmbajtën kontratës për ta ruajtur destinacionin e fabrikës për pesë vjetët e ardhshme. AKP-ja heshti, e shkeli ligjin, sepse nuk kërkoi anulimin e tenderit. Zyrtarët e Gjykatës Komunale në Pejë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme u bënë pjesë e veprës kriminale, duke lëshuar dokumente të rrejshme, respektivisht duke fshehur informacionet se ndaj korporatës “Devolli” po zhvilloheshin hetime për vepra në disa raste.

Ajo që nuk dihet dhe duhet të hetohet nga organet e hetuesisë është pyetja se a janë vetëm vëllezërit Devolli të përfshirë në këtë mënyrë të privatizimit, apo ka qeveritarë që qëndrojnë pas kësaj vepre penale dhe kanë përfituar prej saj? Ka dyshime të bazuara se pas kësaj vjedhjeje masive qëndrojnë edhe eksponentë të partisë në pushtet. Nuk dihet gjithashtu cilët zyrtarë të AKP-së përfituan dhe sa përfituan nga organizimi i privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Prishtinë.

Po ashtu, nuk dihet se cila është pjesa e fitimit e zyrtarëve të Gjykatës Komunale në Prishtinë, në Pejë, dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme. Rasti i privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Prishtinë, bashkëpunimi ndërmjet krimit brenda dhe jashtë institucioneve duket të jetë vetëm maja e Ajsbergut, pra vetëm maja e akullnajës në gjithë procesin e privatizimit në Kosovë.

Ju deputetë të nderuar dhe qytetarë të Kosovës,
Në shembullin e Fabrikës së Amortizatorëve mund ta merrni me mend se sa i madh është dëmi që AKP-ja i ka shkaktuar ekonomisë dhe qytetarëve të Kosovës.

Sot deputetët e Parlamentit të Kosovës e kanë rastin dhe mundësinë të krijojnë kushte për t'u dhënë përgjigje në shumë pyetje të hapura, por edhe për t'ia kthyer Kosovës dhe punonjësve të Fabrikës së Amortizatorëve një pasuri që iu mor padrejtësisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: I nderuar nënkryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Më lejoni që edhe unë të kyçem pak në këtë debat dhe t'i them disa fjalë.

Është e vërtetë që privatizimi po shikohet nga këndvështrime të ndryshme, po debatohet shumë dhe kjo është mirë, sepse qartësohen pozicionet dhe ka mundësi të ketë harmonizim të qëndrimeve.

Unë si deputetë e përkrah çdo nismë të Kuvendit, e cila kërkon rend, ligj dhe rregull. Kërkesat e tilla, siç është kjo e sotme, nuk duhet të bëhen vetëm për një privatizim, për një ndërmarrje të privatizuar, por duhet të bëhen për çdo ndërmarrje të privatizuar, në të cilën ka dyshime. Është paraqitur dyshimi se në procesin e privatizimit të kësaj ndërmarrjeje ka pasur dyshime për shkelje të ligjit dhe veprime të tjera të ndaluara, atëherë unë si deputetë përkrah që pika e parë e përcaktuar pra në rekomandime të shkojë, sepse po kërkohet një auditim ligjor dhe financiar për t'i hequr dyshimet dhe nëse ka të gjetura, atëherë duhet edhe të veprohet.

Në tërësi i përkrah të gjitha rekomandimet. Unë besoj dhe mendoj se Kuvendi e ka rolin e tij të fuqishëm, i cili ka mundësi ta mbikëqyrë çdo proces i cili ndodh në Kosovë, e sidomos në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Unë mendoj se me këtë nuk frikësohen investitorët, por mendoj se serioziteti ynë në këto veprime do t'i inkurajojë investitorët, sepse tregohet që shteti i Kosovës është një shtet serioz, i cili punon për rend, rregull dhe ligj. Ne nuk po bëjmë asgjë më shumë, veçse po thërrasim në drejtësi dhe po i mbrojmë interesat e shtetit dhe të qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: Faleminderit, i nderuar kryesues!
Të nderuar kolegë deputetë,

Ma merr mendja që temën për të cilën po diskutojmë sot është një pikë e vogël nga ajo që ky Parlament ka qenë dashur të bisedojë ose ta hapë qysh në fillimin e mandatit të tij.

Fatkeqësisht, po flasim për një proces, i cili nuk ka ndodhur sot, s'ka ndodhur dje, por është një proces me të cilin vazhdimisht shoqëria kosovare, vetë ne jemi ballafaquar me reagimet e ndryshme të grupeve të interesit, të njerëzve të cilët e njohin mirë ekonominë e këtij vendi dhe, fatkeqësisht, asnjëherë nuk është marrë seriozisht të diskutohet e të trajtohet kjo temë.

Besoj që për shumicën e neve këtu edhe jashtë kësaj salle është e qartë që procesi i privatizimit në Republikën e Kosovës ka dështuar, ose thënë më mirë - ka prodhuar efekte tjera nga ajo që është pritur. Me procesin e privatizimit, natyrisht, pritet që ekonomia të rigjenerohet, të rifreskohet, të fuqizohet dhe të vazhdojë ta luajë rolin kryesor në zhvillimin dhe në ndërtimin e vendit. E kundërta ka ndodhur në vendin tonë. Nuk mendoj që këtu ne duhet të marrim shumë shembuj nga vendet tjera për të gjetur një lloj ngushëllimi nga ajo që ka ndodhur në Kosovë, sepse hulumtoni kudo, në çfarëdo vendi, askund nuk mund të gjeni situatë si në Kosovë.

Ajo që unë dua të ngre këtu është se unë e mbështes qëndrimin që procesin e privatizimit duhet ndarë në dy tema, ose në dy lëndë, ashtu siç edhe ka shkuar ky privatizim. Duhet të flasim për privatizimin me 'spin off' special, dhe privatizimet ose shitjet tjera. Këto janë dy çështje të ndryshme. Duke u nisur nga kjo, unë jam për atë që të fillohet dhe të trajtohen të gjitha privatizimet me 'spin off' special. Të shikohen a janë përmbushur ato kontrata dhe obligime të cilat i kanë marrë mbi vete blerësit apo kontraktuesit dhe mbi bazën e saj pastaj të mbyllet njëherë e mirë kapitulli i shumëpërfolur i privatizimeve.

Për të ardhur deri te kjo, mendoj që Parlamenti i Republikës së Kosovës, u fol këtu dhe unë pajtohem plotësisht që duhet të krijohet një komision hetimor, ama jo komision hetimor për një ndërmarrje, ose për një rast të veçantë. Parlamenti i Kosovës nuk guxon të bjerë pre e grupeve të caktuara të interesit për ta ushtruar ndikimin e tyre parcial për motive dhe për arsye të ndryshme. Parlamenti i Kosovës duhet mbi baza parimore dhe në interes të përgjithshëm ta trajtojë dhe ta mbyllë njëherë e mirë këtë çështje për të ecur përpara. E për ta mbyllur mirë këtë çështje duhet që të gjitha privatizimet me 'spin off' special të rishikohen deri në detaje dhe të vihet përfundimi.

Ne sot nuk duhet të paragjykojmë. Unë nuk e kuptoj një gjë, që një instrument më të fuqishëm që e ka ky Parlament, në Parlamentin e Kosovës aq lehtë kalohet nëpër këtë instrument. Nganjëherë as nuk dihet funksioni i këtij instrumenti. Nuk ka instrument më të fuqishëm në dorë Parlamenti i Kosovës se sa komisionin hetimor dhe ai që tenton ta përziejë gjykatën me komisionin hetimor janë dy çështje krejt të ndara. Është që t'i merret ai instrumenti më i fuqishëm që e ka Parlamenti i Kosovës.

Komisioni hetimor krijohet dhe do të duhej të krijohej dhe ky Parlament do të kishte sot me dhjetëra e dhjetëra komisione hetimore për çështje të caktuara. Pavarësisht për çka dyshohet, pavarësisht për çka diskutohet, sepse nëpërmjet këtij komisioni hetimor do të

hiqej nga rendi i ditës të shumë temave të cilat sot përfliten e përfliten, e degradohen, e dëmtohen njerëzit, ose shoqëria, ose grupi i caktuar i interesit.

Prandaj, ndërtimi i një komisioni hetimor, pastaj vetë komisioni do ta vlerësonte a ka nevojë për të futur në një inspektim, a ka nevojë për një auditim, të brendshëm, të jashtëm, të huaj, vendor. Është komisioni që e vlerëson dhe ia sjell rekomandimet Parlamentit të Kosovës.

Unë i lexova rekomandimet e propozuesit të rendit të ditës dhe mendoj që me një pikë, me një rekomandim, ne vijmë në përfundim. Sot ne nuk duhet të kërkojmë asgjë tjetër - një komision hetimor për ta vlerësuar gjithë procesin e privatizimit të ndërmarrjeve me ‘spin off’ special. Dhe këtu e kam fjalën, jo vetëm për Amortizatorët, jo vetëm për Fabrikën e Gypave, por edhe ‘Sharrcemin’, e posaçërisht ‘Ballkanin’ e Suharekës. Edhe ‘Ferronikelin’, edhe shumë e shumë tjerë, për të cilat ekspertët që janë marrë me këtë punë. Këtu kemi ekspertë, të cilët i dinë më mirë të gjitha ato ndërmarrje që kanë shkuar me ‘spin off’ special.

Duhet të futet komplet rishikimi, rivlerësimi. Të gjithë ata të cilët e kanë përmbushur kontratën sipas ligjit e vazhdojnë punën. Për të gjithë ata të cilët nuk e kanë përmbushur këtë kontratë, nuk ka nevojë Gjykata Speciale. Nga vetë rekomandimet që vijnë nga komisioni hetimor, atyre duhet t’u pushojë kontrata dhe komplet ato ndërmarrje të kthehen në situatën zero.

Ju e thatë këtë për Amortizatorët dhe përsëri po e them - ju lutem të mos e kthejmë Parlamentin e Kosovës duke folur për ndërmarrje veç e veç, sepse kjo është pafund. Të marrim si paketë, propozimi im është: të gjitha janë ndërmarrje të cilat janë të privatizuara me ‘spin off’ special patjetër duhet të shqyrtohen nga ky Parlament nëpërmjet një komisioni hetimor.

Komisioni hetimor, të nderuar kolegë deputetë, mund të veprojnë në qoftë se e kemi përnjëmend, duhet t’i jepet një fond, një buxhet. Ai duhet ta fillojë intervistimin e të gjitha grupeve, sindikatave, punëtorëve, ekspertëve, atyre që kanë drejtuar dikur ndërmarrjet tona, pastaj edhe kontraktuesve, edhe AKP-në, edhe të gjithë palët e involvuara në atë proces. Pastaj komisioni vjen në përfundim: duhet të shkohet në auditim, apo nuk duhet të shkohet, dhe i sjell rekomandime Parlamentit që të votojë: një ndërmarrje i ka plotësuar, apo nuk i ka plotësuar kushtet? Kjo mënyrë për qasje parciale, individuale është e pafund, kjo është për të mos e zgjidhur problemin. Kjo është thjesht për ta bartur diskutimin edhe vitin e ardhshëm, ose thënë më mirë - nëse vazhdojmë kështu - edhe një herë dalim para njerëzve të cilët e presin nga ne një zgjidhje, e këtu konkretisht e kam për punëtorët.

Dikush foli këtu për përqindjen e punëtorëve. Mos harroni se punëtorët e këtyre ndërmarrjeve nuk janë duke kërkuar për punën e atyre 20-përqindëshit të tyre që u takon në rroga, por thjesht ata janë duke luftuar, sepse janë të bindur se pasuria publike e këtij vendi nuk është privatizuar ashtu siç duhet, por është plaçkitur.

E tash, a është plaçkitur ajo pasuri apo s'është plaçkitur, ky Parlament e ka obligim të japë përgjigje, e jo gjykata. Parlamenti e ka obligim dhe ne si përfaqësues të popullit të ju japim një përgjigje, të themi "jo, fabrika e 'Ballkanit' është privatizuar si duhet". Këto janë argumentet. Ose nuk është privatizuar si duhet. Të kthehet në gjendjen e mëparshme, nëse duam ta zgjidhim problemin.

E të nderuar kolegë, për ta zgjidhur problemin duhet vullnet politik. Me vetë faktin që ne sot diskutojmë në fund të këtij mandati, kjo tregon që këtu ka munguar vullneti politik për ta zgjidhur çështjen e privatizimit dhe unë dyshoj që kjo do të mbetet vetëm diskutim. Këtu pres të vijë një përbërje e re e Parlamentit, e cila është e përcaktuar dhe garanton se do ta hapë këtë proces deri në fund. E nëse i shkon këtij procesi deri në fund atëherë jam shumë i bindur që rezultatet do të jenë shërbim dhe në të mirën e këtij vendi.

Ndryshe, ky është edhe një debat pafund, shterp, sikur shumë e shumë debate që janë bërë në këtë Parlament, e sidomos në këtë përbërje të Parlamentit që për tre vjet, unë besoj që nesër, ne kur ta kryejmë mandatin, pakkush ose pakgjë kemi për ta thënë, për t'u krenuar me atë punë që e kemi bërë për katër vjetët e kaluara.

KRYESUESI: Po duhet ta përsëris, t'i kthehemi temës konkrete, por kur është konkrete njerëzit flasin e bëjnë të përgjithshme, po ta kenë të përgjithshme thonë e duam konkrete. Burim Ramadani e ka fjalën. Kur ta kërkosht fjalën, qëndro këtu!

BURIM RAMADANI: Faleminderit, nënkryetar!

Në fakt, zoti Kelmendi e ka kërkuar fjalën para meje, prandaj unë dola jashtë për t'ia liruar vendin për të folur, vetëm për këtë arsye.

Po besoj që në total, sjellja moralizuese dhe sjellja engjëlllore në këtë seancë, edhe në këtë temë shumë bajate, jashtëzakonisht bajate dhe besoj që qytetarët dhe secili prej nesh edhe këtu e di që kjo sjellje është shumë bajate dhe nuk është e sinqertë, nuk është korrekte dhe besoj se loja me ndjenjat e njerëzve nuk është ajo që do të duhej të ndodhte, jo vetëm në këtë Kuvend, jo vetëm në këtë seancë, por asnjëherë në politikën e Kosovës, e cila definitivisht është dalldisur në nivelin më të ulët që e ka pasur ndonjëherë që prej çlirimit të vendit.

Nëse flasim për efektet e privatizimit në tërësi, por edhe për rastet konkrete veç e veç, mund ta përdorim ndoshta një fjali që njihet, që thuhet "efekti është shumëzuar me zero". Çfarëdolloj rezultati i mundshëm që mund të fillojë nëse shumëzohet me zero është zero. Asnjë përgjigje tjetër s'ka dhe asnjë efekt tjetër nuk ka. Dhe, në fakt, këta njerëz që tash mungojnë në seancë, sepse e udhëheqin Kosovën, dhe e kam fjalën për Qeverinë e Kosovës, që e udhëheq Kosovën, e kanë shumëzuar çfarëdolloj përpjekje, edhe të qytetarëve, edhe të politikës me zero edhe efekti është zero. Prandaj efekti është zero, sepse është shumëzuar me zero, dhe si e tillë po vazhdon edhe më tutje dhe e dimë që sistemet shoqërore, sistemet politike në ekonomi, rezultati zero është kthim prapa. Nuk është ecje përpara, sepse zhvillimet tjera ecin përpara.

Jo vetëm ky rast, ka edhe shumë raste tjera, të cilat i kanë vënë qytetarët e Kosovës, ish-punëtorët e atyre ndërmarrjeve në një situatë jashtëzakonisht të rëndë të jetës.

U përmend këtu disa herë fabrika “Ballkan” në Therandë, sepse s’po e themi më Suharekë, por Therandë; Fabrika e Gypave, hotel “Mirandi”, hotel “Iliria”, Distribucioni i KEK-ut, e shumë e shumë raste tjera, të cilat janë privatizuar, madje nëpërmjet sekserëve dhe ata që e kanë privatizuar nëpërmjet sekserëve definitivisht kanë përgjegjësi edhe do të duhej që të trajtohen juridikisht mirë në Kosovë.

Edhe në rastin e fabrikës “Ballkan” në Therandë, njerëzit plot pesë muaj janë në grevë, janë në tenda, dhe normalisht, sikur që e tha zoti Gjini më herët, nëse shkojmë një nga një, definitivisht se rendi menjëherë pas kësaj seance, pas këtij rasti, do të jetë fabrika “Ballkan”, sepse edhe aty do të duhej që të ketë raste të tilla, të cilat Kuvendi dhe politika në tërësi i trajton më seriozisht.

Por, në përgjithësi, duhet të them se jeta e keqe në Kosovë, e qytetarëve të Kosovës është e keqe, sepse ka Qeveri të keqe. Do të jetë e keqe derisa të ketë Qeveri të keqe, e kjo nuk është vetëm një mandatore. Po flasim për krejt periudhën sa Kosova është shtet, prej kur e kemi shpallur pavarësinë.

Ka pasur Qeveri të keqe kur është shpallur pavarësia, edhe në periudhën tjetër, dhe ka Qeveri edhe më të keqe, më megalomane, kështu që ka qenë edhe ajo. Për rreth shtatë vjet, Qeveria e Kosovës ka menaxhuar diku rreth 10 miliardë euro të buxhetit të popullit të Kosovës. Nëse e bëjmë bashkë për shtatë vjet buxhetin për secilin vit çfarë ka ndodhur dhe nëse perceptcioni është se në Kosovë keqmenaxhohet 10% e buxhetit, i bie që mund të llogaritet se janë keqpërdorur nga Qeveria e Kosovës 1 miliard euro për këto 7 vjet. Dhe nuk është pak dhe është tepër shumë, sepse kjo ka ndikuar dhe po vazhdon të ndikojë që jeta e qytetarëve të jetë e keqe.

Dhe edhe sot askush nga Qeveria nuk është këtu. Askush nga Qeveria nuk e ka asnjë përgjigje. Tek e fundit a ka njerëz edhe në këtë Kuvend të Kosovës që mund ta flasin një fjalë në emër të Qeverisë, a ka Qeveri Kosova, a ka Kosova një qeveri, e cila mund ta marrë përgjegjësinë për atë çka ndodhur në secilën fushë që është përgjegjësi e saj, a ka njerëz që e kanë votuar këtë Qeveri?

Edhe nëse kthehemi edhe te rasti konkret, kur ka ndodhur ky privatizim, në vitin 2010. Kush ka qenë në Qeveri, kush e ka votuar atë Qeveri, kush e ka votuar atë bord të AKP-së që ka qenë në vitin 2010? A ka njerëz që mund të flasin për AKP-në në vitin 2010, dhe ka?

Asnjë fjalë për atë çka ka ndodhur, për ato që dikush mund të marrë përgjegjësi dhe duhet të marrë përgjegjësi, sepse nuk po flasim për qielli, sepse nuk ka ndodhur diçka nga Marsi dhe asnjëri prej këtyre këtu prej nesh nuk ka asnjë lloj përgjegjësie. Secili që ka përgjegjësi duhet ta ndjejë përgjegjësinë, por në të njëjtën kohë duhet të vazhdohet edhe më tutje.

Unë besoj se Kuvendi i Kosovës në këtë seancë do të duhej që të pajtohej që ta krijojë një listë të ndërmarrjeve të privatizuara për të cilat do të ngrihet komisioni hetimor, përndryshe, fatkeqësisht detyrohem secili që të kthehem në përfaqësues të grupeve të caktuara, dhe unë e paralajmërova për rendin kush e ka. E ka “Ballkani” i Therandës, rendin e kanë shumë e shumë ndërmarrje të cilat janë privatizuar me sekser, madje edhe prej njerëzve të Qeverisë, janë privatizuar me sekser.

Prandaj, po besoj që do të duhet që ta kemi një listë ose të pajtohemi për një listë të ndërmarrjeve e cila do të futej si listë në një komision hetimor nga ky Kuvend i Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Ramadani! Fjalën e merr deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Degradimi i pasurisë shoqërore që dikur ishte në pronësi të qytetarëve të Republikës së Kosovës, me procesin e privatizimit së pari u degradua, për t’u shitur në shuma simbolike që as për së afërmi nuk e pasqyrojnë vlerën reale të këtyre pasurive.

Me instalimin e administratës së UNMIK-ut u themelua edhe një praktikë e veçantë, ku shihet se ndarja e pasurisë publike në pronë shoqërore dhe atë publike është bërë qëllimisht.

Qëllimi prapa kësaj vorbulle të madhe të korrupsionit mbështet në karakterin kriminal.

Përderisa ndërmarrjet shoqërore iu besuan në menaxhim Qeverisë për t’i degraduar skajshmërisht me menaxhmentet tërësisht politike dhe militaneske, ndërmarrjet shoqërore iu besuan Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit që pas shpalljes së pavarësisë, u trashëguan nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Duke e kategorizuar pronën e qytetarëve në këto dy kategori, ndërmarrjet shoqërore u degraduan dhe u shiten për çmime që u ishin përshtatur apetiteve të grupeve të ndryshme të interesit, ndërsa ndërmarrjet publike pas menaxhimit të dështuar qëllimisht nga kjo Qeveri, tani planifikohen që të privatizohen nga kompanitë fantome, për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se prapa tyre qëndron elita kriminale e politikës qeveritare.

Pasi që AKP-ja e kishte ndarë këtë ndërmarrje në dy kompani të reja, pra ndërmarrja shoqërore Fabrika e Amortizatorëve dhe ndërmarrja shoqërore Ndërtesa administrative, që të dyja të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ajo e kishte shpallur privatizimin e këtyre dy ndërmarrjeve në rundin e 45a.

Në listën e aseteve nuk ishin përfshirë afërsisht edhe 1 000 asete që ishin në shërbim të veprimtarisë së prodhimit e që me një vlerësim të përafërt kapnin vlerën afro 10 milionë euro. Pra, AKP-ja qëllimisht duke mos futur në listën e aseteve të ndërmarrjes këto asete, në mënyrë të drejtpërdrejt ka ulur në masë të madhe potencialin e ofertës së mundshme qysh në fillimin e privatizimit të kësaj ndërmarrje.

Në këtë drejtim, AKP-ja duke filluar këtë proces në mënyrë kaq të parregullt, këtë e ka formalizuar edhe me veprimet formale të saj. Në këtë mënyrë, AKP-ja ka shkelur rregullat e përgjithshme të tenderimit, të cilat vetë i ka nxjerrë.

Sipas kësaj, me nenin 3, paragrafi 1 është paraparë se personat që janë shpallur fajtorë për ndonjë krim që është kryer pas muajit qershor të vitit 1999 apo ofertuesi, i cili i është nënshtruar në ndonjë mënyrë ndonjë procedure penale, do të ketë ndalesë ofertimi.

Dhe, përkundër këtij fakti që hetimet penale ndaj ofertuesve Blerim dhe Shkëlqim Devolli për veprat penale siç është përcaktuar me aktakuzën e ngritur që është konfirmuar me aktvendimin numër 417/11. Këto hetime kishin nisur qysh në vitin 2010 e ku konkretisht më datën 15 korrik 2010 në gazetën “Kosova Sot” është botuar lajmi për bastisjen e shtëpive të pronarëve “Devolli Group” dhe vetë biznesin në fjalë.

Kjo vërteton se hetimet kishin filluar para kësaj date, gjë për të cilën AKP-ja më datë 27.10.2010 është dashur që të kishte bërë verifikimin e ofertuesve të cilët në atë kohë i ishin nënshtruar procedurës penale.

Po ashtu përkundër faktit se AKP-ja ka qenë e obliguar që të bëjë verifikimin e historikut të ofertuesve, shihet qartë se e njëjta nuk e ka bërë këtë në mënyrë të drejtë, pasi me vetë dokumentacionin e parashtruar nga ofertuesi mund të vërehet edhe një mbulesë që mund të çojë edhe deri tek legalizimi i përmbajtjes së rrejshme.

Po ashtu, sipas nenit 15.2 thuhet se Bordi i AKP-së detyrohet ta anulojë tenderin nëse për ftesën në ofertë janë paraqitur më pak se tri oferta që janë të regjistruara. Edhe përkundër kësaj, pra edhe pse nuk ishin parashtruar së paku tri oferta në procesin e parakualifikimit, Bordi i AKP-së nuk është përkujdesur pra për këtë çështje.

Po ashtu AKP-ja nuk është kujdesur për monitorimin e përmbushjes së obligimeve kontraktuale, duke marrë parasysh se sipas kontratës së privatizimit, blerësi i ndërmarrjes Fabrika e Amortizatorëve është i obliguar që të vazhdojë të mbajë aktivitetin aktual të biznesit për vitet e ardhshme.

Përkundër të gjitha këtyre veprimtarive ose veprimeve të paligjshme, AKP-ja e legalizoi shitjen e këtyre dy ndërmarrjeve për një çmim simbolik. Pra, ndërmarrja e re Fabrika e Amortizatorëve, 5 milionë, ndërsa Ndërtesa Administrative për 2 milionë euro.

Dhe në fund, me gjithë këto parregullsi janë dëmtuar drejtpërdrejt edhe punëtorët e kësaj ndërmarrje, të cilët nuk patën mundësi t’i realizojnë kërkesat e tyre legjitime. AKP-ja me këtë proces të privatizimit duhet të marrë përgjegjësinë për këto veprime të dëmshme që janë shkaktuar me anë të shkeljes së drejtpërdrejt të Ligjit dhe rregullave të tenderimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Albana Gashi e ka fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Procesi i privatizimit që filloi me politikat e imponuara nga administrata e Kombeve të Bashkuara përmes misionit UNMIK, që pat themeluar Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit e që pas shpalljes së pavarësisë është trashëguar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka përfaqësuar procesin më të korruptuar deri më tani që ka njohur Kosova.

Pas shpalljes së pavarësisë, Kosova lëre se nuk e ka forcuar subjektivitetin e saj në drejtim të administrimit të pronës shoqërore, por me këmbëngulësi ka vazhduar të zbatojë politikën korruptive të procesit të privatizimit.

Ky proces, i cili la më se 76 mijë punëtorë të papunë, po ashtu ka shkatërruar në tërësi pronën shoqërore e cila paraqet një ndër potencialet kryesore makroekonomike të Kosovës.

Një gjë e tillë është vërtetuar edhe me privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve. Kjo fabrikë e cila më herët ishte promotor i zhvillimit ekonomik në Kosovë, për t'u shitur aq lirë i është përshtatur, të ashtuquajturit "tregut të lirë, treg i cili është përcaktues i fatit të pronës për të cilët punëtorët dhe qytetarët e Kosovës investuan vite me radhë.

Përkundër kësaj, AKP-ja realisht nuk ka zgjedhur mjetet ligjore dhe faktike, vetëm dhe vetëm për t'ia përshtatur blerësit potencial, paraprakisht të paragjykuar. Dhe, kjo shihet më së miri meqë së pari juridikisht subjektiviteti i kësaj ndërmarrje u rregullua në mënyrë që çmimi të jetë korelativ me parcializimin e kësaj ndërmarrjeje.

Sipas kësaj, AKP-ja si përgjegjëse për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore, pasi ka vendosur masat e drejtpërdrejta të administrimit mbi pronat e ndërmarrjes shoqërore Fabrika e Amortizatorëve, ka themeluar dy ndërmarrje të reja që janë regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, konkretisht në Zyrën për regjistrimin e shoqërive tregtare.

Në këtë proces të administruar nga AKP-ja, pa ndonjë procedurë të veçantë të riorganizimit të ndërmarrjes ka bërë themelimin e ndërmarrjes së re shoqërore, duke e ndarë edhe pronën e paluajtshme për Njësinë administrative të Fabrikës së Amortizatorëve.

AKP-ja duke i regjistruar dy ndërmarrje të reja në cilësinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, ka themeluar dy ndërmarrje me subjektivitet tërësisht të ndarë. Kjo ngase që të dy subjekte kishin akte të veçanta themeltare dhe aftësi të veçanta për të vepruar.

Kështu, AKP-ja duke i ndarë pra në dy ndërmarrje të veçanta, atë të Njësisë Administrative dhe Fabrikës së Amortizatorëve, ka vënë në situatë këtë ndërmarrje që edhe ndaj detyrimeve të përgjigjet si dy ndërmarrje të reja.

Zaten, qëllimi kryesor këtu ishte se duke e ndarë pronën e luajtshme dhe atë të paluajtshme të kësaj ndërmarrje, krijonte përparësi ndaj ofertuesve që në çmim të ndarë të ofertonin blerjen e këtyre dy ndërmarrjeve të reja.

Në vend se procesi i vlerësimit të pronës së përgjithshme të Fabrikës së Amortizatorëve të vlerësohej si një tërësi, me ndarjen e kësaj ndërmarrje në dy entitete juridike, puna është vlerësuar në dy procese të ndara të cilat drejtpërdrejt dëmtuan vlerën e përgjithshme të kësaj ndërmarrjeje. Kështu që, duke dëmtuar këtë vlerë, u dëmtuan edhe punëtorët, të cilët sigurisht që në cilësinë e kreditorëve të 20% të vlerës së ndërmarrjes në mënyrë nominale u dëmtuan nga vlera që janë shitur këto dy njësi të ndara dhe të riorganizuara.

E gjithë faza e privatizimit të kësaj ndërmarrje, që përfshin veprimet para përgatitore, pra riorganizimin e Fabrikës së Amortizatorëve, themelimin e dy ndërmarrjeve të ndara, procesi i parakualifikimit, procesi i përzgjedhjes së ofertave, likuidimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të kontratës, janë rrethana faktike që e bëjnë këtë proces të mbështetur në dyshimin e bazuar se i gjithë ky proces ka karakter korruptiv.

Pa dyshim se ky proces duhet hetuar, ky proces duhet qoftë edhe të revidohet vetëm në mënyrë që këto kontrata që janë lidhur në kundërshtim me ligjin të shpallen të pavlefshme dhe si të tilla mos të prodhojnë asnjë efekt juridik.

Zaten, është edhe logjika e rendit juridik, ku në çdo rast kur vjen deri te cenimi i tij, nuk mund të njihen aktet juridike të cilat formalisht thirren në mbështetjen e rendit juridik në fuqi.

Duhet të kemi parasysh se përgjegjësia nuk duhet të mbetet vetëm tek ofertuesit, kjo përgjegjësi shtrihet edhe deri tek zyrtarët e AKP-së të cilët, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të kujdeseshin për zbatimin e drejtë të procedurave ligjore dhe qëllimit të zhvillimit të një procesi të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja deputete! E ka fjalën deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nga Kabineti qeveritar, nuk e kemi askënd.

Pra, meqë në shumë gjëra pajtohem me parafolësit e mi, nuk do të zgjas shumë, do të flas shumë shkurt.

Mund të themi dhe konkludojmë që privatizimi që nga fillimi ka qenë një proces jo i drejtë, i gabuar, jo transparent dhe me këtë privatizim askush nuk mund të thotë se ka qenë i kënaqur. Ka prodhuar papunësi, ka prodhuar varfëri, por fatkeqësisht edhe pasurim të pa bazë të shumë personave të caktuar dhe keqpërdorime pikërisht në privatizim, një privatizim i drejtë, i kënaqshëm është interes i të gjithë neve këtu. Dhe, të gjithë e përkrahim një privatizim transparent, fillimisht për qytetarët dhe edhe për ne si përfaqësues të qytetarëve.

I shikova rekomandimet e Lëvizjes “Vetëvendosje” natyrisht se pajtohem me formimin e komisionit hetimor, është një gjë që kemi nevojë. Komisioni hetimor mund të formohet edhe në bazë të nenit 77 të Kushtetutës, ku parashihet se me një kërkesë prej 40 nënshkrimeve apo 1/3 e deputetëve formohet komisioni hetimor dhe pastaj në pika tjera

caktohet përbërja e këtij komisioni. Është një hap pozitiv, është diçka që duhet të kryhet dhe në një mënyrë do ta kemi një transparencë për privatizimet se a kanë qenë të drejta apo jo.

Në këtë drejtim as nuk dëshiroj të paragjykoj se të njëjtat nuk do të votohen nga pozita, sepse një gjë e tillë do të zgjonte them një dyshim se në një mënyrë mbrohet një privatizim jo i ligjshëm apo edhe një privatizim ku ka edhe ndoshta korrupsion, prandaj dëshiroj ta theksoj se këto rekomandime unë do t'i votoj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Procesi i privatizimit në tërësi, po edhe ky që po flasim në veçanti, kanë pasur edhe një efekt që jo shpeshherë apo ndoshta me këtë nivel nuk është folur shumë për shkak se shumë fabrika apo disa fabrika siç është edhe Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, ka pasur edhe pajisje të cilat për destinacion kanë pasur edhe prodhime të ndryshme sensitive. Në rastin që ne po flasim, dihet që Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, ka pasur mundësi dhe kapacitete edhe të prodhimit të armatimeve dhe pajisjeve tjera ushtarake. Pra, Kosova në përgjithësi ka pasur disa fabrika të cilat me kapacitetet e tyre kanë prodhuar pjesë të armëve, armë dhe pajisje tjera ushtarake.

Por po flasim për Fabrikën e Amortizatorëve në Prishtinë, e cila ka pasur mundësi, ka prodhuar pjesë të ndryshme, e cila këtë fabrikë në atë kohë e kishte kthyer në një nga kapacitetet në ish-Republikën Federative të Jugosllavisë, e barabartë me shumë fabrika tjera. Pra, kjo fabrikë ka pasur edhe makineri të destinuara për prodhimin e armatimeve për ushtrinë jugosllave.

Ndër ato kapacitete që i ka prodhuar Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, kanë qenë pjesë të ndryshme, qoftë duke filluar nga ato armët e vogla siç kanë qenë pistoletat, ku për këto armë ka prodhuar rreth 10 procese ka pasur të prodhimit apo 10 pjesë të kësaj arme, pastaj për pushkë gjysmë automatike dhe automatike, 11 pjesë të saj për automatikun si armë e veçantë, po ashtu kaq 11 pjesë të tjera për mitraloz, minahedhës, top me artilleri të lehtë 22 milimetër, top për artilleri të mesme 90 milimetër si dhe artilleri të rëndë 105 dhe 155 milimetra. Për ata që kanë njohuri për këto kalibra, është shumë e qartë se për çka bëhet fjalë.

Pra, në këtë fabrikë janë prodhuar dhe kjo fabrikë ka pasur kapacitete të prodhojë armatime të kalibrave deri në artillerinë e rëndë.

Çështja është kjo se ku janë sot këto kapacitete, respektivisht ku janë sot këto makineri? Blerësi i cili e ka blerë këtë fabrikë, nuk e ka blerë për këtë destinacion, dhe unë e di që blerësi nuk e ka blerë këtë fabrikë, as të prodhojë amortizatorë, por njëkohësisht as të prodhojë armatime dhe pjesë të armatimeve. Por, ngjashëm me këtë fabrikë, ka pasur edhe fabrika tjera në Kosovë, siç ka qenë për shembull fabrika apo repart, ndër repartet më moderne të Fabrikës së Prodhimit të Armëve në Klinë, e cila fabrikë po ashtu është privatizuar për një destinacion tjetër.

Më lejoni t'ju kujtoj edhe një herë që në Fabrikën e Armëve në Klinë, apo në ish-Fabrikën e Armëve në Klinë - reparti i “Zastavës” në Klinë, ka pasur makineri të prodhimit të armatimeve ndër më modernet dhe jam shumë i sigurt që reparti i prodhimit të armëve në Klinë ka qenë reparti ndër më modern i “Zastavës” së atëhershme të prodhimit të armatimeve në Kosovë.

Çështja është kjo, ku janë këto kapacitete? Nëse nuk e dimë ku janë këto kapacitete, atëherë kush i ka në dorë këto kapacitete dhe do të ishte mirë që të ringrihej edhe një herë kjo temë për shkak se do të duhej së paku të ishim në tri situata në të cilat nuk jemi në asnjërën prej tyre. Pra, ose do të duhej këto kapacitete të shfrytëzoheshin për nevojat të Policisë së Kosovës dhe të FSK-së, ndonëse për momente janë shumë nevojat të vogla, ose do të duhej të ishin të ruajtura, të mbrojtura këto makineri të “fjetura” të quajtura ashtu, ose ne së paku do të duhej ta dinim se ku janë këto, pra do të duhej të ishin të sekuestruara së paku se ku janë këto kapacitete. Të mos harrojmë, këto janë kapacitete që nuk do të duhej të ishin në duar të panjohura. Të mos harrojmë, por t'i kthehemi prapë, po t'i kthehemi së paku të kaluarës sonë, por t'i kthehemi vetëm dhjetorit të cilin ne e kujtuam një nga rëniet më të mëdha në luftën e UÇK-së, ka qenë për armatime dhe kur e dimë që këto kapacitete i kemi pasur në dorë dhe nuk i ka sot, nuk i trashëgon as ushtria, as FSK-ja dhe as Policia, vërtet është një pyetje dhe një çështje për t'u ngritur.

Kosova do të duhej që këto kapacitete t'i shfrytëzonte e jo tash të ishin në destinacione të pa ditura.

Nëse më lejohet, pa dashje të ik nga tema, reparti i “Zastavës” në Klinë ka pasur armatime, më falni edhe armatime, ndoshta por si do qoftë ka pasur edhe makineri që kanë prodhuar armë dhe nuk dua të thirrem në të dhënat e panjohura, por gjithsesi ndoshta të përfolura që ato makineri janë kthyer andej kah kishin ardhur vite më herët dhe dekada më herët. Nuk do të duhej të ishte kështu, prandaj procesi i privatizimit ka pasur edhe këtë dimension, i cili nuk është i përmendur deri më tani.

KRYESUESI: Diskutuesi i fundit, Afrim Kasolli.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Karakter i brutal i procesit të privatizimit të zhvilluar në Kosovën e këtyre viteve askund nuk vërehet më shumë se sa në mënyrën se si është privatizuar Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë, apo më mirë të themi mënyra se si u legjitimua institucionalisht, politikisht dhe juridikisht plaçkitja e kësaj ish-ndërmarrje shoqërore për prodhim industrial nën emrin e gjoja procesit të privatizimit.

Retorika ideologjike që justifikonte infitimin praktik të këtij rendi të ri ekonomik postulohej mbi doktrimin e eliminimit të shtetit si aktor ekonomik në prodhimin e kapitalit shoqëror dhe ekonomik, ndërtimin gjoja të një ekonomie të tregut, rendit kapitalist, eficiencës ekonomike dhe hapjes së vendeve të reja të punës.

Po sot, më shumë se kurrë shihet qartë se gjërat nuk shkuan aspak në praktikë, ashtu siç u proklamuan nga synimet e shpallura zyrtare.

E para, paradoksi qenësor i këtij procesi ndoshta qëndron në faktin se në vend të premtimit për t'i ndarë proceset politike prej atyre ekonomike që synojë të etablohej, ai rezultoi me një konfigurim hegjeonik të ri të pushtetit politik pikërisht duke e shfrytëzuar procesin e privatizimit.

Askund nuk u dëshmuar më fort se retorika e fundamantelistëve të tregut se sa në Kosovë, se privatizimin do ta ulë korrupsionin e zyrtarëve politikë, por përkundrazi në Kosovë privatizimi u shndërrua në korrupsion dhe korrupsioni në privatizim. Sepse nëse një politikë është e korruptuar, privatizimi vetëm se do ta thellojë problemin dhe jo që do ta zgjidhë, ngase në fund të fundit, kjo politikë e korruptuar do ta menaxhojë këtë proces duke ndikuar edhe në shitjen e ndërmarrjeve nën vlerën e çmimit real të tregut vetëm për përfitimet personale dhe të strukturave që e financojnë pushtetin në dëm të interesave të vendit.

E në sajë të kësaj pleksje ndërmjet të këtyre dy veprimtarive, pushteti më pastaj në anën tjetër vetëm sa i shtrinë edhe më shumë kthetrat e tij mbi tregun, duke e fuqizuar veten edhe më shumë ekonomikisht. Shembull eklatant i kësaj fryme mund të merret dhe privatizimi i Fabrikës së Amortizatorëve nga Kompania e Devollëve, kompani kjo që në kundërshtim flagrant me çdo procedurë ligjore e uzurpoi këtë ndërmarrje vetëm e vetëm se ndoshta për shkak të lidhjeve të drejtpërdrejta me pushtetin politik.

Por është e ditur se fuqizimi i një rendi dhe modelit të mirëfilltë kapitalist shoqërohet me investimin e instrumentet e tjera, sikur që janë investimi në mjete teknike, veprimtaria hulumtuese dhe shkencore në funksion të prodhimit. Sepse siç ka argumentuar Veberi, një sociolog i njohur gjerman, jo dëshira e verbër për fitim, por organizimi racional i prodhimit e përbën esencën e këtij rendi, ndërsa procesi i privatizimit në Kosovë i menaxhuar, kontrolluar dhe i drejtuar politikisht nga instrument për lindjen e këtij rendi racional u shndërrua në instrument të lindjes së një kapitalizmi të përçudnuar, grabitqar politik. Dhe mbetet më se e qartë se ky rend logjikën e vet të pastër e ka në konjunkturën politike që dominuan Kosovën gjatë gjithë këtyre viteve.

Përgjithësisht, për shkak të deficiteve të sipërcekura, kjo shtesë e biznesmenëve rishtakë të lidhur me pushtetin, në pamundësi që fitimet e veta t'i shtojnë nga investimi në kapital, siç funksionon logjika imanente e kapitalizmit të vërtetë, ajo u orientua vetëm në aktivitetet e ndërmjetësimit tregtar dhe rast eklatant i kësaj dukurie mbetet fakti se sipas kalimit të kësaj prone në duart e Kompanisë së Devollëve, përfaqësuesit e saj në mënyrë të paligjshme grabitin asetet e luajtshme të kësaj ndërmarrjeje duke i shituar ato pastaj me një vlerë prej 7 milionë eurove edhe për kundër faktit se gjithë ndërmarrjen ata e kishin përvetësuar me një çmim prej 2 milionë euro.

Ndoshta ky transaksion super profitabil mbase ishte një mundësi tjetër e mirë për organizimin e orgjive hedoniste me pushtetin si shpërblim për këto përfitime që i merrnin.

Substancialisht, shndërrimi i këtij aktiviteti në normë të strukturës aktuale ekonomike e ka transformuar sistemin aktual në bartës të institutimit të këtij modeli bizar. Si i tillë ai jo vetëm që nuk e shton kapitalin e përgjithshëm ekonomik, vëllimin dhe prodhimin e shoqërive, zgjerimin e prodhimit industrial, por përkundrazi ndikon në pakësimin drastik të tij dhe bëhet motiv për largimin e pasurisë nga vendi.

E sfera ku më së shumti janë manifestuar pasojat negative të këtij procesi padyshim se mbetet humbja e vendeve të punës për ata që kishin punuar në këto ndërmarrje dhe mos hapja e atyre të reja. Sipas statistikave të deritanishme privatizimi në Kosovë ka rezultuar me humbjen e vendeve të punës për 70 000 qytetarë. Kjo humbje ka rrezikuar mirëqenien e 12 667 familjeve në kuadër të shoqërisë sonë. Këtë fakt tragjik padyshim se e kanë pësuar edhe rreth 1 mijë punëtorë të punësuar në Fabrikën e Amortizatorëve në Prishtinë. Pra, shihet qartë se procesi i privatizimit është faktori kryesor që Kosova sot renditet e para në Evropë për nga varfëria dhe pa punësia.

Dhe ky largim i njerëzve nga puna ka kosto të tmerrshme sociale dhe ekonomike, sepse pasojat e kësaj katrahure do të vërehen jo vetëm në momentin e humbjes së vendeve të punës, por edhe për një kohë të gjatë.

Në fund të fundit, lënia e njerëzve pa punë nuk mund t'i rrisë të ardhurat e përgjithshme në vend dhe as mirëqenien sociale, por vetëm sa do ta varfërojë.

Si pasojë tjetër e kësaj dukurie është abrogimi skandaloz i të drejtave të përgjithshme sociale, veçanërisht të ish- punonjësve të ndërmarrjes shoqërore, tani të privatizuar, të ndodhur në një botë pa mbështetje institucionale, të rrënuar dhe dëshpëruar, ata më shumë se çdokush tjetër janë viktimat e këtij rendi.

Kjo logjikë e prodhimit të papunësisë që i detyron njerëzit të jetojnë mes mjerimit dhe presionit psikologjik, përbën esencën e gjendjes emergjente të të jetuarit nga ky rend që i imponon. Pikërisht ky stil i jetës në një gjende emergjente përbën edhe logjikën imanente të doktrinës së shokut, doktrinë kjo që qëndron në fundament të këtij procesi e të cilin në mënyrë brilante e ka analizuar edhe një autore e njohur Naomi Klein, në një libër emblematic me të njëjtin titull. Madje ajo konstaton se si rrugëtimi se si eksperimenti i parë i këtij modeli ekonomik për herë të parë ishte bërë në Republikën e Kilit, në diktaturën e Pinoçetit për të vazhduar më pastaj në gjithë Amerikën Latine me juntat ushtarake dhe për t'u zgjeruar edhe në përmasa planetare.

Po sot më shumë se kurrë janë duke u shtruar për diskutim teorik paradigmat e reja zhvillimore që kanë për synim t'i japin fund doktrinës së shokut, e cila është treguar me pasoja fatale për ekonominë e përgjithshme.

Dhe në këtë kontekst, edhe në Kosovë sot më shumë se kurrë shtrohet për diskutim politik ndalimi urgjent i kësaj mënyre të privatizimit. Kjo ndoshta është mënyra e vetme për ta çliruar Kosovën nga tentakulat e korrupsionit, arbitrarizmit politik dhe kolapsit ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju e dini që sipas rendit, në këtë rast e merr fjalën propozuesi.

Më lejoni, zotërinj deputetë t’i them tri fjalë, meqë unë jam vetëm duke e drejtuar këtë seancë, nuk do të dal atje, por po e shfrytëzoj të drejtën e deputetit dhe të drejtuesit se s’mund të ma marrë kurrkush atë.

Çështjen të cilën, t’ju them drejt, ne në Grupin tonë Parlamentar e kemi diskutuar gjatë e gjatë, pa ardhur këtu, po përtej kësaj unë kam një mendim dhe plus u përpoqa t’ju dëgjoj këtu kujdesshëm të gjithëve.

Është interesant se ne jemi një Kuvend, proceduralisht kjo mënyrë është e drejtë e kërkimit të një diskutimi të këtij lloji i çfarëdo grupi parlamentar, kalon nëpër të gjitha instancat, Kryesi dhe tutje dhe tash këtu në bankat e Kuvendit, në vend që të përqendrohemi në këtë pikë që e kemi, tendenca është e madhe e ikjes nga pika konkrete, në fillim e grupeve tjera kah fundi totalisht edhe vetë “Vetëvendosjes”, që ikët, ju në histori e në gjeografi e në filozofi e politike që ishit kaq larg të kësaj teme. Domethënë të gjithë e kanë merakun, nëse ju jep diçka konkrete, kalojnë në të përgjithshmen, po ua dhe të përgjithshmen - thonë e pse kjo është, po mungon konkretja, s’jep rezultat. Pak a shumë po hidhemi këtu dhe mua më duket që nuk është edhe fort mirë, sepse është tepikje.

Ajo që edhe pak më shumë mua më integroi është problemi i njëfarë notimi, vetëmohimi të kolektivitetit nga këndi personal që unë edhe si drejtues edhe si deputet po duhet të tërheq vërejtje. Njeri as mos t’i lëvdojë të gjithë kolektivisht kur është entuziast se i ndodh njeriut, njeriu prej ndjenjave, nganjëherë është entuziast dhe i lulëzon krejt dynjaja para syve, a edhe kur është i rezignuar - të mos të thotë që ky Kuvend s’vlen. Unë në këtë an-blllok s’e pranoj në asnjërin variant, bile vetveten e përjashtoj prej kësaj në çdo mënyrë, sepse kaq kam të drejtë, nëse për ju tjerët s’kam, për veten kam.

Tutje. Ju duhet t’ju përkujtoj edhe një herë qysh janë procedurat, çka ka brenda në këtë mocion edhe procedura. Ligji për hetim parlamentar, neni 4, pika 2 e jep rastin qysh formohet domosdoshmërisht, edhe e treta ky tip i komisionit hetimor. Nëse janë 40 firma, domethënë 1/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës bën kërkesë dhe ajo domosdoshmërisht kalon në rast se, a, në rast se është shumica brenda. Dhe, ajo edhe më e rëndësishmja. Urdhëro, zoti kryetar që menjëherë veç të mos ta ndërprej mendimin edhe më e rëndësishmja, ky komision s’mund të punojë më shumë se 6 muaj, ky komision nuk krijohet më vonë se 6 muaj para se të mbarojë mandati, këto t’i keni parasysh.

Dhe po rezymo. Nga ajo që pashë unë, domethënë janë rekomandimet e “Vetëvendosjes”, është një propozim i modifikuar i LDK-së, është hedhur ideja që të bëhet Komision parlamentar për të gjitha ndërmarrjet që janë privatizuar me ‘spin off’ special që artikuloi Fatmir Limaj dhe është të bëhet komision hetimor për një listë ndërmarrjesh, e para mbas kësaj do të jetë “Ballkani” që është propozim i Burim Ramadanit. Unë rezymova, tash është e deputetëve të shkojnë tutje. Fjalën e ka paraqitësi i kërkesës...

(Ndërhyrje)

Çfarë the? Ai është diskutim yti, hetimi e gjen atë. Ose dalin vetë vullnetarisht që thonë janë pronarë, unë s'i di.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Me diskutimin dhe konsultimin me disa prej deputetëve dhe me Grupin Parlamentar të LDK-së, rekomandimet përfundimtare kanë pësuar një lloj modifikimi, të cilin do ta lexoj më vonë, por do ta vëreni modifikimin.

Prej asaj që dëgjova këtu, mendoj se është e nevojshme që të tentoj t'ju jap përgjigje pak disa gjërave që u ngritën nga deputetë të ndryshëm, të grupeve të ndryshme parlamentare për sa i përket çështjes në përgjithësi.

Është e vërtetë që ky debat ka qenë i motuar të përqendrohet në një proces të privatizimit, i cili ka të bëjë pra me procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve të ndarë në dy ndërmarrje dhe në këtë drejtim edhe rekomandimet kanë qenë të përqendruara në këtë, për shkak se konsiderojmë që është një proces i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm që duhet të hetohet dhe kjo nuk nënkupton që të tjerat nuk duhet hetuar dhe që të tjerat nuk janë të rëndësishme për t'u hetuar dhe që të tjerat nuk duhet debatuar në këtë Kuvend.

Unë konsideroj se natyrisht që është e drejtë madje edhe obligim i Kuvendit, meqenëse të gjithë këtu po e pranojmë në njëfarë mënyre që jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, atëherë kjo nënkupton që nuk jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës, individualisht apo si shumë aggregate, por më shumë përfaqësues të interesit të përgjithshëm. Dhe, nëse ne pajtohemi këtu që procesi i privatizimit, siç e përmendën deputetët nga grupe të ndryshme parlamentare, e ka cenuar këtë interes të përgjithshëm, pra që ka qenë i udhëhequr në mënyrë të gabuar, që ka prodhuar shkatërrim, rrënim ekonomik, degradim të kapaciteteve prodhuese e kështu me radhë, që u dëgjuan nga shumë deputetë, atëherë është hipokrizi të thuhet që Kuvendi nuk duhet të ndërhyjë në këtë.

Është një hipokrizi të thuhet që Kuvendi nuk duhet të merret me këtë, aq më tepër kur në njërin anë po e pranojmë që gjykata edhe i tërë sistemi është në njëfarë mënyre nën ndikim të politikës dhe në anën tjetër po themi që nuk duhet të ndërhyjmë në punën e këtyre gjykatave.

Pra, natyrisht që është obligim i Kuvendit që të debatojë dhe të nxjerrë rekomandime.

Këto rekomandime të paraqitura këtu, asnjëra prej tyre nuk janë vendime që duhet t'i marrë gjykata. Gjykata nuk merr vendim për themelimin e komisioneve hetimore. Le ta kemi parasysh këtë gjë, për shkak se çështja më e debatuar që ishte këtu ishte pezullimi i kontratës. Ne kemi kërkuar që kjo kontratë të pezullohet, jo të shkëputet. Dhe pezullimin e kontratës në bazë të respektimit të kushteve të kontratës e ka për obligim ekskluziv

Agjencia Kosovare e Privatizimit, e cila i raporton këtij Kuvendi, jo gjykata. Pra, të mos i përziejme gjërat, mendoj që si deputetë duhet të jemi të informuar mirë dhe ta themi atë si është.

U paraqit këtu edhe kërkesa e disa deputetëve, të cilët madje edhe e kushtëzuan votën e tyre me atë nëse do ta kemi një komision hetimor që merret me tërë procesin e privatizimit, e cila pastaj në njëfarë mënyre u reduktua, u konkretizua, të them ashtu nga deputeti Limaj, që të merremi me procesin e hetimit të ndërmarrjeve që janë të privatizuara me ‘spin-off’ special.

Konsideroj që është pikërisht kjo kërkesë dhe mënyra se si u shtrua këtu ajo që paraqet populizëm të kulluar, sepse po të kërkojmë një herë komision hetimor, i cili merret me tërë procesin e privatizimit, kjo nënkupton që të kërkohej një komision hetimor, i cili mbledhet për të mos bërë asgjë. Aq voluminoz, dhe aq shumë shkelje ka në këtë proces të privatizimit, ku janë privatizuar mbi 500 ndërmarrje në Kosovë sa që ky komision hetimor që merret me të gjitha, nuk do të merret me asnjërën, pra nuk do të bëjë asgjë dhe kjo është pra që t’i themi në njërin anë qytetarëve të Kosovës, punëtorëve të këtyre ndërmarrjeve, ja Kuvendi po bën diçka e, në anën tjetër, të jemi të sigurt, paraprakisht nuk do të bëjmë asgjë.

Pra, ky është populizmi, e nuk është populizëm që të merremi me një ose me disa raste të privatizimit të cilat paraqesin njëfarë mënyre këtë formën më eklatante të rrënimit, të degradimit ekonomik të Kosovës, siç është rasti i Fabrikës së Amortizatorëve për arsye që i përmendëm më herët.

Tash po i lexoj rekomandimet të cilat kanë ndryshuar, disa prej tyre janë formuluar, dhe kanë ndryshuar në renditje.

1. Të formohet Komision Hetimor Parlamentar për hetimin e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, pra Fabrikës së Amortizatorëve dhe i asaj të Amortizatori , ndërtesa administrative.
2. Të auditohet dhe të vlerësohet nga Auditori i Përgjithshëm procesi i privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve dhe ndërmarrjes shoqërore ‘Amortizatori’ - Ndërtesa Administrative, si dhe të gjetura te auditimit të vijnë në funksion të Komisionit Hetimor Parlamentar para se procesi i hetimit parlamentar të përmbyllet, dhe nën
3. Agjencia Kosovare e Privatizimit ta pezullojë kontratën me tenderët e privatizimit me ‘spin off’ special për Fabrikën e Amortizatorëve dhe ndërmarrjen shoqërore Amortizatori për shkak të mos përmbushjes së kushteve të kontratës deri në përmbylljen e procesit të auditimit dhe atij hetimor.

Pra, ta shpjegoj, veçanërisht për pikën 3, për shkak se këtu e pashë që ka keqkuptime të mëdha.

Pra, po e them, nuk kemi kërkuar shkëputjen e kontratës. Kemi kërkuar që kësaj kontrate t’i pezullohet efekti juridik për deri sa të përfundojë procesi i hetimit, sepse nuk ka

kurrfarë kuptimi që ne në njërën anë ta hetojmë një proces për shkak të dyshimeve të ngritura, pa i paragjykuar ato natyrisht dhe në anën tjetër ta lejojmë që blerësi të marrë vendime dhe të zbatojë vendime në ndërmarrjen të cilën e ka privatizuar...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Urdhëro, edhe një minutë, por përmbylle më shpejt!

VISAR YMERI: ...dhe që në atë mënyrë pra ta lejojmë vazhdimin e këtyre dyshimeve apo zbatimin e këtyre shkeljeve dhe në anën tjetër të shtiremi prapë kinse se po e hetojmë. Prandaj, ne kërkojmë që këto rekomandime të votohen.

Mirëpo, meqenëse janë çështje të cilat nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me njëra me tjetrën dhe që janë çështje që mund të funksionojnë ndarazi, kryetar kërkoj që rekomandimet të votohen një nga një, por jo të gjitha si listë, por të votohen për secilin rekomandim që deputetët ta kenë rastin ose mundësinë që të pajtohen për njërën, por të mos pajtohen për tjerat. Pra, të mos i lidhim, meqenëse edhe ashtu janë çështje që mund të funksionojnë ndaras nga njëra-tjetra. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, nëse është kështu, ne e kishim dhënë një pauzë deri në orën 15,15 minuta, në mënyrë që të përgatiten rekomandimet. A jeni dakord? Atëherë, këto rekomandime hidhen në letër, kështu që në orën 15:15 minuta do të vazhdojmë seancën.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë. Pasi nuk e kemi kuorumin e duhur për votim, vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Debat parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës për Prodhimin e Gypave në Ferizaj

Deputeti Elmi Reçica, i mbështetur edhe nga një grup i deputetëve nënshkrues, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit të Fabrikës për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK Ferizaj.

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, që të përgatisë një informatë lidhur me procesin e privatizimit të Fabrikës për Prodhimin e Gypave të Çelikut dhe Kuvendit ia paraqesin këtë informatë. Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka dërguar në Kuvend informatën e kërkuar.

E ftoj deputetin Elmi Reçica, në emër të deputetëve nënshkrues, në cilësinë e propozuesit të çështjes, ta paraqesë dhe arsyetojë kërkesën për debat.

ELMI REÇICA: I nderuar kryetar,

Zoti nënkryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të punëtorëve të ish-Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK të Ferizajt.

Më lejoni që në emër të 17 deputetëve nënshkrues dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, të bëj arsyetimin për thirrjen e debatit parlamentar në lidhje me mospërmbarimin e aktgjykimit Kushtetues të rastit KI 08/9 i datës 17 dhjetor 2010, që ka të bëjë me aktgjykimin 340/2001 i formës ‘res judicata’ për kompensimin e borxhit prej 25 milionë e 649 mijë e 250 euro, me kamatë vjetore 3%, prej marsit 2002, që duhet t’u bëhet 912 punëtorëve të kësaj ish-ndërmarrjeje.

Fillimisht, dua të theksoj se kryetari i Shoqatës Sindikale të punëtorëve të ish-Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK Ferizaj, zoti Ali Azemi, në emër të 912 punëtorëve më është drejtuar me një kërkesë për të iniciuar një debat parlamentar dhe për të sjell një rezolutë obligative ligjore, që në një afat prej 30 ditësh të ekzekutohet aktgjykimi Kushtetues, në rastin KI 08/09 i 17 dhjetorit 2010.

Kërkesa dhe insistimi i përfaqësuesve të punëtorëve të ish- Ndërmarrjes për nënshkruesit e këtij debati parlamentar dhe Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, është i ligjshëm, i bazuar dhe i arsyeshëm. Prandaj, konform kësaj është edhe domosdoshmëria që kësaj çështjeje pas përfundimit të debatit, miratimit të vendimit përmes votimit dhe në fund adresimit të qartë, se nga cili institucion dhe kur saktësisht do të fillojë implementimi i kompensimit të borxhit ndaj punëtorëve.

Është e vërtetë se kjo çështje është diskutuar, është debatuar dhe është përdorur dhe keqpërdorur në shumë situata dhe në shumë momente, mirëpo përfaqësuesit e punëtorëve dhe vetë punëtorët e kanë shumë të qartë se angazhimi i sinqertë dhe konkret ka qenë i atyre, të cilët vërtet kanë qenë të gatshëm dhe janë të angazhuar që çështja e tyre të marrë një zgjidhje përfundimtare.

Nga takimet e vazhdueshme të cilat unë i kam pasur me përfaqësuesit e punëtorëve, të cilët janë këtu në këtë sallë, e kanë parë gatishmërinë që kësaj odisejade t’i vijë fundi.

Çështja e vendimeve të institucioneve të pavarura, siç janë gjykatat, as që do të duhej të diskutohej se janë obligative për të gjitha institucionet që të zbatohen. Kompensimi i punëtorëve të ish- Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK në Ferizaj, i ka kaluar të gjitha instancat dhe të gjitha nivelet e gjykatave të Kosovës, që nga Gjykata Komunale e Ferizajt, Gjykata e Qarkut në Prishtinë deri te Gjykata Kushtetuese, si instanca më e lartë e gjykatave në Republikën e Kosovës.

Shqetësimin për mosekzekutimin e vendimeve të këtyre gjykatave, së fundmi me shkrim e ka shprehur edhe përfaqësuesi i Bashkimit Evropian, zoti Samuel Zhbogar, në letrën e dërguar më 3 tetor të vitit 2013.

Për hir të qartësisë së opinionit publik dhe të kuptuarit të kësaj odisejade të Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave IMK Çeliku, po paraqes përmbledhtas procesin se si është zhvilluar deri më tash.

Është e vërtetë që pjesa dërmuese e deputetëve dhe opinionit e dinë historikun e gjithë kësaj lëvizjeje dhe gjithë kësaj xhiro angazhimeve të punëtorëve, më duhet që në pika të shkurta ta paraqes këtu.

Më 27 shkurt 1990, menaxhmenti i përkohshëm i Ndërmarrjes Shoqërore IMK në Ferizaj, ndërpreu kontratën e punës për 912 punëtorë, me arsye se kishin munguar në punë për 5 ditë të njëpasnjëshme. Punonjësit parashtruan kundërshtimin e tyre pranë menaxhmentit të përkohshëm të IMK-së dhe parashtruan kërkesën për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tyre pranë Gjykatës Themelore të Punës së Bashkuar në Prishtinë. Duke konsideruar se vendimi i kundërshtuar i IMK-së është i paligjshëm, bazuar në atë se gjatë ditëve në fjalë ata nuk janë lejuar të hyjnë në fabrikë dhe të vazhdojnë punën, mirëpo, nuk kanë marrë asnjë përgjigje në kundërshtimin e tyre.

Në vitin 2001 këta punëtorë parashtruan në Gjykatën Komunale të Ferizajt kërkesëpadi lidhur me largimin e tyre të padrejtë nga puna dhe humbjen e pagave, nga data e largimit të tyre deri në datën e parashtrimit të kërkesës pranë kësaj Gjykate.

Në vitin 2002 Gjykata Komunale e Ferizajt në aktgjykimin e 11 janarit 2001 ka miratuar kërkesën për kompensimin e pagave të papaguara të punëtorëve të ish-Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK në Ferizaj, në shumën prej 25 milionë e 649 mijë e 250 euro. Ky aktgjykim është i plotfuqishëm ‘res juridica’, më 11 mars 2002.

Më 22 dhjetor 2005, Gjykata Komunale e Ferizajt lejoi përmbarimin e aktgjykimit, ndërsa përmbarimi nuk është kryer.

Më 2 prill 2007, përfaqësuesi i Sindikatës ka paraqitur kërkesën pranë Dhomës së Posaçme, duke kërkuar anulimin e të gjitha procedurave të privatizimit të kësaj ndërmarrjeje dhe duke kërkuar nga AKM-ja lëshimin e urdhëresës për të ndalur procedimin e shitjes së New Company IMK, që do të thotë se është Fabrika e Tubave të Çelikut në Ferizaj. Me vendim të 17 dhjetorit 2007, Dhoma e Posaçme e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës duke deklaruar se nëse parashtruesi i kërkesës do të mund të dëshmonte se kishte pronësi mbi pronën e privatizuar nga AKM-ja, ajo do ta anulonte transaksionin.

Më 21 nëntor 2007 AKM-ja publikisht deklaroi se IMK-ja është privatizuar në tërësi, për shumën prej 3 milionë e 200 mijë euro.

Më 18 nëntor 2007, Bordi i drejtorëve i AKM-së e shpalli IMK-në në likuidim në bazë të nenit 91 të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12. Pas saj punëtorët paraqitën kërkesën e tyre kreditore pranë Komisionit për Likuidime.

Më 6 tetor 2008, Gjykata Komunale në Ferizaj ‘ex officio’ e ndaloi ekzekutimin pas një njoftimi të dërguar nga AKM-ja në gjykatë, pasi që IMK-ja ishte futur në procesin e likuidimit.

Më 26 shkurt 2009 punonjësit dorëzuan në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për përmbarimin e aktvendimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale të Ferizajt C. nr. 340/2001 të datës 11 janar 2002.

Më 11 gusht Gjykata Kushtetuese njoftoi IMK-n lidhur me kërkesën e parashtruesit.

Më 13 tetor 2010, Gjykata Kushtetuese mbajti seancë dëgjimore, ku ishin të pranishëm përfaqësuesi i parashtruesit dhe përfaqësuesit e AKP-së, si dhe New Company IMK, ndërsa Gjykata Komunale në Ferizaj nuk ka marrë pjesë. Gjykata Kushtetuese në aktgjykimin e saj të datës 17 dhjetor ka vendosur: “vendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt i formës së prerë është i obligueshëm, dhe si i tillë duhet përmbaruar nga ana e organeve kompetente, posaçërisht nga Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, si pasardhëse ligjore e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

Në vitin 2011, në sqarimin e aktgjykimit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese, gjegjësisht në pikën 10 të këtij sqarimi përcaktohet pika 10, veç kësaj, sipas ligjit për AKP-n, duhet që AKP-ja është autoriteti që administron ndërmarrjet shoqërore dhe që AKP-ja do t’i përmbushë pretendimet e vlefshme të kreditorëve, që kanë të bëjnë me ndërmarrjet shoqërore nga mjetet e realizuara nga administrimi, shitja dhe likuidimi i ndërmarrjeve dhe ose aseteve të tilla. Pasi këto mjete të realizuara mbahen në mirëbesim dhe në të mirë të kreditorëve përkatës nga AKP-ja, AKP-ja mund të jetë e vetmja dhe tërësisht përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt C. nr. 340/2001 të 11 janarit të vitit 2002, varësisht dhe në çfarë mënyre paraardhësja e saj AKM-ja veproi gjatë këtyre 9 vjetëve të fundit lidhur me aktgjykimin e Gjykatës Komunale dhe respektimin e ligjit të zbatueshëm.

Në vitin 2012, në vazhdimin e sqarimit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese, ku përcakton që AKP-ja mund të jetë e vetmja dhe tërësisht përgjegjëse për zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale të Ferizajt, vendimi për mospërmbarim në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të 17 dhjetorit 2010, Gjykata Kushtetuese ka vendosur që të publikojë vendimin për mospërmbarim, për shkak se Qeveria dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit në Kosovë ende nuk kanë përmbaruar aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KI 08/09 të 17 dhjetorit 2010.

Si përpjekje për t’i dhënë fund kësaj odisejade dhe për të gjetur një zgjidhje konform ligjeve në fuqi, ky Kuvend, pra Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka mbajtur një debat parlamentar, më 21 shkurt dhe prej aty ka dalë rekomandimi: “Kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe organet tjera kompetente

për ekzekutimin në afatin 4-mujor të aktgjykimeve të gjykatave kompetente, për pagat e papaguara të punëtorëve të ish- Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK Ferizaj”.

Konform kësaj, ose këtij rekomandimi, kryeministri i Qeverisë së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për të zgjidhur këtë çështje. Në funksion të kësaj zgjidhje kryeministri ka takuar përfaqësuesit e punëtorëve të ish-Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave IMK të Ferizajt dhe ka dhënë premtimin publik se në emër të Qeverisë do të bëjë përmbushjen e këtyre obligimeve.

Mirëpo, organet përkatëse të Zyrës së Kryeministrit nuk kanë gjetur bazë ligjore se nga cili pozicion buxhetor i Buxhetit të Kosovës duhet të sigurohen paratë. Dhe, pikërisht duke u bazuar në këtë fakt dhe duke parë këtë pengesë është parë e nevojshme konkretizimi dhe adresimi i saktë prej nga duhet të sigurohen mjetet për pagesë, që duhet bërë ndaj punëtorëve të ish Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave.

Me këtë motiv dhe pikësynim është kërkuar ky debat sot. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është plotësisht i bindur se zgjidhja, përkatësisht mjetet buxhetore duhet të sigurohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, në kuadër të saj, konkretisht nga Fondi i mirëbesimit. Arsyeja është e qartë, Agjencia Kosovare e Privatizimit është e vetmja trashëguuese ligjore e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe që ka bërë privatizimin e kësaj ndërmarrjeje.

Duhet kujtuar me theks të veçantë se aso kohe i është bërë e qartë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit se ish-Ndërmarrja për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK në Ferizaj, sipas Gjykatës Komunale të Ferizajt, ka obligim 25 milionë e 649 mijë e 250 euro ndaj punëtorëve të kësaj fabrike, prandaj të mos bëhet privatizimi i saj. Porse, ky institucion nuk ka përfillur vendimet e gjykatave dhe ka bërë privatizimin, duke marrë kështu edhe përgjegjësinë për borxhet ndaj punëtorëve të ish-ndërmarrjes.

Prandaj, bazuar me sa u tha më sipër është Agjencia Kosovare e Privatizimit, ai i cili duhet t'i ndajë mjetet për të shlyer borxhin ndaj punëtorëve, kurse Qeveria e Republikës së Kosovës e ka për detyrë që të mbikëqyrë përmbushjen e këtyre detyrimeve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit ndaj këtyre punëtorëve.

Dhe në fund dua të theksoj se punëtorët e kësaj ish-ndërmarrjeje presin që debati lidhur me këtë çështje të mos politizohet, por secili deputet të japë kontributin e vet në të mirë të së vetmes zgjidhje të mundshme, pasi që është një problem konkret, i cili vetëm duhet adresuar konkret dhe kështu arrihet zgjidhja adekuate dhe i jepet fund kësaj odisejade të punëtorëve të Ndërmarrjes për Prodhimin e Gypave të Çelikut IMK në Ferizaj. Faleminderit! Kryetar, pas debatit i kam disa konkluzione, pastaj...

KRYETARI: Faleminderit! Por, unë jam i obliguar pasi më 21 shkurt 2013 kam nënshkruar një rekomandim që ka dalë nga një debat për të njëjtën çështje. Dhe, në rekomandim shkruan: “Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe organet tjera kompetente, që në afatin prej 4 muajve të bëjnë

ekzekutimin e aktgjytimeve të gjykatave kompetente për pagat e papaguara të punëtorëve të Fabrikës së Tubave dhe Çelikut në Ferizaj”. Dhe, ky rekomandim është nënshkruar më 21 shkurt 2013, do të thotë edhe një muaj bëhet një vit.

Mirë, vazhdojmë tash me radhën e kryetarëve të grupeve. Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, kryetari i Grupit, Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Sa për fillim po e them që kjo është dosja që unë e kam dhe e kemi shqyrtuar më 21 shkurt pas kërkesës për debat parlamentar, më 21 shkurt të vitit të kaluar. Edhe unë normalisht, i përshëndes përfaqësuesit e Sindikatës të cilët kanë ardhur sot për të ditur çka ka bërë Qeveria e jo edhe njëherë për t’ ia nisur kësaj, siç u tha këtu, odisejade.

Zoti kryetar, ne kemi qenë edhe në Kryesi të Parlamentit kundër, unë e kam thënë, jemi kundër një debati i cili, sipas nesh është tentim i relativizmit të problemit, është tentim i blerjes së kohës për Qeverinë si përgjegjëse dhe për AKP-në, për realizimin e asaj që ju e lexuat dhe unë po e them, ky është rekomandimi që ka dalë nga seanca e 21 shkurtit, kërkesë kjo në atë kohë e Grupit Parlamentar të LDK-së, por me përkrahje edhe të kolegëve të partive të tjera opozitare. Sigurisht se ka pasur edhe ndonjë të partisë në pushtet, dhe shumë qartë shkruan që është vetëm një rekomandim e ai është ai që lexuat ju dhe edhe njëherë më duhet të them që ne mbështesim këtë rekomandim si Lidhje Demokratike e Kosovës dhe absolutisht është edhe qesharake dhe absurde sot të ngremë një debat tash tjetër, për të njëjtën çështje, e të mos e bëjmë asnjë hap në realizimin e asaj që obligon gjykata, gjegjësisht gjykatat, të gjitha instancat e në fund edhe Gjykata Kushtetuese dhe po ashtu, rekomandimet e këtij Kuvendi.

Është shumë e qartë që me 21 qershor të vitit të kaluar, ka kaluar afati, katër muaj, vjet janë bërë dhe tash, më 21 shkurt të këtij viti bëhet një vit. Dhe, unë po e them me përgjegjësi të plotë, as s’e kemi keqpërdorur as që kemi dashur ta keqpërdorim, por thjeshtë kemi kërkuar zbatimin e ligjshmërisë të një vendimi që është dalë nga instancat gjyqësore, i drejtë apo i padrejtë, është instanca gjyqësore që ka vendosur. Dhe, ne konsiderojmë sigurisht se ka qenë i drejtë. Së këndejmi edhe kemi bërë debatin, është nxjerrë rekomandimi i vetëm dhe sinqerisht po e them, punëtorëve të nderuar, familjeve të tyre nuk u duhet vullneti i mirë, por u duhet konkretizimi dhe realizimi i atyre që ka vendosur gjykata dhe i rekomandimit të Kuvendit.

Ta lëmë këtë “ka treguar vullnet, mirëpo s’po dimë ku t’i gjejmë paratë, e sot ne donim t’ua gjenim paratë, sot për ta gjetur fondin, mënyrën, po kjo nuk është punë jona, kjo është punë e Qeverisë së Kosovës, është e AKP-së, ata le t’ua gjejnë ose t’i gjejnë ato mjete nga fondi, pozicioni, është punë e tyre, por nuk është jona sot.

Në këtë debat, absolutisht s’ndryshojmë asgjë dhe ne si Lidhje Demokratike e Kosovës nuk do të votojmë kurrfarë rekomandimesh dhe nuk do të marrim pjesë në debat, sepse e shohim, edhe njëherë po e them, tentim të relativizmit të problemit dhe në një mënyrë, një rekomandim shumë të sinqertë të drejtë, të ligjshëm, që e keni bërë, tash të

kamuflohet me nja 4-5 pika, ose 3-4 pika të tjera, që s'thonë kurrëgjë, sepse kur i riformulon është e njëjta gjë, e njëjta çështje që ne e kemi thënë.

Andaj, zoti kryetar, ne si Grup Parlamentar i LDK-së, e thashë nuk do të marrim pjesë në debat, meqenëse u tha po duan, që s'po duam ta politizojmë sipas dikujt, absolutisht s'ka nevojë, veç po kërkojmë të ekzekutohet vendimi i Gjykatës dhe të gjitha instancave gjyqësore dhe rekomandimi i 21 shkurtit të vitit 2013, asgjë më shumë dhe asgjë më pak.

Prandaj, ne nuk shohim asnjë arsye, as për të marrë pjesë në debat as të votojmë, por kërkojmë hapur, qartë po e them, ekzekutimin e asaj që është rekomanduar në seancën e 21 shkurtit. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Fabrikës së Tubave dhe Çelikut të Ferizajt,

Është e vërtetë që ne për herë të dytë po vendosim për një çështje, të cilën e kemi debatuar para një viti, por është edhe fakt dhe e vërtetë se s'ka pasur asnjë lëvizje pozitive drejt implementimit të rekomandimeve dhe drejt plotësimit të kërkesave të ligjshme të këtyre punëtorëve.

Ata i janë drejtuar Kuvendit dhe unë mendoj se ky debat i dytë, nuk do të duhej të ndodhte sikur të realizoheshin kërkesat, por duhet të jetë edhe debati i fundit për këtë çështje. Dhe, ne kemi obligim të përgjigjemi karshi kërkesave të ligjshme të tyre dhe të kërkojmë implementimin e plotë të kësaj marrëveshjeje, sepse nuk ka lëvizur asgjë në drejtim të realizimit të rekomandimeve të Kuvendit që kemi marrë më rastin e debatit të parë.

Fillimisht, për një shoqëri që synon vendosjen e sundimit të ligjit, që synon gjyqësorin e pavarur, moszbatimi i vendimeve të Gjykatës është një shkelje e rëndë drejt aspirimit për të ndërtuar një shoqëri ligjore, sepse në rastin konkret ne kemi dy vendime të formës së prerë. Kemi vendimin e Gjykatës Komunale, i cili pastaj është konfirmuar me plotfuqishmëri të ekzekutimit, por kemi edhe mendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila ka treguar që vendimi është i formës së prerë dhe i zbatueshëm. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare, të zbatueshme, të ekzekutueshme dhe të paapelueshme dhe në kuptimin e përgjegjësisë është Qeveria e Kosovës për gjetje, për implementimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kushtetuta këtë nuk e definon, por si ekspert kushtetues dhe si hartues i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe si njohës i praktikave të Gjykatës Kushtetuese, përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është Qeveria e Kosovës, që është organ ekzekutiv, e cila duhet të zbatojë një vendim të një organi shtetëror dhe të vendosë ligjin dhe kushtetutshmërinë.

Në rastin konkret, implementimi i kërkesave të ligjshme të këtyre punëtorëve ka hasur në problem drejt identifikimit të qartë të fondit, nga i cili këta do të kompensohen. Nuk

diskutohet më baza ligjore për kompensim, ajo është çështje “res-juridicata”, çështje e përfunduar. Këta e kanë fituar në “meritum” dhe më nuk diskutohet se këta duhet apo s’duhet të kompensohen. Këta duhet të kompensohen. Duhet të adresohet qartë ku gjenden mjetet, që ato të kompensohen.

Dhe, ato mjete, siç e tha edhe deputeti Reçica, i cili e paraqiti edhe një faktografi të rastit, duhet tani qartë të adresohen në kërkesën e sërishme të Kuvendit që ato duhet të zotohen dhe të gjenden brenda fondeve që zotëron Agjencia Kosovare për Privatizim, te Fondi i Mirëbesimit dhe ne sot duhet të bëjmë edhe një kërkesë të re që Qeveria e Kosovës të ushtrojë gjithë trysinë tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, që brenda afatit sa më të shkurtër, pra brenda 15 ditësh të zotojë këto mjete, të hartojë kornizën ligjore dhe kohore për kohën dhe dinamikën e kompensimit të këtyre punëtorëve dhe të njoftojë këtë Kuvend, i cili ka diskutuar dhe ka sjellë rekomandime për dinamikën e realizimit të këtij vendimi, sepse Kuvendi tani është palë, Kuvendi është palë në kuptimin që ka mbështetur, ka pru rekomandime dhe ka obligim që të kërkojë llogaridhënie nga Qeveria e Kosovës dhe zbatim nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, që ne të njoftohemi se a po realizohet që e ka pru Kuvendi i Kosovës.

Dhe, tani ne nuk duam të bëjmë shumë debate shterpë, sepse punëtorët nuk presin prej nesh debate, ata presin që gjërat të rrjedhin dhe zbatohen, por ne kërkojmë nga Qeveria që është organ llogaridhënës ndaj Kuvendit, që të ushtrojë gjithë kapacitetin ligjor që të kërkojë prej Agjencisë Kosovare që të fillojë implementimin e këtij vendimi dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit duhet të gjejë fonde, ka fonde, ka fonde të mirëbesimit dhe duhet të hartojë njëloj kornize, njëloj kalendari se brenda cilës periudhë punëtorët do të kompensohen. Dhe, mendoj se është e drejtë legjitime e Sindikatës së punëtorëve që të nënshkruajë një memorandum mirëkuptimi me Agjencinë Kosovare të privatizimit për mënyrën, kohën dhe dinamikën e kompensimit, sepse edhe punëtorët nuk presin një kompensim të menjëhershëm, por mjafton që procesi të fillojë të implementohet, vendimi të zbatohet dhe Kuvendi të marrë një informatë kthyesë që rekomandimi i këtij Kuvendi, që ka qenë i mbështetur nga të gjitha partitë politike, po zbatohet.

Unë, vetëm në këtë kuptim e shoh këtë debat, që është një debat i përsëritur, por mendoj debat i fundit, i cili duhet të rezultojë me fillimin e implementimit të kërkesave të punëtorëve dhe unë uroj, që pas këtij debati ne të kemi një zgjidhje dhe praktikisht punëtorët të fillojnë të marrin kompensimin e vet të merituar dhe në një mënyrë kjo çështje të jetë një çështje e mbyllur dhe një çështje ndoshta edhe një model se si duhet të procedohet në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve.

Andaj, i nderuar kryetar, unë e di që ky është një debat i dytë, është ndoshta edhe debat i konsumuar, por ne kemi obligim të përgjigjemi karshi kërkesave që vijnë dhe karshi iniciativave që janë dorëzuar në këtë rast dhe po pres që si rezultat i këtij debati të jetë presioni i fundit, pra, jo një debat shterpë, presioni i fundit tek Qeveria dhe AKP-ja që të fillohet jetësimi i plotë i kërkesave të punëtorëve. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, fjalën e ka kryetari i Grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është e vërtetë që një debat i tillë dhe shumë debate të tilla edhe atë që e patëm paradite janë të domosdoshëm për këtë Kuvend dhe ne vazhdimisht kemi qenë të gatshëm për të përkrahur iniciativa të tjerëve kur kanë pasur të diskutojnë çështje të tilla, apo edhe të gatshëm që të ngremë çështje të tilla në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Pra, prapë mendojmë që është e domosdoshme që ky proces i privatizimit dhe padrejtësitë që janë shkaktuar përmes tij të diskutohen nga Kuvendi dhe të ftohen institucionet e Kosovës, që të ndërmarrin masa për sanimin e kësaj gjendje. Sepse, natyrisht që vetëm diskutimi, këtu pra të pajtohemi ne që procesi i privatizimit paska qenë i keq dhe tash po shkojmë në shtëpi dhe po e vazhdojmë jetën, kjo s'ka kurrfarë kuptimi, këtu pajtohem plotësisht.

Mirëpo, debati i sotëm mendoj që është së pari i panevojshëm, sepse është kryer, pra kemi bërë debat vitin e kaluar, nuk është se ka ndryshuar ndonjë gjë në këtë drejtim. Pra, për sa i përket çështjes për të cilën po flasim, gjendja është e njëjtë që ka qenë në shkurtin e kaluar, siç është e njëjtë që është duke u përcjellë që prej vitit 2007, kur është privatizuar kjo ndërmarrje, ose edhe më herët, që prej kohës kur Gjykata Komunale e Ferizajt ka vendosur në favor të punëtorëve të Fabrikës së Tubave për t'ua paguar borxhin që ua ka pasur kjo ndërmarrje, para këto të cilat ata kurrë nuk i kanë parë.

Dhe, unë mendoj që është pikërisht kjo thirrje, kjo mënyrë e thirrjes së debatit, në njërën anë keqpërdorim i debatit, keqpërdorim i Kuvendit dhe në anën tjetër, ka edhe shumë sherre në rekomandimet, të cilat janë dorëzuar për të cilat do të flas pak më vonë.

Sa i përket çështjes së përgjegjësi, këtu u fol që Qeveria e Kosovës ose AKP edhe kush e ka përgjegjësinë kryesore për çështjen për të cilën po flasim. Dhe, natyrisht që AKP-ja është ajo agjencia, e cila edhe merret me privatizimin edhe merret pastaj me menaxhimin e Fondit të Privatizimit, pra të atij fondi që mbledhet nga shitja e kompanive të Kosovës, kështu që në shikim të parë mund të duket që këtu përgjegjësinë kryesore e ka AKP-ja, mirëpo a është vërtetë ashtu?

Unë mendoj që jo. Dhe, është shumë e qartë që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, në favor të punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj, ceket shumë qartë që është përgjegjësi e Qeverisë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit për përmbarimin apo zbatimin e vendimit të Gjykatës Komunale. Pra, aty në mënyrë eksplicite përmendet Qeveria dhe kjo nuk është rastësisht. Pse nuk është rastësisht? Sepse, ne e dimë të gjithë që Fabrika e Tubave e Ferizajt është shitur për 3 milionë e 650 mijë euro, ndërkohë që borxhi që kjo ndërmarrje ua ka punëtorëve është mbi 25 milionë euro. Pra, edhe po të donte, e qartazi AKP-ja nuk ka qenë kurrë e interesuar që ta paguajë këtë borxh, por edhe po të dëshironte ta paguajë këtë borxh, AKP-ja i ka vetëm 3 milionë e 650 mijë euro për ta paguar borxhin, pjesa tjetër pastaj kur do të merret.

Kjo është çështja që duhet ta diskutojë Kuvendi dhe këtu, mendoj unë, është përgjegjësia e Qeverisë, sepse nëse ju kujtohet, me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për AKP-në kur flitej për fondet publike, ju kujtohet që aty e pat marrë përsipër Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i marrë një pjesë të fondeve nga privatizimi, 75% sosh dhe me atë e merr

edhe obligimin pastaj, që çfarëdo kërkesë e re e ligjshme për kreditim, ose për t'ia kthyer kredinë kompanive, të cilave ua ka marrë paratë, mbetet përgjegjësi e Qeverisë. Pra, kjo përgjegjësi shkon përtej Fondit të gjeneruar nga privatizimi.

Dhe, në këtë kuptim, mendoj unë, që këtu është përgjegjësia shumë e qartë edhe e Qeverisë për ta përmbushur atë dallim në shumën e parave, në mes të parave që janë gjeneruar nga shitja e ndërmarrjes dhe parave që kjo ndërmarrje ua ka borxh punëtorëve, të cilët në këtë rast llogariten si kreditorë. Pra, kjo është ajo shumë që në rastin konkret është mbi 22 milionë euro, e cila duhet të mbulohet nga Qeveria dhe këtu është përgjegjësia e Qeverisë.

Dhe, tash çfarë do kërkesi i seancës? Me rekomandimin që e ka sjell këtu, të cilin unë kam dëgjuar se e ka tërhequr, por në fakt nuk është tërhequr, është pjesë e dokumentacionit që na është dorëzuar. Në pikën e parë thuhet: obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit që në kuadër të kornizës ligjore dhe Fondit për ndërmarrje të kontestuar, të zotojë fondet e nevojshme për fillimin e implementimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Tash këtu janë dy problemet kryesore në këtë kërkesë. Së pari, përjashtohet plotësisht Qeveria e Kosovës përkundër faktit që Qeveria e Kosovës figuron në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ky është sherri një. Mirëpo, ky është sherr më i vogël krahasuar me këtë sherrin dy. E cili është sherri dy? Jam shumë i lumtur që këtu janë edhe punëtorët, përfaqësuesit e punëtorëve që ta shohin këtë seancë dhe ta shohin se çfarë mashtrimi, të them ashtu, po tentohet të bëhet këtu.

Sherri dy është që thotë që të zotohen mjetet për fillimin e implementimit, pra jo për përmbartimin e plotë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, por për të filluar implementimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ky fillim mund të jetë, ta zëmë me 100 mijë euro. 100 mijë euro u ndahen 900 punëtorëve, u bien nga sa u bien edhe thonë tashmë nuk ka para të tjera, që u zbatua një pjesë e vendimit, shkoni tash nëpër shtëpia, sepse edhe ju jeni të kënaqur edhe ne jemi të kënaqur si deputetë. Pra, ky është sherri. Nuk po flasim për këto 25 milionë euro, që ua ka borxh ndërmarrja, këtu po flasim për atë sa ndanë Agjencia Kosovare e Privatizimit. E ajo plus ajo pozitivja në këtë rast mund të jetë prej 1 euro deri në 10 mijë euro, por nuk do ta tejkalojë 3 milionë e 650 mijë euro, sepse më shumë AKP-ja në këtë rast, nuk ka se ku t'ia marrë. Pra, AKP-ja nuk do t'ia marrë fondet që janë gjeneruar, ta zëmë, prej privatizimit të amortizatorëve, dhe t'ia japë këtë Fabrikës së Tubave, sepse nuk e ka këtë të drejtë, apo jo.

Ata që i kuptojnë pak ligjet se si funksionojnë, ose që e kuptojnë pak rregullimin institucional të Kosovës, do të duhej ta dinin këtë. Dhe, unë mendoj që edhe këta që e kanë parashtruar kërkesën e kuptojnë këtë, por kanë zgjedhur mos ta kuptojnë, sepse gjatë fushatës paraelektorale dhe këtu punëtorët e dinë shumë mirë, u është kumtuar edhe njëherë nga kryeministri, që paratë i ka të gatshme, vetëm po pret vendimin që t'ua japë ato para, apo jo. Dhe kjo punë është në tetor të vitit 2013, pra jo shumë larg. Dhe, në këtë drejtim tash sa për t'u hedhur pak hi syve dhe t'u thuhet punëtorëve të Fabrikës së

Tubave që edhe ne u munduam pra për ta realizuar premtimin tonë, por ja që ishte e pamundshme, po bëhet kjo kërkesë për debat.

Pra, kjo është kërkesa më e pasinqertë për debat, që e ka parë ndonjëherë kjo legjislaturë dhe si e tillë, natyrisht që konsideroj se përveç që është e tepërt, madje-madje është edhe e papranueshme që të ndodhë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Edhe Lëvizja “Vetëvendosje” refuzon të marrë pjesë në këtë debat dhe i vetmi rekomandim që mendojmë se duhet të nxirret nga ky Kuvend, është ai që është nxjerrë më 21 shkurt, ose një vendim i ngjashëm, që do të mund të votohej, kur do ta kishte vetëm një pikë, në të cilën kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Agjencia Kosovare e Privatizimit, që të zbatohet në përpikëri, po të përmbahet vendimi i Gjykatës Komunale të Ferizajt, i mbështetur edhe nga Gjykata Supreme edhe pastaj nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Çfarëdo variacioni tjetër është mashtrim për punëtorët dhe është në kundërshtim edhe me logjikën institucionale, por edhe me ligjet pozitive në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, kryetari i Grupit, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zakonisht, kur duam të përgjigjemi në diçka, fillimisht duhet të dimë kush po thotë dhe çka po thotë. Tash, kush po thotë sot, është Qeveria e Kosovës, ju jeni Qeveria, është demokraci parlamentare, thonë kush po thotë tjetra, është edhe më zi, është zëvendëskryeministri i parë i Qeverisë së Kosovës, që është pronar i Fabrikës, që po thotë: “Kam ardhur për punëtorë këtu, t’u japë para.” Domethënë, Qeveria dhe zëvendëskryeministri dhe kryeministri po flasin. Tash, çka po thonë sot me këtë rezolutë, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, po i thonë punëtorëve të Fabrikës së Tubave të çelikut, “shkoni te AKP-ja merrni paratë.” Kështu po thoni, se diqysh duhet të përmbledhet me një fjali, krejt ato që janë shkruar në rezolutë. Dhe, ju po u thoni, shkoni në AKP. Krejt në rregull është për t’u thënë shkoni në AKP, se është njëfarë rendi të shkojnë në AKP, por nuk është në rregull me dalë para fushatës e me iu thënë, “i gëzofshi 25 milionë, unë kam me ua dhënë”.

Domethënë, krejt çka po bëni ju sot, është për t’i thënë popullit, “edhe ju shkoni te AKP-ja tash, para fushatës ju thamë që ne ua japim 25 milionë, unë ju jap, tha kryeministri i Kosovës, veç pritni ju.” Tash po u thoni: shkoni atje. Domethënë, që kjo është çka është duke ndodhur. Kush po thotë dhe çka po thotë është kjo, kurrëgjë as më pak as më shumë.

Tani folëm edhe në pikën paraprake të rendit të ditës, për privatizim. Mund të them që këtu brutaliteti nuk ka pasur fund. Bile-bile, ne si Aleancë jemi ithtarë ta dimë se kush po blen dhe çka po blen edhe nuk na duket që është marre për ta privatizuar dikush. S’është marre, i ka mjetet, e kemi qitur në shitje një aset si Kosovë, blije! Krejt në rregull është, aq më mirë të kemi biznesmenë tonë që blejnë.

Por, kur ndodh të gjitha herët që një person që privatizon e ka dikë përpara që e jep çmimin e vet është i dyti permanent, atëherë këtu kemi problem ne, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës, të nderuar qytetarë, kemi problem e aq më i madh është problemi kur ky person është gjithmonë zëvendëskryeministri i Kosovës. Njëjtë e keni Grandin, dikush tjetër e blen për të. Njëjtë e keni “Ilirinë”, dikush tjetër për të. Njëjtë e keni Fabrikën e Tubave, dikush tjetër për të, ky është i dyti dhe në secilin rast nga një milion, a dy a tre, hiqen në çmim. Njëjtë e keni edhe rastin e ‘Farmedit’, fatkeqësisht EULEX-i është në ‘Farmed’, paramendoni ju, në ‘Farmed’ ka dalë njeriu, ka denoncuar publikisht, ka thënë më ka para borxh, se kam qenë i pari e jam tërhequr, duhet të m’i paguaj paratë.

Kjo është Kosova e Qeverisjes suaj, ju jeni Qeveria, demokraci parlamentare nuk janë Qeveria ata, jo, jo, ju jeni qeveria të nderuar deputetë. Aleanca nuk mund të kërkojë asgjë tjetër, përpos se nëse kemi sot ndonjë rezolutë, të rikonfirmohet rezoluta e 21 shkurtit të vitit të kaluar. Thjeshtë, ju keni thënë njerëzve që doni t’ua paguani paratë, paguani ato. Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim, të gjitha instancat janë shterë, duhen paguar mjetet, tani gjeni mjetet. Kishte me qenë krejt ndryshe situata sikur kryeministri i Kosovës të kishte qenë i sinqertë kur ka shkuar në Ferizaj, e me u thënë: “shihni, unë s’mund të ju paguaj”, por u ka thënë: “mos t’ua ndiej, votoni e shihni ju pasnesër se çka ju them”. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

E nderuara ministre, që je sot këtu e pranishme me ne,

Duke marrë parasysh se deputetët e Kuvendit të Kosovës janë të interesuar për biografinë e zëvendëskryeministrit të parë dhe blerja e çështjes së aseteve të tij, sot do t’ia bëj me dije shefit të Grupit Parlamentar të AAK-së se zëvendëskryeministri i parë Fabrikën e Gypave e ka blerë kur s’ka qenë zëvendëskryeministër. Hotelin “Grand” e ka blerë nëpërmjet aksioneve pa qenë zëvendëskryeministër dhe është mirë dikush që blen me para të veta dhe nuk uzurpon, kjo është çështja më e mirë e zëvendëskryeministrit të parë, në rast se e blen edhe përmes të aksioneve të dikujt tjetër.

Ndërsa, çështja e ngritur nga kërkesa e deputetëve të cilët janë nënshkrues për debatin lidhur me Fabrikën e gypave dhe punëtorët që gjenden këtu, kryetari i Kuvendit e tha shumë qartë se ne kemi nxjerrë një rekomandim më 21 shkurt 2013 dhe në bazë të atij rekomandimi nuk ka ardhur kurrfarë vendimi tjetër. Dhe, ne e dimë mjaftë mirë se vendimet e Gjykatës duhet të respektohen. Unë e thashë edhe pak më parë, në debatin e mëparshëm, nuk jam e interesuar të bëj fushatë me ndërmarrjet shoqërore, por jam e interesuar që procesi i privatizimit të jetë në mënyrë transparente dhe në rast se janë shkelur ligjet, atëherë gjyqësori dhe prokuroria kanë punë me to. Unë nuk jam as gjyqësor as prokurori, por jam deputete dhe kërkoj çështjen e zbatimit të ligjit. Dhe në këtë rast, në rast se kanë ardhur këto vendime të Gjykatës, atëherë besoj që ne veç mund të kërkojmë nga Qeveria, që besoj se është në dijeni mjaft mirë, që vendimet e Gjykatës duhet të respektohen. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: E nderuar deputete Selmani, Edhe kur nuk ka qenë zëvendëskryeministër, edhe pasi është bërë zëvendëskryeministër, njëjtë e ka bërë. I njëjti sistem është. Ke qenë këtu deputete e di ku e ka marrë prej Qeverisë së Kosovës, në mënyrën më të paligjshme dhe brutale të mundshme, kontratën për renovim të “Rilindjes”, e dini që njeriu ka denoncuar publikisht në televizor për Farmed, e dini që ka proces gjyqësor për Grand. Krejt po i dini, domethënë, qysh bën që një njeri krejt kohën çka po prek e ka njëfarë kontraverse, unë nuk po them kurrëgjë, veç kaq po them, çka kemi parë në televizor, çka kemi parë në media, çka kemi ndie këtu në Kuvend.

Sa për uzurpime, kushdo që ka uzurpuar duhet të shkojë në burg, veç ju jeni kah flisni për do uzurpime që kanë ndodhur me ndonjë qymez, me ndonjë kioskë, e unë po ju them që kur një kompani blihet për 5 milionë e vlerën reale e ka 100 milionë, ky është uzurpim i përmasave epike. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replika është 1 minutë, Myzejene!

MYZEJENE SELMANI: Jo një minutë kryetar, as ky s’e pati një minutë.

KRYETARI: ... Shikoje Rregulloren!

MYZEJENE SELMANI: Të lutem! Të njohim, shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, që ka filluar një fushatë nga humbja e Gjakovës, mirëpo në fakt e gjithë pasuria e zotit Pacollit është shumë valide. Më vjen keq, se ju jeni kah mundoheni ta përdhosni figurën e tij, po ju kisha thënë: merruni me figurat tuaja, më së miri është dhe e shihni se cilat janë problemet kontroverse në subjektin e juaj dhe te lideri Pacolli.

KRYETARI: Vazhdojmë. Fjalën e ka deputetja Lumnije Morina.

LUMNIJE MORINA: Faleminderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Edhe unë dua t’i bashkëngjitëm këtij debati edhe pse debat për të njëjtin problem është bërë edhe në shkurtin e vitit të kaluar.

E dimë që nëpër procesin e privatizimit të Kosovës kanë kaluar shumë ndërmarrje, në mesin e të cilave ka kaluar edhe Fabrika e Tubave të Çelikut në Ferizaj. Për mënyrën se si u privatizuan këto ndërmarrje, me çfarë kushte dhe me çfarë çmimi ato u shitën, flet më së miri edhe rasti i Fabrikës së Tubave të Çelikut në Ferizaj.

Kjo fabrikë në vitin 2007 u privatizua dhe u shit me një shumë prej 3 milionë e 657 mijë eurove, çmim ky aspak real. Ky privatizim u bë në shpërputhje të plotë me pritjet e punëtorëve të kësaj fabrike, të cilët në momentin e privatizimit ishin në gjendje të rëndë ekonomike. Mendimi në atë kohë, se Fabrika e Tubave të Çelikut në Ferizaj nuk duhej të kalonte nëpër procesin e privatizimit, përderisa të mos definohej qartë kërkesa e

punëtorëve të kësaj fabrike ndaj menaxhmentit të përkohshëm të fabrikës lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës, si dhe kompensimin e pagave të 912 punëtorëve, të larguar nga puna në mënyrë të dhunshme, më 27 shkurt 1990, po del që ka qenë mendim i arsyeshëm.

Po them se ka qenë mendim i arsyeshëm, pasi kërkesa për kompensimin e punëtorëve të larguar nga puna për dëmshpërblim u bë nga Sindikata e pavarur e punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj dhe u miratua nga Gjykata Komunale e Ferizajt në vitin 2001.

Kjo gjykatë mori vendim që punëtorët e Fabrikës së Tubave të Ferizajt të larguar me dhunë nga puna të dëmshpërbleheshin me një shumë afro 26 milionë euro, e cila shumë ishte afër dhjetëfish më e lartë se sa shuma e shitjes së fabrikës. Meqenëse, vendimi i Gjykatës Komunale nuk është ekzekutuar asnjëherë dhe Sindikata e Punëtorëve e Fabrikës së Tubave ishte këmbëngulëse në realizimin e vendimit, ata iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e vendimit të formës së prerë të Gjykatës Komunale të Ferizajt dhe Gjykata Kushtetuese e shpalli si të pranueshme kërkesën e punëtorëve të fabrikës.

Derisa e kemi një vendim tjetër dhe atë të Gjykatës Kushtetuese në favorin e punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Ferizajt, konsideroj se ky problem duhet të zgjidhet përfundimisht, në mënyrë që punëtorët të mos bredhin rrugëve edhe më tutje për realizimin e vendimeve që janë marrë nga gjykatat në favorin e tyre.

E thanë edhe kolegët e mi gjatë diskutimit se edhe në vitin e kaluar Kuvendi ka debatuar lidhur me këtë problem dhe janë nxjerr rekomandime. Edhe sot pas një viti prapë po debatohet për të njëjtin problem dhe mendoj se ky problem i këtyre punëtorëve nuk do të zvarritet edhe më tutje, por duhet të bëhet realizimi i vendimeve të gjykatave dhe gjithashtu të zbatohet rekomandimi i Kuvendit të Kosovës , i cili është marrë në vitin e kaluar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Megjithëse nuk ka pasur nevojë për debat, por meqë u hap kjo temë konsideroj se tash duhet vetëm të kërkohej zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese, me çdo kusht dhe po ashtu, meqë kemi të bëjmë me dëmtim të interesit, prej momentit kur ka marrë vendim Gjykata Kushtetuese, deri sot duhet të paguhet dëmshpërblim për moszbatimin e vendimit dhe njëkohësisht Qeveria e cila nuk e ka kryer obligimin ndaj punëtorëve të fabrikës duhet thjesht të sanksionohet dhe ne kemi raste kur Gjykata Kushtetuese ka shkarkuar presidentë për shkelje të Kushtetutës.

Në këtë moment kur kemi shkelje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese e njëjta vlen. Prandaj, konsideroj se të gjithë ata që s'i përgjigjen ligjit, që si përgjigjen Kushtetutës ose që nuk zbatojnë vendime të Gjykatës Kushtetuese duhet të japin përgjegjësi. Prandaj, kjo temë duhet të mbyllet dhe të fillojë menjëherë zbatimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pasi që këtë temë e kemi debatuar edhe njëherë u detyrova edhe për shkak punëtorëve, mirëpo edhe tentativa që vërtet i jepet kahe politike këtij debati edhe pse nga vetë parashtruesi ishte kërkesa që mos të shndërrohem në vlerësime politike.

Sido që të jetë, dy çështje dua t'i potencoj këtë rast. Agjencia Kosovare e Privatizimit është institucion i themeluar nga ky Kuvend dhe raportet e punës aprovohen në këtë Kuvend dhe asnjëherë në Qeveri. Edhe pse po tentohet që të luhet me këtë kartë nga AKP-ja në Qeveri me qëllim që ndokush ndoshta mendon që mund të përfitojë edhe poenë politik në këtë çështje.

U fol edhe për sherrin në këtë proces edhe për politizimin e rastit të punëtorëve të Fabrikës së Tubave në Ferizaj. Si duket vërtet sot këtij politizimi nuk është e mundur t'i ikëm, vërtet a thua vetëm kryeministri i paska takuar punëtorët e Fabrikës së Tubave apo i kanë takuar edhe tjerët, vërtet që kryeministri i ka takuar edhe u ka premtuar zgjidhje dhe tërë ajo çka po mundohet edhe unë si përfaqësues i pozitës këtu është që vërtetë ta kanalizojmë zgjidhjen dhe ta orientojmë zgjidhjen e problemit të punëtorëve të Fabrikës së Tubave të Ferizajt.

Kur kemi debatuar për raportin e AKP-së vetëm dua t'u tërheq vëmendjen se ka qenë një nga vërejtjet më themelore për arsye se bordi i AKP-së, bordi i drejtorëve të AKP-së ka prekur Fondin e mirëbesimit për disa projekte të tjera dhe pasi që është një rast ku vërtet bordi i drejtorëve të AKP-së ka prekur nga Fondi i mirëbesimit, atëherë sigurisht me vendimin e këtij Kuvendi, me rekomandimet e këtij Kuvendi do të orientohej AKP-ja për arsye se AKP-ja i përgjigjet këtij Kuvendi dhe ky Kuvend mund ta orientojë problematikën në AKP se nga ato mjete të fillojë dhe sigurisht se pa filluar nuk mundet edhe të përfundojë një proces edhe është keq të manipulohet me tema fillim dhe mbarim se një proces duhet të fillojë që të mbarojë pastaj dhe jo më të luhet me shifrat edhe një pagesë do fillojë menjëherë dhe do përfundojë me borxhin total.

Kjo është më se e vërtetë dhe më se e qartë. U tha që duhet të jemi të singertë ose nuk do të duhej të jemi të singertë, vërtet kjo çka po më ndodh sot është një sinqeritet për zgjidhjen e problemit. Jo i sinqertë ishte debati i kaluar për Fabrikën e Amortizatorëve ku kërkohet pezullimi i një privatizimit të një ndërmarrje, por jo ndërmarrjeve që i kanë privatizuar deputetët e "Vetëvendosjes".

U tha edhe për fabrikën, ku kanë mbetur mjetet e Fabrikës së "Zastavës" kush e ka privatizuar Fabrikën e "Zastavës"?

KRYETARI: Në rend dite, në rend dite.

BEKIM HAXHIU: A është Florin Krasniqi privatizues i "Zastavës"? Ky është josinqeriteti i cili po shitet këtu. A është privatizuesi, a është deklaruar publikisht Florin Krasniqi që vetëm nëse do ta shiste Fabrikën e "Zastavës" në Pejë për skrap, do të përfitonte trefishin

e asaj të cilin e ka dhënë në çmim. Pse s'kërkohet pezullim edhe i fabrikës "Zastava" në Pejë?

Ky është josingheriteti, nëse ne sot kemi organizuar një debat dhe për arsye se debati i kaluar nuk ka dhënë ndonjë rezultat, atëherë po duam ta orientojmë zgjidhjen e problemit, për arsye se ndoshta edhe juristët më të mëdhenj këtu nganjëherë nuk e marrin guximin të flasin drejt, vendimi i Gjykatës Kushtetuese e ka vu një sherr në këtë hile dhe në këtë proces, për arsye se ka orientuar zgjidhjen problemit në dy vende edhe në AKP edhe në Qeveri.

Momenti që është adresuar zgjidhja në dy institucione, të cilat sigurisht që nuk do të mund ta zgjidhnin të dyja njëkohësisht, mirëpo sikur edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese të ishte më preciz dhe të orientohej vërtet zgjidhja në AKP, besoj që ky problem do të ishte zgjidhur. Ajo çka po kërkohet sot me anë të këtij debati është që vërtet të orientohej zgjidhja në AKP, Fondi i mirëbesimit nga bordi i AKP-së është prekur nga vetë bordi i drejtorëve dhe po kërkohet që të fillohet me pagesa dhe sigurisht kur të fillohet do përfundojë ky proces deri në fund. Faleminderit!

KRYETARI: Diskutuesi i fundit është deputeti Nijazi Idrizi, nëse mund konkretisht për temën, të mos dalim jashtë saj.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Do të përpiqem të mos i përsëris gjërat që u thanë. Kompensimi i punëtorëve nuk është një çështje që duhet të diskutohet për shkak se ky është një akt i kryer dhe i vulosur nga Gjykata Kushtetuese.

Me sa jam në dijeni, edhe AKP-ja është e gatshme t'i paguajë punëtorët për pjesën me të cilën ajo i disponon ato para për 3 milionë, ndërsa pjesën për 23 milionët ajo nuk i ka dhe siç jam në dijeni ajo nuk mund t'i gjejë që t'i paguajë.

Këto para ajo mund t'i paguajë në vetëm në rastin kur të emërohet edhe një drejtor, një anëtar i bordit i cili është ndërkombëtar dhe mungon. Për mua është me interes të theksohet fakti se Gjykata Kushtetuese, me marrjen e vendimit për rastin e punëtorëve të Ferizajt, Fabrikës së çelikut ka hapur rrugën e njohjes së të drejtave për kompensimin të dhjetëra-mijëra punëtorëve tjerë të larguar dhunshëm nga puna në vitet e '90-ta nga regjimi i atëhershëm, të cilëve iu ka krijuar mundësia që ata të parashetrojnë kërkesat për njohjen e të drejtave të kompensimit.

Pasi që punëtorët kanë realizuar në një formë me proces gjyqësor fitimin e humbur siç quhet të tyre të disa viteve, tani akt gjykimi i Gjykatës Kushtetuese për t'ua njohur të vullnetin e atyre ka përcaktuar një precedent gjyqësor dhe ekziston mundësia e parashtrimit të kërkesave edhe të një numri të madh të punëtorëve që kap shifrën në disa miliarda euro, të cilat unë mendoj që Kosova nuk i ka.

Unë jam skeptik se a do të ketë mundësi buxheti dhe Qeveria e Kosovës që të përballët me shumica të tilla të parave, të cilat me të vërtetë janë të larta. Në aspektin buxhetor konsideroj se kjo është e papërballueshme për rrethanat aktuale të Kosovës. Ky

kompensim do të duhej që të bëhej nga Serbia, sepse ajo e ka vendosur gjendjen e jashtëzakonshme në atë kohë dhe i ka larguar punëtorët nga puna.

I ftoj institucionet e Kosovës që në procesin negociator që aktualisht po zbatohet, ta shtojnë këtë kërkesë për 100 mijë punëtorët, të cilët janë larguar nga puna e të cilat i kanë fitimet e tyre të humbura për të cilët ata duhet të kompensohen.

Njëkohësisht, u bëj thirrje rreth 100 mijë punëtorëve të diskriminuar të Kosovës, që t' i ndjekin rrugët ligjore për fitimin e të drejtës së tyre e cila e drejtë u takon për shkak se ata kanë humbur fitimin e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: Nuk kemi të lajmëruar për diskutim. Tani kemi një vendim prej pesë pikave, por kemi edhe një dallim mes grupeve parlamentare pa hyrë në këto vendime të gjykatave, a janë të drejta a s'janë të drejta, mendoj që Kushtetuta e thotë shumë qartë atë që duhet thënë. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.

S'ka tjetër shpjegim për këtë çështje.

Ne s'po kërkojmë kurrigjë tjetër, s'po ndërhyjmë në organet tjera, por po kërkojmë përmbarimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që është obligativ për institucionet përkatëse.

Ndoshta dalja më e mirë nga kjo çështje, nga kjo seancë dhe nga pika e rendit të ditës është që Kuvendi në këtë seancë rikonfirmon rekomandimin e 21 shkurtit 2013 dhe citohet rekomandimi i 21 shkurtit dhe ne e votojmë këtë. Mendoj që do të ishte dalja më e mirë nga kjo situatë.

E ka fjalën kryetari i Komisionit për Legjislacion , deputeti Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Mendoj se është ide interesante, por praktika e rikonfirmimit të vendimeve të Kuvendit është praktikë e jashtëligjshme, sikur të themi tash ne e rikonfirmojmë Kushtetutën. Vendimi i Kuvendit është vendim i plotfuqishëm edhe është fuqi.

Nëse do ta anulojë dikush është çështje tjetër që e anulon, por ta rikonfirmojë Kuvendi unë nuk e di pse ka nevojë Kuvendi t' i rikonfirmojë vendimet e veta. Është votuar, është vendosur, ju e keni nënshkruar, është në fuqi, çka të rikonfirmojmë ne. Pse ta rikonfirmojmë një vendim? Nëse dikush do ta rrëzojë atë vendim, e ta nxjerr një vendim tjetër, atëherë le të thotë që rrëzohet vendimi i parë, nxirret vendimi tjetër.

Përndryshe mendoj se është gabim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Por, derisa rekomandimi ka thënë për t'u realizuar për katër muaj dhe jemi edhe një vit, unë mendoj që për të mos u marr me pikat tjera ia vlen ta themi Kuvendi edhe njëherë e rikonfirmon të njëjtën gjë sikur të ishte realizuar s'kemi

pasur nevojë për ta rikonfirmuar, por derisa nuk është realizuar unë mendoj një dalje më e mira është kështu.

Propozuesi a pajtohet me atë çka kërkon? Ne e kemi një rekomandim, për të njëjtën çështje është fjala. Deputeti Ilmi Reçica e ka fjalën.

ILMI REÇICA: Nuk është çështje e letrave se unë ata burra i takoj çdo javë, ndoshta një pjesë e këtyre i kanë takuar njëherë në jetë. Se unë jam prej Ferizajt dhe çdo të hënë i takoj rregullisht, jashtë ditëve tjera, plus i takoj anëve tjera.

Dhe duhet pasur parasysh këtë kur secili e jep një mendim ose gjykon për diçka. Esenca është që rekomandimet të cilat janë miratuar nga ky Parlament, më 21 shkurt të vitit të kaluar, e kanë renditjen e kundërt. Këtu çka po kërkohet me këtë vendim të cilin do ta lexoj tash, kërkohet që vërtet në bazë të aktgjykimit sqarues të Gjykatës Kushtetuese që është i datës 12 maj 2011, saktësohet që AKP-ja është trashëguese e AKM-së dhe është përgjegjëse për zbatimin e atyre vendimeve.

Është edhe një vendim, faktikisht i Gjykatës Kushtetuese se edhe ata nuk e kanë gjykuar rastin e parë tamam siç duhet, pastaj e kanë dhënë sqarimin, dhe do ta lexoni edhe sqarimin edhe dy aktgjykimet të cilat i ka prurë Gjykata Kushtetuese dhe konform kësaj nëse i rivotojmë edhe njëherë ose i rikonfirmojmë, zoti kryetar, ato rekomandime të vitit të kaluar, e njëjta situatë do të jetë, esenca është që në bazë të sqarimit, aktgjykimit sqarues të Gjykatës Kushtetuese, AKP-ja është përgjegjëse për atë.

Qeveria nuk mund t'i ikë përgjegjësisë, se Qeveria është pjesë e kësaj përgjegjësie, mirëpo gjithë çështja që ka të bëjë këtu, esenca e kësaj është ku duhet të merren paratë nga cili pozicion buxhetor? Dhe, kushdo që të jetë kryeministër, kushdo që të jetë në Qeveri, pavarësisht premtimeve që i kanë bërë dhe pavarësisht lajkave, të cilat i kanë treguar, do të kenë problem ta zbatojnë këtë vendim ashtu siç është.

Nëse Agjencia Kosovare e Privatizimit obligohet që nga fondi dhe kur të them nga Fondi i Mirëbesimit dhe fillimi i tij, njerëzit kanë prirje t'i shohin gjërat krejt mbrapsht, unë jam marrë vesh me ata që përfaqësojnë 912 punëtorë. Nuk i kërkojnë 25 milionë e 26 milionë t'i marrin në xhep menjëherë, janë të gatshëm që në faza të caktuara qysh të merren vesh me atë që do t'i japë paratë që në faza të caktuara, afate kohore të caktuara, t'i marrin ato para.

Dhe këtu e ka atë kufirin që të fillohet, të fillohet me realizim dhe kjo është ajo çështje që është bërë në marrëveshje me ta. Është esenca që secili njeri tash ndoshta nisat nga vetvetja dhe sheh gjithçka mbrapsht. Angazhimi është shumë konkret dhe shumë i sinjertë dhe është i bazuar në të gjitha vendimet. Unë, kryetar, nëse bën po i lexoj ato çka i kam si vendim faktikisht të këtij Kuvendi, kanë qenë si rekomandime, por në bashkëpunim me përfaqësuesit e punëtorëve jam marrë vesh që ky të titullohet si vendim. Nëse më lejohet unë i kisha lexuar dhe i kisha kërkuar nga të gjithë deputetët. Kërkova edhe në fillim që mos të politizohet ky rast. Është rast i pastër, është rast i qartë dhe nuk

duhet t'i lidhim ato çështje se kush është në qeverisje dhe kush është në opozitë, mendoj kjo çështje shumë konkrete.

Nëse më lejohet, unë do t'i kisha lexuar këto.

KRYETARI. Lexoji, por ta dimë që fjalën “politizim” po e përdorni gabim, çdo debat është politik edhe vendimet janë politike dhe s'mund t'i ikim as politikës, as politizimeve.

Prandaj, të gjithë nga pak këtu po bëjmë një lojë fjalësh. Lexoji vendimet...

ILMI REÇICA: Kërkoj fjalën, kam menduar gjithmonë dhe po mendoj në politizimin negativ të kësaj çështje, më fal! Do të thotë unë po e lexoj një vendim të cilin e kemi përpiluar si grup parlamentar dhe pastaj kisha kërkuar që të gjithë deputetët ta votojnë këtë. Është në interes dhe të mirën e zbatimit të atyre vendimeve dhe unë besoj që punëtorët ose përfaqësuesit e punëtorëve presin këtë nga ne.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, pas përfundimit të debatit për zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. Ref. AGJ 75/ 10 të datës 17 dhjetor 2010, për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj, C nr. 304 / 2001 i datës 11 janar 2002 që ka për qëllim kompensimin e punëtorëve të Fabrikës së çelikut IMK Ferizaj, miraton këtë vendim: vendim thotë:

1. Detyrohet Agjencia Kosovare e Privatizimit AKP që nga Fondi i mirëbesimit të fillojë kompensimin e punëtorëve të Fabrikës së çelikut IMK në Ferizaj në bazë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës NR. Ref AGJ 75 / 10 të datës 17 dhjetor 2010.
2. Detyrohet Agjencia Kosovare e Privatizimit që 15 ditë pas miratimit të këtij vendimi të detyrueshëm të hartojë dhe miratojë kornizën kohore dhe planin për dinamikën e kompensimit të punëtorëve të Fabrikës së çelikut IMK në Ferizaj.
3. Obligohet Qeveria e Republikës së Kosovës të miratojë zbatimin e këtyre rekomandimeve ose këtij vendimi në këtë rast dhe të marrë të gjitha masat ligjore për lehtësimin e këtij zbatimi.
4. Obligohet AKP-ja, Qeveria e Republikës së Kosovës ta informojë Kuvendin e Kosovës në mënyrë periodike për dinamikën e zbatimit të këtij vendimi.
5. Ky vendim ka karakter detyrues dhe hyn në fuqi ditën e miratimit në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kryetar, këto janë propozimet pastaj seanca le të vendosë.

KRYETARI: E shfave të grupeve parlamentare, por nëse ia leni krejt përgjegjësinë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duhet ta dini sa është shitur ajo fabrikë, ose ato dy fabrika dhe nëse ia lëmë asaj, rezultati po dihet cili është.

E ju e dini se sa është shitur ajo dhe si është shitur. Fjalën e ka deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Kryetar, e keni thënë edhe në fillim dhe e përsërisim edhe njëherë, ne nuk i mbështesim këto rekomandime që u lexuan tani, ndërkaq edhe vendim nëse është, ne e mbështesim dhe do ta votojmë atë që e formulat ju. Dhe aty afat nuk ka as 2 javë, as 3 javë, por të obligon menjëherë, bile i ka dal edhe afati kësaj pune që një kohë.

Prandaj, nuk pranojmë diçka tjetër përpos asaj nëse duhet të rikonfirmohet rekomandimi i 21 shkurtit dhe obligohen konform këtij rekomandimi të ekzekutohet vendimi menjëherë dhe këtu nuk asgjë tjetër. Ne këtë riformulim, gjegjësisht rekomandim që ju e thatë, që e lexuat, e votojmë, për këto tjerat nuk marrim pjesë në votim dhe nuk i përkrahim.

KRYETARI: Visar, e ke fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm edhe njëherë për ta qartësuar se për çka po flasim se po shihet që fatkeqësisht parashtruesi nuk e ka idenë se as çfarë kërkesë ka sjell në Kuvend, as që kërkojnë punëtorët e as si zbatohet kjo.

Edhe njëherë, punëtorët nuk është se nuk e kërkojnë 25-milionëshin, punëtorët e kërkojnë krejt atë që u takon me ligj. Mos thoni që punëtorët e kanë ndryshuar mendjen edhe tash po i duan veç do pak para, sepse punëtorët, priti që ku i ke lart, ata thonë 25 milionë euro na i ka borxh, plus kamata 3%. Pra, mos ua ndryshoni qëndrimin punëtorëve.

E dyta, prapë po e them paratë që janë gjeneruar nga shitja e Fabrikës së Tubave janë 3 milionë e 650 mijë, maksimalisht AKP-ja mund t'i japë aq, për këtë çështje, maksimalisht nëse vendos t'i japë të gjitha, sepse ato janë para me të cilat do të paguan kreditorët e ndërmarrjes, kështu është procesi i privatizimit, ligjërisht kështu ka funksionuar dhe funksionon në Kosovë.

Dhe, çështja tjetër e treta, është që ne një vendim e kemi marrë këtu në Kuvend edhe ne mendojmë se duhet t'i mbesim besnik atij vendimi që është marrë vitin e kaluar, pra nëse hidhet në votim formulimi që paraqitët ju, zoti kryetar, ne jemi për, përndryshe mendojmë që këto rekomandime jo vetëm që duan ta prolongojnë çështjen, por për më keq janë edhe mashtrim, prapë po e them, mashtrim ndaj punëtorëve edhe jemi absolutisht kundër këtyre.

KRYETARI: Ardian, e ke fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe propozimi im ishte i njëjtë me atë që thatë ju, e mira e së mirës do të ishte që Kuvendi ta rikonfirmojë vendimin e vet para një viti e dy dite.

Çështjet tjera nuk mendoj se janë rregull. Ne nuk e kemi në plan të futemi në këtë lojë që nuk e kemi nisur vetë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit, Myzejane e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe në fillim të fjalimit unë e thashë se në rast se prapëseprapë vendoset që të votohet ai rekomandim se ne e kemi një rekomandim të nxjerrë në shkurt të vitit 2013, ne jemi të votojmë dhe prapë të konfirmohet ai rekomandim i Kuvendit.

Nuk e di tjetër çka mund të bëjmë. Këtu është problemi.

KRYETARI: Faleminderit!

Tani po të shkojmë sipas radhës duhet t'i votojmë vendimet që i ka propozuesi. Por, unë kisha kërkuar nga propozuesi - a pajtohet me shumicën e kryetarëve të grupeve parlamentare? Fjalën e ka Adem Grabovci.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është shumë e vërtetë se e ka shqyrtuar me hollësi këtë çështje, sepse është një çështje serioze kemi të bëjmë me punëtorët dhe me familjet e tyre, kemi të bëjmë me një vendim të Gjykatës Kushtetuese i cili është i pakontestueshëm për ne dhe ai patjetër duhet të ekzekutohet.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike është dakord që me propozimin tuaj që ne të dalim me një rikonfirmim të vendimit të mëhershëm që ka qenë, por të kërkojmë vërtet zbatimin e tij dhe punëtorëve t'u jepet, t'u ndahen sa më parë mjetet që u takojnë. Faleminderit!

KRYETARI: E ka fjalën Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Unë mendoj që u thanë të gjitha, sepse është hera e dytë që trajtohet, është mirë që të gjendet formulimi që e pranojnë të gjithë dhe intenca e të gjithëve që të realizohet një e drejtë e fituar me Kushtetutë.

Në këtë rast meqë një mendim tillë ky Kuvend e ka marrë edhe para një viti, thuaja para viti, dhe s'mund të ofrojmë kurrgjë tjetër specifikisht si Kuvend, sepse Kuvendi rekomandon, merr vendime, por nuk realizon, nuk e ka në dorë ta realizojë atë punë, atëherë duhet ta ruajnë pak a shumë atë formulim që tash po e pranojnë të gjithë veçse ta ketë një precizim të saktë, një saktësim që të thuhet që rikonfirmohet vendimi i marrë me datën këtë, këtë dhe kërkohet fillimi i menjëhershëm i realizimit të tij dhe jepet teksti. Unë besoj që kjo është saktësisht ajo që po kërkojmë të gjithë me këtë formulim.

Unë mendoj që kjo mund të votohet prej të gjithëve. Faleminderit!

KRYETARI: Pra, të jemi të qartë çka po votojmë. Unë mendoj që do të ishte, Kuvendi në mbledhjen e sotme rikonfirmon rekomandimin e 21 shkurtit 2013, thuhet rekomandimi, mbyllet rekomandimi dhe i shtohet: "Kuvendi kërkon realizimin e menjëhershëm të këtij rekomandimi". A jeni dakord?

Atëherë, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash.

Prani fizike janë 83 deputetë, me elektronikë 96. Konstatohet që me 72 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim Kuvendi e miratoi rekomandimin.

Shkojmë në votim menjëherë të rekomandimeve që i keni me shkrim nga debati i mëparshëm. Unë po i lexoj këto rekomandime që të shënohen në procesverbal, ose këto votohen një nga një.

Atëherë, pasi i keni marrë të gjithë fillojmë, këto janë tri rekomandime, rekomandimet i votojmë veç e veç.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim për rekomandimin e parë për formimin e Komisionit Hetimor, është fjala për, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Për rekomandimin e parë kanë votuar për 41 deputetë, kundër 18, 8 janë abstenime, pra miratohet.

Vazhdojmë, kemi rekomandimin e dytë e keni përpara. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash. Konstatohet se me 48 dhe një me ngritje dore 49 vota për, 13 kundër, 10 abstenime, miratohet rekomandimi i dytë.

Dhe tani votojmë rekomandimin e tretë. Votojmë tash. Konstatohet se me 17 vota për, 51 kundër, 4 abstenime, nuk miratohet rekomandimi i tretë. Dhe një ngritje dore 18 për, por nuk votohet rekomandimi i tretë.

Janë votuar dy rekomandimet e para.

Kuvendi pra, miratoi dy rekomandimet e paraqitura nga deputeti Visar Ymeri lidhur me procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës.

Vazhdojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Raporti i Qeverisë së Kosovës për ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

Ministrja e Integrimeve Evropiane, Vlora Çitaku, ka paraqitur kërkesën për ta njoftuar Kuvendin e Republikës së Kosovës lidhur me ecurinë në procesin e negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kryesia e Kuvendit ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të përgatitë një informatë lidhur me këtë çështje dhe Kuvendit t'ia paraqesë këtë informatë. Qeveria e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka dërguar informatën e kërkuar. Ftoj ministren Vlora Çitaku, në emër të Qeverisë së Kosovës, ta paraqesë këtë informatë.

Fjalën e ka ministrja e Integrimeve Evropiane, Vlora Çitaku.

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kam kënaqësinë që sot të raportoju për jush lidhur me procesin e negociimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Nisja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian, është moment historik në kuadër të procesit integruar të vendit tonë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit do të jetë marrëveshja e parë kontraktuale që ofron perspektivë të qartë drejt anëtarësimit të plotë të Kosovës në Bashkimin Evropian. Qëllimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është ofrimi i kornizës politike dhe ligjore që do të rregullojë procesin e përafrimit dhe anëtarësimit të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Marrëveshja do të jetë bazë ligjore për të gjithë hapat e radhës së Kosovës në kuadër të procesit integruar në BE. Në kuadër të MSA-së Kosova dhe Bashkimi Evropian do të bëjnë zotime të ndërsjella, në njërin anë, vendi ynë për të ndërmarrë reforma edhe më të thella dhe në anën tjetër, Bashkimi Evropian, do të ofrojë mundësi reale për anëtarësim.

Është inkurajuese se para nesh kemi një agjendë ambicioze për një marrëveshje që do t'i përfshijë të gjitha elementet tradicionale të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit sikurse edhe për vendet tjera të rajonit, përfshirë dialogun politik, aspektin tregtar, politikat e bashkëpunimit, pjesët që kanë të bëjnë me drejtësi, liri dhe siguri, si dhe një sërë çështjesh tjera të rëndësishme.

Strukturën negociuese për MSA, si dhe strukturën e përmbajtjes së Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe detajet e titujve i gjeni në raportin, të cilin ua kam dërguar kohë më parë. Më 28 tetor të vitit të kaluar është mbajtur takimi i parë zyrtar në nivel të kryenegociatorëve. Kjo ka shënuar fillimin e negociimit të MSA-së.

Negociatat kanë filluar me hapjen e titujve më kompleks të MSA-së, gjegjësisht titujve 4, 5 dhe 6. Raundi i dytë i negociatave ka vazhduar me takimin që është mbajtur më 27 nëntor. Gjatë takimit janë hapur për negociim: titulli 1, 3, 7, 8, 9 dhe 10. Me përfundimin e raundit të dytë janë hapur të gjithë titujt për negociimin e MSA-së, përveç titullit të dytë që flet për dialogun politik i cili do të hapet gjatë takimit të tretë të kryenegociatorëve.

Gjatë muajit dhjetor dhe janar janë mbajtur takimet e grupeve punuese negociatore, ndërkohë që gjatë muajit shkurt do të mbahen takimet e radhës së grupeve teknike me ç' rast presim dakordimin e të gjitha detajeve teknike të MSA-së. Presim që takimi i tretë dhe i fundit të mbahet në fund të muajit shkurt të vitit 2014. Kjo do të shënonte edhe përfundimin e procesit negociator dhe në pranverë të këtij viti pritet edhe vendosja e inicialeve në MSA.

Pas përfundimit të procesit negociator të MSA-së, teksti i MSA-së do ta fillojë procesin zyrtar të miratimit në Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian, po ashtu edhe në Parlamentin e Kosovës.

Shfrytëzoj rastin t'i falënderoj të gjitha institucionet, partitë opozitare, shoqërinë civile dhe të gjithë të tjerët që me përkushtim kanë kontribuar në negociimin e deritanishëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit, fjalën e ka deputetja Blerta Deliu- Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuara ministre,

Nisja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit padyshim që do të thotë përbën Marrëveshjen e parë kontraktuale ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, por gjithsesi duhet të kuptohet se paraqet vetëm fillimin e një procesi të gjatë. Do të thotë, pas studimit të fizibilitetit janë identifikuar edhe kriteret afatshkurtra që janë përmbushur e pas tyre janë përcaktuar edhe kriteret afatmesme në mënyrë që të merren përsipër obligimet që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim-Asociim e që lidhen me sundimin e ligjit, me gjyqësorin, me Administratën Publike, me reformën zgjedhore, me të drejtat e njeriut, me mbrojtjen e minoriteteve, tregtinë, tregun e brendshëm, si dhe veterinën e shumë specifika të tjera.

Si pjesë përbërëse të Planit të Veprimit të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim janë kriteret politike, kriteret ekonomike, si dhe standardet evropiane. Do të thotë, gjatë kësaj kohe vlen të përmendet edhe bashkëpunimi konstruktiv i Komisionit për Integritet me ministrin e Integritetit Evropian, për t'i përmbushur kriteret, por edhe për t'i përafruar qëndrimet ndërmjet Kuvendit dhe ekzekutivit për përputhjen e do të thotë legjislativitetit me 'acquis communautaire'.

Ndërsa, sa i përket punës së Kuvendit është vlerësuar Rezoluta për dialogun për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, pastaj numri i rritur i debateve parlamentare që kanë qenë në Kuvend, si dhe interpelancat e shumta që janë organizuar brenda Kuvendit. Edhe më tutje për tu përafruar drejt Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit sa i përket punës së Kuvendit, vazhdon të mbetet sfida pavarësia buxhetore e Kuvendit, e kemi thënë disa herë në seancat e Parlamentit Komisioni për Integritet Evropian, ndërkaq sa i përket punës së Qeverisë, Qeveria ka miratuar strategjinë legjislative, por duhet të përmirësojë bashkëpunimin ndërmjet Kuvendit sa i përket legjislativitetit me 'acquis communautaire'.

Sa i përket Administratës Civile është kompletuar korniza ligjore për implementim të Ligjit për shërbyesit civilë, për Ligjin për shërbyesit do të thotë për pagat e shërbyesve civilë, është siguruar dhe hapësira e shumë kërkuar dhe pavarësia financiare Avokatit të Popullit që ka qenë edhe një kërkesë e Raportit të Progresit për Kosovën. Po ashtu sa i përket shoqërisë civile është përfshirë në task-forcën për Integritet Evropian, si dhe Këshilli Kombëtar për Integritet Evropian.

Kërkohet që shoqëria civile të jetë e përfshirë do të thotë edhe në konsultimet publike, veçanërisht tek ministrat, si dhe të forcohet Këshilli Kombëtar për bashkëpunim Qeveri dhe shoqëri civile.

Kemi edhe tek pavarësia e gjyqësorit, do të thotë mbetet kusht kryesor për sundimin efikas të ligjit në Kosovë. Po ashtu, rastet në gjykata kanë filluar që të ulen, por kërkohen që të kompletohen edhe anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Lufta kundër korrupsionit, kërkohet kornizë ligjore në këtë fushë edhe pse kjo kornizë ligjore është kompletuar, është amendamentuar Ligji për financim të partive politike në të cilën është inkorporuar do të thotë si vepër penale konflikti i interesit dhe do të thotë deklarimi i pasurisë nga zyrtarët publik.

Ky Plan i Veprimit do të thotë parasheh plotësim- ndryshim të Ligjit për deklarim, të prejardhjes, si dhe kontroll të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe Ligjit për parandalim të konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik. Do të thotë, janë një varg sfidash dhe një varg kriteresh që ne duhet t'i përmbushim bashkarish që Marrëveshja Stabilizim-Asociimit të jetë më e kapshme për të gjitha institucionet e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e ka fjalën deputetja Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Në radhë të parë dua të theksoj që Lidhja Demokratike e Kosovës vazhdimisht ka përhëndetur hapjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, natyrisht që konsiderojmë që është një vendim shumë i rëndësishëm për Kosovën, mirëpo u takon institucioneve të Kosovës po ashtu që ta marrin me shumë seriozitet secilën pikë dhe secilin kriter të paraqitur në radhë të parë në Planin e Veprimit që e kanë hartuar vetë institucionet e Kosovës në mënyrë që këto kriterë të plotësohen, por edhe të negociohen me kohë.

Ministrja këtu sot, sipas agjendës së miratuar në Kryesi, thuhet që raporton, pra nuk paraqet vetëm informatë, por raporton lidhur me procesin e negocimit të MSA-së, kështu që prezantimi im në fakt do të fokusohet në disa pyetje për ministren, të cilat shpresoj ajo do të ketë mundësi t'i sqarojë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës lidhur me këtë proces kaq të rëndësishëm.

E para, ministrja deklaroi se MSA-ja do të jetë Marrëveshja e parë kontraktuale me BE-në, e cila citoj: “ofron perspektivë të plotë të Kosovës për anëtarësim në BE”. Kjo çështje është diskutuar disa herë, sepse edhe në Rezolutën e fundit të Parlamentit Evropian, thuhet që fatkeqësisht MSA që i është ofruar Kosovës është ndryshe nga ajo që u është ofruar vendeve të tjera.

Pra, pres nga ministrja ta sqaroj çka nënkupton kjo në radhë të parë? Pra, përveç përmbajtjes e cila shihet që është e njëjtë me MSA-të e vendeve të tjera çka do të

nënkuptojë procedura ndryshe që është paraparë në rastin e MSA-së për Kosovën, sa i përket ofrimit të perspektivës së plotë për anëtarësim? Pra, kjo procedurë ndryshe e cila për herë të parë edhe po përdoret në rastin e Kosovës, a do të ketë ndonjë implikim në hapat e mëtejme që pritet që Kosova të marrë drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian?

Gjithashtu, në dokumentin që është dorëzuar nga Ministria përmendet që qëndrimi konstruktiv i Republikës së Kosovës në dialogun me Serbinë ka qenë një ndër parakushtet kryesore që është vlerësuar para se të fillojnë negociatat me MSA-në. Pyetja ime për ministren është, në qoftë se në procesin e negocimit të deritanishëm është kërkuar edhe më tej konstruktivitet, në mënyrë që të premtohet nënshkrimi i MSA-së me kohë, pra ashtu siç është thënë në pranverën e këtij viti.

E treta, në materialin që është dërguar flitet edhe për prioritetet e identifikuara në studimin e fizibilitetit, pyetja ime është në qoftë se ka pasur vërejtje nga ana e Qeverisë së Kosovës lidhur me prioritetet e identifikuara dhe nëse po cilat kanë qenë ato vërejtje dhe u janë paraqitur ato ekipeve me të cilat është negociuar?

E katërta, kam mjaft pyetje, cila është pritshmëria e Qeverisë së Kosovës lidhur me afatin e përfundimit të negociatave dhe pas kësaj pas ratifikimit të MSA-së në Parlament, shpresoj që ministrja ta sqarojë çështjen që po diskutohet shumë rreth hyrjes në fuqi të MSA-së dhe pse duhet kohë më shumë për hyrjen në fuqi, në qoftë se duhet kohë më shumë a është kjo e mirë apo është diçka e keqe për Kosovën?

Dhe së fundi, në fakt nga materiali i dërguar ka shumë pak informata lidhur me detajet se çka është negociuar dhe cilat kanë qenë vendimet përfundimtare në këtë proces negociator, pra për çfarë kanë rënë dakord ekipet, cilat kanë qenë qëndrimet fillestare të palëve dhe si është arritur deri tek qëndrimet përfundimtare?

Duke qenë ky një proces negocimi, pra sa ka arritur Ekipi Negociator i Kosovës, jo vetëm ekipi i ekspertëve, por edhe lidhshipi politik që të mbrojë interesat e Kosovës, veçanërisht me tre kapitujt e parë që janë negociuar. A ka efekte financiare nga përfundimi i negocimit të këtyre tre kapitujve, nëse po - cilat janë ato? A ndikojnë në rritjen apo uljen e të hyrave doganore apo tatimore dhe, nëse po, si mendon Qeveria e Kosovës ta rikuperojë mungesën e këtyre të hyrave? Ku do t'i gjejë këto të ardhura? A ndikon kjo marrëveshje në marrëveshjet e tjera të tregtisë së lirë me vendet, me të cilat Kosova tashmë ka të nënshkruara marrëveshje?

Pra, këto janë disa prej çështjeve për të cilat shpresoj që ministrja do ta shfrytëzojë mundësinë që t'i sqarojë para deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Një çështje që desha ta sqaroj në cilësinë e kryetares të Komisionit për Integritet Evropian është që materiali nuk është trajtuar në komision, ndoshta do të ishte praktikë më e mirë në të ardhmen që para se të vijë në seancë, paraprakisht të trajtohet në komision, në mënyrë që komisioni ta japë rekomandimin e vet dhe, përfundimisht, në fund të këtij debati, apo raportimi, të votojmë diçka, apo të miratojmë diçka, që të mos jetë vetëm një informatë e thjeshtë, meqenëse është një proces jashtëzakonisht i rëndësishëm. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, nënkryetari Glauk Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: I nderuar kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është një proces me shumë rëndësi në kuadër të konceptit të integriteteve evropiane. Përmbushja e kriterëve dhe e kapitujve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është parakusht i domosdoshëm që shteti të hyjë në rrugën e anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian. Por, unë desha t’i ngre tri çështje që kanë të bëjnë me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, sidomos në rastin e Kosovës.

E para ka të bëjë me atë që mbetet problemi kryesor i MSA-së për Kosovën dhe me këtë rast duhet të shtrohet pyetja se cilët kanë qenë faktorët kryesorë që e kanë pasur ndikimin e tyre vendimtar, që Kosova, më në fund, t’i nisë negociatat për këtë marrëveshje.

Ne jemi dëshmitarë se si Raporti i Progresit i Komisionit Evropian ngre shqetësime të ndryshme sa i përket funksionimit të drejtësisë dhe të demokracisë në Republikën e Kosovës. Aty madje thuhet se drejtësia vuan edhe nga ndërhyrjet politike në Gjyqësor, kurse dihet fare mirë se drejtësia dhe sundimi i ligjit, në anën tjetër, përbëjnë kapitujt kryesorë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Atëherë, nëse në Kosovë ka probleme shumë serioze sa i përket sundimit të ligjit, çka ndikoi që Bashkimi Evropian të na shpërblejë me fillimin negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit? Dhe, këtu më duhet të them se arsyeja kryesore që nisi ky proces ka të bëjë shumë më shumë me zemërgjerësinë e paskajshme që e ka treguar Qeveria jonë në negociata me Serbinë, e cila u përkthye në koncesione dhe lëshime kapitale, të cilat mund të gjenden në Marrëveshjen e 19 prillit të vitit të kaluar me Serbinë.

Pra, ky është defekti kyç, kisha për të thënë, i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit në rastin e Kosovës, sepse në ecjen tonë drejt Bashkimit Evropian ne po vlerësohemi se në ç’masë janë bërë kompromise ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, e ky do të thosha që është pikëvështrimi i Departamenti për Siguri dhe Politikë të Jashtme i Bashkimit Evropian.

Ky pikëvështrim e nënvendos Kosovën në mënyrë instrumentale ndaj integritetit më të përshpejtuar të Serbisë në Bashkimin Evropian. Kjo është arsyeja pse departamenti të zonjës Eshton shumë më pak i intereson demokracia apo sundimi i ligjit në Kosovë, por mbi të gjitha i intereson stabiliteti rajonal, që pretendohet se arrihet atëherë kur më shumë përmbushen interesat e Serbisë, e cila vlerësohet më e fuqishme dhe me më shumë ndikim në rajon, se sa të plotësohen interesat e Kosovës, e cila vlerësohet më e dobët.

Në anën tjetër, komisionari për Zgjerim, Shtefan Fyle, e mbani në mend se kur u drejtua këtij Kuvendi të Republikës së Kosovës në korrik të vitit të kaluar, gjëja e parë të cilën e vlerësoi si shumë të rëndësishme dhe të cilën e përshëndeti në mënyrë të veçantë ishte marrëveshja me Serbinë, por në gjithë fjalimin e tij, prej gati gjysmë ore, askund nuk e përmendi korrupsionin, ndërhyrjen e politikës në Gjyqësor, e kështu me radhë. Kjo është

shumë domethënëse, sepse tregon se cilat janë prioritetet e Bashkimit Evropian në raport me Kosovën.

Prandaj, duhet ta themi hapur se gjatë 5 vjetëve të para të pavarësisë së Kosovës, MSA-ja dukej shumë larg, por 5 muaj pas përmbylljes të negociatave me Serbinë menjëherë filluan negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ndonëse ne e dimë fare mirë se nuk pati kush e di se çfarë përmirësimi të dukshëm në luftën kundër korrupsionit, përmirësimin e sundimit të ligjit, e kështu me radhë. Por, do të ishte shumë më mirë për Kosovën që kriter kyç për ecjen tutje në integrimin evropian të mos jetë Serbia mbi të gjitha, por të jenë problemet tona të brendshme, se sa kemi ecur ne në rrugën drejt përmirësimit të çështjeve tona të brendshme, e jo që Serbia të jetë prioriteti i këtyre vlerësimeve.

Çështja e dytë që dua ta ngre lidhur me procesin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ka të bëjë me një dokument të cilin unë e konsideroj shumë të rëndësishëm. Është një dokument i 10 tetorit të vitit 2012, me ç'rast Kosovës iu dha drita jeshile për të hyrë në fazën e fillimit të negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe këtu desha ta plotësoj zonjën Osmani, sepse mendoj që në këtë dokument faktikisht jepen arsyt kryesore pse Kosova është rast 'sui generis' edhe për Marrëveshjes e Stabilizim-Asociimit. Pra, desha të them që unë këtë dokument e vlerësoj si tepër të rëndësishëm, i cili na shpjegon pse Kosova nuk është rast sikur shtetet tjera, dhe unë desha t'i përmend vetëm dy arsye. Po i citoj bile këto dy arsye, të cilat shpjegohen në këtë dokument. Aty thuhet: "Në të kaluarën, Bashkimi Evropian ka arritur disa marrëveshje ndërkombëtare me entitete, të cilat nuk janë vetëm shtete sovranë". Kështu thotë ky dokument i fizibilitetit. Pra, na tregon që me Kosovën nuk qenka problem të lidhet marrëveshje, sepse BE-ja ka lidhur marrëveshje edhe me entitetet, të cilat nuk janë shtete.

E dyta, në këtë dokument thuhet: "Shfrytëzimi i nenit 2018 për marrëveshjen e funksionimit të Bashkimit Evropian, si bazë ligjore për një marrëveshje me Kosovën nuk përbën njohje si shtet të pavarur për Kosovën nga BE-ja, e as nuk përbën njohje të Kosovës nga shtetet individuale". Pra, ky dokument na tregon që BE-ja lidh marrëveshje me entitetet, të cilat nuk janë shtete, dhe lidhja e marrëveshjes me Kosovën nuk do të thotë që BE-ja e njeh Kosovën, e as që shtetet individuale e njohin Kosovën.

Pra, me fjalë tjera, në njëfarë mënyre, me këtë dokument të vitit 2012, sipas mendimit tim, vulolet karakteri joshitetëror i Kosovës në marrëdhënie kontraktuale me Bashkimin Evropian dhe kjo është shumë e dëmshme, sepse në njëfarë mënyre po përcaktohet në mënyrë pozitive që kemi të bëjmë me një jo shtet dhe nuk ka kurrfarë problemi për BE-në, sepse në marrëveshjen për funksionimin e BE-së, nuk tregohet në mënyrë eksplicite se kur lidh marrëveshje BE-ja me një shtet, ai duhet të jetë patjetër shtet sovran. Po ky është problemi kryesor, edhe i karakterit politik bile, i marrëdhënieve tona si shtet me Bashkimin Evropian.

Dhe, çështja e fundit që unë desha ta ngre është se në këtë dokumentin e vitit 2012 listohen 8 fusha, të cilat janë kyçe, që Kosova të bëjë reforma substanciale, ashtu që ne të ecim tutje në procesin e integrimi evropiane. Unë po i lexoj këto 8 fusha, të cilat janë:

1. Mbikëqyrja e Qeverisë nga Kuvendi është e dobët;
2. Pavarësia financiare e Kuvendit nuk ekziston;
3. Statusi i shërbyesve civilë nuk është zgjidhur;
4. Reforma zgjedhore duhet të përmbyllet;
5. Ligjet për shpëlarjen e parave dhe konfiskimin e pasurisë të paligjshme janë të dobëta;
6. Lufta kundër korrupsionit nuk është ekzistente,
7. Duhet të forcohet lufta kundër krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit, si dhe
8. Lufta kundër trafikeve me qenie njerëzore me drogë dhe me armë.

Pra, këto janë fushat kryesore në të cilat, nëse nuk ka përparime, nuk do të ketë plotësim të kushteve të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, e unë po ju them që të niseni vetëm prej njëres - reforma zgjedhore, për shembull. Reforma zgjedhore ka filluar në pranverë të vitit 2011. Përmendet në këtë dokument të vitit 2012 dhe ne po hyjmë në vitin 2014 pa reformë zgjedhore. Çka do t'i themi ne BE-së? Kush po e mban peng reformën zgjedhore, e të mos flasim më për fushat tjera: pavarësia e gjyqësorit, sundimi i ligjit, konsolidimi i institucioneve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministre,

Ajo që duhet thënë në gjithë këtë proces është se sistemi ose tendenca për t'i ndarë proceset veç e veç edhe për t'i evalvuar veç e veç, mund të sjellë ndonjë rezultat në shpjegimin në publik të asaj se çka po ndodh, por nuk e ndërron situatën e Kosovës aspak. Domethënë, veç sa e rëndon situatën e Kosovës në procesin e tërësishëm të integritetit në Unionin Evropian. U përmendën këtu disa çështje nga disa parafoles. Mendoj se opinioni nuk ka nevojë të lodhet me detaje, por në aspektin politik ajo që po ndodh në Kosovë është një shkyçje e shoqërisë me tendencë nga ky proces.

Shumë shpesh tentohet të krijohet përshtypja se Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit do të nënshkruhet nëse për këtë ka vullneti Unioni Evropian, nëse nuk e bëjnë shumë problem 5 vendet, të cilat nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe që janë anëtare të Unionit Evropian e tjera e tjera. Domethënë jepen arsyet, arsyet largohen prej vetes në këtë proces edhe hidhen te Unioni Evropian. Ne kursesi nuk guxojmë të themi se nuk ka probleme edhe nga ajo anë, 5 vende të mosnjohëse janë një problem, mirëpo një qeveri serioze dhe e përgjegjshme fillimisht do ta kishte marrë një pasqyrë tepër të madhe, do ta kishte vënë para vetes dhe do të kishte punuar duke e parë veten, duke e përmirësuar vetveten, domethënë duke e përmirësuar Kosovën.

Në këtë mënyrë, me këtë qasje politike për integritetin në Unionin Evropian në plotësi, pastaj do të ndalem pak edhe te MSA-ja, po rritet edhe skepticizmi në Kosovë. Njerëzit po fillojnë të mendojnë Unioni Evropian qenka i keq e nuk po na do ne për një arsye, ose

për një arsye tjetër. Në vend se të krijohet përshtypja se procesi i integrimit evropian, ose mbyllja e cilitdo kapitull do të nënkuptonte drejtpërdrejt përmirësimin e një aspekti të jetës në Kosovë, jo vetëm pse ata u pajtuan me ne, jo vetëm se Unioni Evropian po thotë ‘hajt se po e bëjmë këtë marrëveshje’, por nuk po krijohet kjo përshtypje në publik në Kosovë dhe ky është një ndër dështimet më të mëdha të Qeverisë të Kosovës, ekskluzivisht dështim i cili nuk mund ta nxjerrë prej kësaj situatë as ministrja, e cila po përpiket, sinqerisht po them, të bëjë diçka.

Puna e ministres, më falni që po e bëjë këtë ‘xhep’ në bisedë, në situatën në të cilën është Kosova mund të kualifikohet me një thënie të moçme komuniste: “Operacioni pati sukses, por pacienti vdiq”. Kjo thënie do të thotë që ti e ke bërë mirë krejt çka është dashur bërë, por nuk ke pasur sukses, dhe të nderuar deputetë të Kosovës, zoti kryetar, nuk mund të ketë sukses Ministria e Integrimeve Evropiane, kur të gjitha sferat tjera të jetës, të cilat përmbledhen në draft-marrëveshje nuk janë askund. Këtu ne e kemi problem me sundim të ligjit, u përmend këtu, të mos ju lodh, kemi problem me gjithçka, me universitet, me Kuvend, me Qeveri, me Polici, me Gjyqësor. Të gjitha janë probleme të mëdha dhe nëse ministrja beson se këto do të përmirësohen në një afat të shkurtër, me sinqeritetin më të madh po ju them, edhe ne, edhe Aleanca, si gjithmonë, i mbështetim proceset të cilat janë në të mirë të vendit dhe do t’i kishim mbështetur, por problemi është se ne nuk po mund të besojmë më se Qeveria mund të bëjë diçka për të shkuar më tutje.

Minimumi që mund të bëjë kjo Qeveri tash, për hir të Kosovës, jo për hir të vetvetes, është të nisë të jetë e kujdesshme, që qytetarëve të Kosovës t’ua shpjegojë se integrimi në Unionin Evropian nuk është kusht i dhimbshëm që ne duhet ta plotësojmë, në mënyrë që ata të na pranojnë ne. Duhet të fillojë t’ua shpjegojë se integrimi në Unionin Evropian është ekzakt kusht për ta ndrequr jetën në Kosovë, për ta bërë jetën më të mirë për qytetarët e Kosovës dhe nëse kështu kuptohet dhe kështu punohet, me siguri se i gjithë procesi drejt integrimit evropian do të ishte më i lehtë për njerëzit më motivues, ose procesi drejt liberalizimit të vizave do të ishte më i lehtë dhe më motivues, nëse në ndërkohë diçka përmirësohet në Kosovë dhe, fundi i fundit, arrihet kjo karotë.

U përmend këtu nga parafolësi se ndoshta edhe vetë nisja e procesit të negociimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit është edhe një karotë për shkak të sjelljes së mirë të Kosovës në biseda me Serbinë. Mund edhe të jetë ashtu, ndoshta edhe është, por çka tjetër të na japë? Cilat arsye tjera i ka dhënë Kosova, që të mos ketë dilema për t’u nënshkruar një marrëveshje stabilizim-asociimi, ose për ta pasur një presion më të madh prej vendeve anëtare shumë të fuqishme të Unionit Evropian që e kanë njohur Kosovën, te vendet tjera, në mënyrë që të kemi, shembull ta marrim liberalizim të vizave, dhe prapë po kërkoj falje që po e bëj këtë ‘xhep’ në bisedë.

Nuk mund ta shohë Raportin e Progresit një ministër i Brendshëm, i cilitdo vend të Unionit Evropian dhe të thotë ‘po, liberalizim i vizave’. E kemi përmendur këtu këtë çështje. Njëjtë do të ndodhë edhe me procesin e stabilizim-asociimit dhe pyetja ime për ministren është: A keni frikë se edhe ky proces mund të përfundojë sikur procesi i liberalizimit të vizave?

Unë personalisht kam frikë. Nuk kam dëshirë, të jemi i qartë para jush, edhe para qytetarëve të Kosovës, nuk është dëshirë e jona të ju zëvendësojmë ju në pushtet, duke ju parë duke dështuar. Nuk është kjo. Por, ne kemi frikë se ky dështim ka shkuar aq thellë, sa është e pamundshme nxjerrja, është e pamundshme kjo Qeveri ta kthejë Kosovën qoftë edhe në fillim të binarëve, ku është dashur të jetë. Kjo është frika jonë.

Nëse lexohen raportet që dalin për Kosovën prej institucioneve më serioze të Unionit Evropian, ato kryesore që janë, shembull ta marrim Komisioni i Unionit Evropian, ju mund të shihni se aty thuhet që papunësia po rritet, edhe absolutisht, edhe relativisht, edhe në terma absolutë, edhe relativë. Aty thuhet që krimi i organizuar nuk po luftohet, aty thuhet që varfëria po rritet, aty thuhet që universiteti është më zi se katastrofa. E tash, nëse ata i mbledhin këto detaje, si të liberalizojnë viza, shembull ta marrim me Kosovën? Ata e dinë se në këto kushte nuk e pret as i pari të fundit për të shkuar diku.

Domethënë, edhe një herë kisha dashur politikisht të përgjigjet ministrja, jo në terma teknikë, e di që e kuptoni çfarë po pyes: A keni frikë ju se ky proces do të prolongohet njëjtë sikur procesi i liberalizimit të vizave? Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Myzejene Selmani, shefja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për dy ministrat që janë të pranishëm,

E falënderoj ministren që e ka sjellë raportin në Kuvend në lidhje me procesin e negociimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit.

Duke marrë parasysh raportin, të cilin e ka sjellë ministrja në Kuvend dhe deklarin e saj, mund të shohim se Kosovën e presin sfida të mëdha. Nuk duhet të jemi optimistë, as skeptikë në BE, mirëpo duhet të jemi optimistë në punën tonë që duhet ta zhvillojmë për realizimin e kësaj marrëveshjeje.

Përmbajtja e marrëveshjeve e jep vetë titullin në të cilin duhet të fokusohet Kosova. Dhe këta 10 tituj apo nëpër 10 takime që do të zhvillohen ndërmjet Kosovës dhe BE-së janë sfida të mëdha. Një ndër sfidat më të mëdha u cek edhe nga ministrja do të jetë dialogu politik dhe shpresoj dhe besoj shumë që të gjithë, pavarësisht pozitë-opozitë, do të mundohemi ndoshta me sugjerimet dhe me kritikën tona që ta kemi një përafrim më të mirë, kur dihet se sa më afër realizimit të këtyre sfidave të jesh, aq sfidat do të jenë më të cekëta. Do të thotë, ata do të na shikojnë edhe nëpërmjet llupës se a do të mund të mund t'i realizojmë këto sfida të cilat na i kanë vënë në titujt e përmendur në këtë raport të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Mund të themi se duhet ndoshta pak më shumë të kemi vëmendje edhe gjatë draftimit të ligjeve, edhe gjatë zbatimit të tyre dhe gjatë debateve tona në lidhje me çështjet, ku sugjerime shumë të mëdha jepen edhe për drejtësinë, lirinë dhe sigurinë. Besoj që

ministrja është duke e kryer punën e vet, mirëpo jo vetëm kjo. Këtu është edhe një grup ndërministror, të cilët duhet të merren me këtë çështje, ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Tregtisë, Bujqësisë, i Financave, i Zhvillimit Ekonomik dhe sidomos ministri i Drejtësisë, mbi të cilin ndoshta do të bjerë barrë shumë e madhe, kur dihet se Kosova akoma nuk ka arritur në ato sfida çfarë duhet të jetë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, mirëpo prapë shpresa mbetet që në dialogun, apo në takimin e fundit, i cili do të zhvillohet në pranverë të këtij viti, dhe ministrja besoj se përsëri do të na raportojë në Kuvendin e Kosovës, që pas përfundimit të këtij procesi do të kemi rezultate tjera, jo vetëm pse është kjo Qeveri, por arsyeja është që qytetarët e Kosovës meritojnë diçka ndryshe. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

E nderuara ministre e Integriteteve,

E dëgjuam me vëmendje ekspozitën tuaj dhe ishim duke i përjetuar të gjithë shqetësimet tuaja, të Qeverisë dhe të qytetarëve njëkohësisht për të gjitha ato vlerësime, që janë bërë dhe për ato sfida që ende janë të pranishme në fushën e cilën e kemi për trajtim.

I preokupuar me gjithë këtë materie, që tani e kemi si analizë e Raportit të Progresit 2013, dhe me dëshirën për të qenë në një performancë më ndryshe, edhe për shkakun se ministria juaj udhëhiqet nga një edukatë dhe nga një formim i vlerësuar me emancipim, të cilin nuk mund ta kontestosh, edhe në çdo krahasim të avancimeve dhe shkollimeve më të avancuara në botë. Por, duke parë mangësitë, unë tani kërkoj të gjej atë që vërtet të jemi të preokupuar bashkërisht, ta konstatojmë dhe pastaj ta evitojmë.

Duke lexuar progresin dhe sfidat e evidentuara në analizën e Raportit të Progresit, vij në konstatimin që ju duhet t'i drejtoheni me një kërkesë kryeministrit dhe Qeverisë. Të gjithë ata faktorë që nuk funksionuar në realizimin e këtij projekti që ka qenë edhe kombëtar të evidentohen shpejt dobësitë e mangësitë, dhe ato të eliminohen. Telegrafikisht, po t'i shikosh sfidat, më besoni, të gjithë do të pajtoheshim se me një përgjegjësi më të madhe, asnjë faktor vendor nuk mungon për t'u përmbushur dhe për t'u tejkaluar këto sfida.

Nëse telegrafikisht e shohim përfundimin e procesit të reformës zgjedhore, më besoni, me një vullnet të përgjithshëm, me një mobilizim të plotë të të gjithë spektrit politik, kjo sfida nuk do të ekzistojë më për institucionet tona, për Qeverinë e Kosovës dhe për Kosovën, në përgjithësi, sepse atje kur të bëhet analiza e Raportit të Progresit nuk vlerësohemi si PDK, as si LDK, nuk vlerësohemi as si Qeveri e Kosovës. Vlerësohemi si subjektivitet shtetëror dhe tani këtu, në qoftë se çdo kritikë, çdo sfida të patejkalueshme nuk e përfshijnë bashkërisht, natyrisht se nuk jemi në nivel të ndërgjegjes sonë nacionale, kombëtare dhe natyrisht shtetërore.

Shkojmë më tutje dhe shohim dhe habitemi pse kanë mbetur këto, për shembull po ndalem te ministrinë. Duhet të përmirësoj përcjelljen e tyre për kërkesa nga komisionet

parlamentare. Pse kjo nuk ndodh? Pse kjo stagnon? Pse kjo është sfidë e pranishme ende? Përpjekjet e mëtejshme janë të nevojshme për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit, të përgjegjshmërisë dhe transparencës së Qeverisë. Funksionimi, zbatimi i legjislacionit, strategjisë dhe planit të veprimit, pse këto ne t'i quajmë sfida ende? Duhet të fillojë vlerësimi i performansës për nëpunësit civilë. Pse kjo të mos bëhet? Kush nuk e ka bërë? Të kërkohej përgjegjësi.

Duhet të caktohen edhe dy anëtarë të Këshillit Gjyqësor me shumicë kështu e kështu. Pse nuk janë caktuar këta? Do të duhej të mos ishte kjo sfidë. Ka mungesë të kapaciteteve të angazhimit për ta hetuar krimin që bëhet nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale. Po, pse të mos plotësohen këto mangësi? Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial duhet të sigurojë këtë e këtë. Po pse të mos bëhet kjo? Kodi i sjelljes për gjykatësit duhet të forcohet. Por, kjo nuk do të ishte trajtuar, sepse në edukimin e tyre arsimor, ata këtë kod nuk do të duhej ta kishin absolutisht të goditur.

Ekziston një numër i madh i mbi 100 mijë vendimeve që duhet të ekzekutohen. Duhet të kërkohej pse kjo ka ndodhur? Pse ky stivim i lëndëve deri në 100 mijë është ende? Ajo që është bashkimi ndërmjet agjencive të përfshira në antikorrupsion, vazhdon të mbetet i dobët. Pse të mbetet i dobët me gjithë ato agjenci që i kemi? Kërkohej vetëm një vullnet dhe ky vullnet nuk guxon të mungojë. Strategjisë së re kundër korrupsionit i mungojnë mekanizmat detyrues dhe i numërojmë cilët janë ato mekanizma. Ka qenë shumë lehtë dhe është e mundur që institucionet tona t'i krijojnë këta mekanizma.

Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit nuk takohet dhe jepen vërejtje. Po pse të mos takohet? Pse është krijuar? Kosova duhet të përqendrohet në zbatimin e politikave, të kornizës legjislative dhe vendosmërisë dhe numërohen këto, këto, këto. Thotë, sidomos në parandalimin dhe luftimin kundër trafikimit të qenieve njerëzore, drogës dhe trafikimit të armëve janë të nevojshme, ndërsa institucionet tona, Qeveria jonë, nuk do të duhej të thoshte se janë të nevojshme, por janë të domosdoshme.

Anëtarët e komisionit drejtues për monitorimin e situatës mbi qendrat e paraburgimit duhet ta përmirësojnë më tej përvojën dhe burimet. Unë për veten, nga që për këto kthina gati kam kaluar, e këto mure kanë ndryshuar pak, janë fasaduar, janë suvatuar, janë ndërruar dritaret, dyert e tyre, por absolutisht nuk do të duhej të kishte vërejtje më. Po vërejtjet mund të jenë të natyrës që i takojnë performansës së këtyre institucioneve dhe kjo është fare lehtë e arritshme. Ka qenë vështirë të ndërrohet infrastruktura e atyre kthinave, të ndërrohet ky inventar, ndërsa për këto kriteret tjera vetëm faktori njeri duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe i mobilizuar për t'i ndryshuar, aq sa unë e njoh këtë fushë.

Në rishikimin e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve duhet të kryhet për t'i identifikuar mangësitë. Këto është shumë lehtë shumë lehtë, veç të dilet në qytetin e Prishtinës. Dikush kush është kompetent dhe t'i shohë ata fëmijë çfarë leksiku kanë, nga vijnë dhe të intervistohen ku kanë lindur dhe ku jetojnë. Dhe, kjo me një vullnet të institucioneve përgjegjëse do të zhdukej për një kohë shumë të shkurtër, sepse shumica prej atyre fëmijëve shihen se nuk janë me adresë nga ky vend, nuk e kanë të folmen tonë, nuk e kanë leksikun e vendit tonë, dhe duket edhe nga aparenca, nga dukja, duket se e kanë një

origjinë të caktuar dhe një adresë që në aspektin perceptiv mund t'i cilësosh dhe të konstatosh vendlindjen e tyre dhe ku janë rritur deri sot.

Me këto ilustrime dua ta krijoj përshtypjen, po dua ta mbjell idenë edhe te ministrja, edhe te Qeveria, por edhe te opinioni i gjerë, edhe te kolegët deputetë, që këto sfida janë të lehta për t'u tejkaluar dhe shumë të rëndësishme janë vlerësimet që janë bërë në Raportin e Progresit. Madje-madje më vështirë kanë qenë të tejkalohen këto vlerësime që janë bërë, se sa këto sfida që janë evidentuar.

Qasja në hapësirat publike për personat me aftësi të kufizuara është e pamjaftueshme. Me një vullnet të ministrive përkatëse, kjo mund të rregullohej jashtëzakonisht, mrekullisht, pa ndonjë kosto të lartë dhe madje mjafton vetëm një shëtitje nëpër qytete dhe metropolet e Evropës e një stafi të ministrive përkatëse. Nuk duhet hiç formim, as nuk duhet edukatë, as nuk duhet edukatë, as nuk duhet arsimim, mjafton që vetëm një ekip të dërgohet nëpër metropolet e Evropës dhe aty do të shohin se çka u mungon qyteteve tona dhe hapësirave publike te ne.

Fëmijët që vuajnë nga kontaminimi me plumb kërkojnë kujdes të mëtejshëm. Natyrisht, kjo është një temë shumë e dhimbshme dhe është e lokalizuar, që me një mobilizim të Qeverisë mund të tejkalohet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Jo, vetëm desha t'i them parafolësit, zotit Krasniqi, se 'pse'-në nuk e ka gjetur as Sterjo Spasse, kështu që të mos e mendojë shumë ministren Çitaku.

Tani po e filloj fjalimin. Të them të drejtën, unë nuk e shoh suksesin e Kosovës në procesin e integritit evropian, por e shoh suksesin e Serbisë, meqë para dy ditësh e pritën në Bruksel përfaqësuesin e saj, pra kryeministrin serb me tapet të kuq, meqenëse u tregua palë konstruktive në dialogun me Kosovën. Kosova bëri shumë lëshime dhe ende nuk ka arritur në këtë dialog, pra ende nuk ka arritur ta firmosë një marrëveshje kontraktuale me BE-në, ndërsa Serbia e mori statusin e vendit kandidat. Mendoj se ky është dështimi i Qeverisë së Kosovës, ashtu siç është dështim procesi i liberalizimit të vizave që nuk po duket më as në horizont, edhe pse, sipas premtimeve elektorale të kryeministrit, kjo punë do të duhej të ishte kryer tashmë.

Çështja që duhet ta ngre është kjo, një tjetër: marrëveshja që e shoqëroi fusnotën, Kosovës nuk ia solli edhe anëtarësimin në organizatat dhe nismat rajonale, të cilat ishin premtuar si kundërvlerë. Shteti i Kosovës mbetet jashtë 22 mekanizmave të tillë rajonalë. Marrëveshja e shkurtit të vitit 2012, e arritur në Bruksel ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, konfirmonte përkushtimin e të dyja palëve për përfaqësim dhe bashkëpunim rajonal, efektiv. Në një pikë të marrëveshjes thuhet se Kosova merr pjesë vetë dhe flet për veten e saj në të gjitha takimet rajonale, por deri tani ka dështuar, edhe pse kjo nuk është pjesë e

MSA-së. Është pjesë e procesit. Kosova pra e fitoi fusnotën, por nuk ka fituar asgjë nga marrëveshjet dhe jo vetëm që e fitoi fusnotën në nivelin rajonal për tashmë kjo fusnotë po vendoset në të gjitha raportet dhe në të gjitha instrumentet e organizatave të tjera ndërkombëtare.

Do të doja një shpjegim nga ministria në lidhje me këtë: pse Kosova s'po arrin të anëtarësohet në këto organizata rajonale?

Një pyetje tjetër shumë konkrete: cilat janë programet e BE-së, në të cilat do të marrë pjesë Kosova? Gjithashtu janë përmendur disa programe, më shumë se 20 sosh, mirëpo në raportin që është paraqitur përpara deputetëve nuk pashë asnjë lloj informacioni të tillë. Nëse ka mundësi, na tregoni! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zotëri Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Do të mundohem të flas shkurt, por nuk do ta quaja replikë.

Unë kam një konsideratë të veçantë për deputeten e nderuar, sepse shfaq një performansë dhe një formim e një edukatë që për mua është jashtëzakonisht impresive dhe natyrisht shumë herë edhe motivohet me praninë e saj këtu dhe me temat që i trajton, sepse edhe origjina e saj, edhe jeta e asaj që e bën këtu në mesin tonë janë mesazh për ne dhe duhet patjetër që të jetë edhe leksion për të gjithë deputetë dhe qytetarët e ambientit tonë këtu ku jemi.

Por, nuk do të duhej absolutisht ndonjëherë që ta keqpërdorë këtë respekt tonin që e kemi për këtë në kontest, siç e përdori tani në këtë rast.

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Marrëveshja për Stabilizim-Asociimin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, ndërmjet tjerash, ka për qëllim forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, stabilitetin politik, zhvillimin dhe bashkëpunimin ekonomik dhe harmonizimin e legjislacionit të Kosovës me Bashkimin Evropian.

Përmbajtja e tekstit për fushat për të cilat do të negociohet tregon që kjo marrëveshje ka implikim të drejtpërdrejtë në shumicën e fushave, të cilat kanë të bëjnë me jetën, organizimin shtetëror, ekonominë e vendit, politikën e jashtme dhe në thelb prek edhe problemet esenciale, si mbijetesën e Republikës së Kosovës, pra ekonominë e vendit, politikën e jashtme, e ndoshta me theks të veçantë....

KRYESUESI: Më shumë qetësi ju...!

FATON TOPALLI: ...dhe çështje të sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë.

Në fakt ne kemi dy probleme kryesore. Njëri problem është që e kemi një Qeveri që zotohet për përmbushjen e standardeve për MSA-në dhe aderimin në Bashkimin Evropian dhe, në të njëjtën kohë, është shkelësja kryesore e standardeve që duhet të realizohen dhe problemi i dytë është agjenda dhe strategjia në drejtim të Bashkimit Evropian, të cilën kjo Qeveri nuk e ka, por vepron herë si pas agjendës të Bashkimit Evropian, herë si pas agjendës së Serbisë, por asnjëherë sipas interesave të Kosovës dhe qytetarëve të saj.

Imputet për raportet e progresit të muajve maj dhe shtator të vitit 2013 dhe informata e Ministrisë për Integritet Evropian për progresin dhe sfidat e identifikuara janë indikator institucional që tregojnë se jemi shumë larg nga krijimi i kushteve të nevojshme për të hyrë në Bashkimin Evropian.

Më lejoni të marr për ilustrim Kapitullin VII të tekstit për negociim të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim nga raporti i Ministrisë për Integritet Evropian, që ka të bëjë me drejtësinë, lirinë dhe sigurinë, dhe të veçoj prej tij dy pika kryesore: parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe fuqizimin e institucioneve dhe sundimin e ligjit për të treguar që shkaktar kryesor për mosfunksionimin e ligjit dhe krimi i organizuar në nivel shtetëror janë pikërisht institucionet, të cilat e kanë mandatin për ta luftuar atë.

Aktualisht, sipas Prokurorisë së Shtetit kemi 937 raste të korrupsionit, në të cilat janë përfshirë 2 470 persona.

Nëse u referohemi rasteve të zgjidhura në periudhën nëntor dhe dhjetor të vitit që shkoi, të akuzuarit me shumicën e rasteve e kanë keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar. 2 470 persona të akuzuar për korrupsion vijnë së paku, unë mendoj kështu, jo si angazhim i organeve shtetërore për ta luftuar korrupsionin, por si rezultat i fishkëllimit të qytetarëve kundër zyrtarëve të korruptuar.

Aty ku institucionet nuk kanë presion qytetar për ta luftuar korrupsionin, nuk veprojnë. Këtë e vërteton më së miri raporti mbi zbatueshmërinë e planit të veprimit kundër korrupsionit për periudhën shkurt-maj 2013, i cili i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës për këtë pikë të rendit të ditës.

Ky raport tregon që institucionet e vendit nuk janë të interesuara për sundimin e ligjit, e aq më pak për luftimin e krimit.

Ndryshe s'ka si të shpjegohet fakti që vetëm 24% e veprimeve të parapara në luftë kundër korrupsionit janë realizuar. Skandaloze është që një varg institucioneve, përfshirë këtu, mes tjerash, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Policinë e Kosovës janë tallur me vendimet e Kuvendit në kuadër të strategjisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit për periudhën kohore 2013-2017, duke mos realizuar veprime të parapara, e disa duke mos raportuar fare nëse kanë të bëjë me një veprim konkret, apo jo.

Nëse lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, siç kërkoi pardje edhe zonja Lunaček, është kërkesë e Bashkimit Evropian, janë pikërisht institucionet qeveritare të

Kosovës ato që bëjnë pjesë në korrupsion, që janë pjesë e krimit si njëra prej formave të krimit, pra madje edhe të organizuar, si në rastin e Fabrikës së Amortizatorëve, janë pra ato që e pengojnë zhvillimin e vendit dhe rrugëtimin drejt Bashkimit Evropian.

Me këtë lloj qeverisje dhe me këtë qasje ndaj sundimit të ligjit dhe përfitimeve nga pozitat e institucioneve nuk ka MSA, nuk ka liberalizim vizash. Përgjegjës kryesor është vetë Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saj.

Implikimi i marrëveshjes në çështjet e rëndësishme të jetesës dhe mbijetesës së qytetarëve dhe shtetit të Kosovës shtrën pyetjen esenciale të rrugëtimit kohor të Kosovës në drejtim të Bashkimit Evropian.

Pas premtimit para tre vjetësh të kryeministrit se do të kemi liberalizim të vizash pas 18 muajsh, na del që për viza duhet të presin së paku edhe tre vjet të tjera.

Nëse liberalizimi i vizave do të zgjasë edhe tre vjet, implementimi i MSA-së do të zgjasë së paku edhe 6 vjet sa shkojnë me Republikën e Shqipërisë. Atëherë shtrohet pyetja: pse ky nxitim për hapjen e tregut ndaj BE-së dhe vendeve të tjera dhe në dëm të ekonomisë së Kosovës?

Ne e kemi nënshkruar një marrëveshje për tregtinë e lirë me Bashkimin Evropian, por të vetmin mall që ne mund ta eksportojmë me shumicë është fuqia punëtore, që e kemi me bollëk, e kemi të mirë, me gjithë tregun e lirë nuk e eksportojmë dot, sepse Bashkimi Evropian nuk e hap tregun, sepse kështu e mbron tregun e vet të fuqisë punëtore.

Pra, nuk them se nuk duhet të nënshkruhen marrëveshje të tilla, por ka shumë rëndësi nëse ato nënshkruhen në fillim, në mes apo në fund të procesit. E njëjta gjë edhe me MSA-në.

Të gjithë e dimë që Kosova është shumë larg realizimit të standardeve që duhet të jenë realizuar në përfundim të MSA-së. Megjithatë, Kosova i filloi bisedimet me Serbinë si kusht për ta filluar negociimin për MSA-në.

Nuk ishte Kosova ajo që duhej të nxitohej për raportet me Serbinë, por ishte Serbia ajo që i dëshironte këto bisedime për ta siguruar sa më parë biletën për të hyrë në Bashkimin Evropian.

Qeveria e Kosovës e shiti këtë biletë shumë lirë. Ajo që mbeti janë eurot në xhepat e negociatorëve dhe dëmi që u shkaktua vendit nëpërmjet federalizimit të vendit tonë dhe një varg problemesh të tjera, që do të dalin më vonë.

Zonja ministre,

Ju keni deklaruar që teksti për implementimin e MSA-së do të shkruhet në pranverë të vitit 2014. Ju lutem, na tregoni, a qëndroni edhe më tutje pranë këtij zotimi?

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar nenkryetar i Kuvendit!

Këtu u fol shumë, duke filluar nga raportet e Kosovës me Bashkimin Evropian, pastaj duke vazhduar me subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës, organizimin e brendshëm, sundimin e ligjit dhe problemi kryesor, i cili nuk u diskutua, është çfarë lloj shteti kemi ndërtuar ne? Sa jemi ne të kënaqur me këtë lloj shteti dhe si po menaxhohet ky shtet?

Besoj se këtu e marrim përgjigjen pse ne nuk kemi progres në raport me Bashkimin Evropian, pse ne nuk kemi legalizim të vizave, pse ne kemi vështirësi me negocimin e kapitujve për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit dhe plot elemente tjera.

Mirëpo, një fushë që nuk u prek këtu, po ashtu është shumë e rëndësishme, mendoj se është ekonomia. Unë vetëm po i lexoj të gjeturat. Nuk po i komentoj, le t'i komentojnë njerëzit që po na shohin nëpërmjet televizorit, apo deputetët këtu, apo ministria, për ekonominë. Rritja e bruto produktit vendor ra nga 4,4% në 2011, në 2,5%. Rritja mbetet fragile.

Statistikat ekonomike, sidomos të llogarive bankare, mbeten të dobëta. Deficiti tregtar është i lartë. Eksportet kryesore kanë rënë. Investimet e huaja direkte kanë rënë dhe vazhduan të shkojnë se sektorët jo të tregtueshëm. Papunësia shumë e lartë, mospërputhje ndërmjet nevojave të tregut dhe kualifikimeve. Të hyrat tatimore dhe tatimet në kufij kanë rënë, e tjerë e tjerë.

Këto janë elemente të cilat tregojnë çfarë kualiteti të shtetit kemi ne, çfarë lloj shteti kemi ndërtuar dhe si mund të shkojmë në Bashkimin Evropian, duke e pasur këtë lloj shteti që e kemi ndërtuar dhe këtë lloj ekonomie. Si mund të kërkojmë ne të kemi liberalizim të vizave, kur të gjithë indikatorët tregojnë rënie, dhe kur deputetët e Lidhjes Demokratike, apo ekspertët të cilët merren me fushën e ekonomisë dalin në këtë Kuvend, apo në konferenca të shtypit dhe thonë se ka rënie në të gjithë sektorët e ekonomisë, këtu e kemi një agresivitet të theksuar edhe të kryeministrit, i cili del edhe thotë që rritja ekonomike është 5,5%, ndërkohë që këtu po na raportohet që është 2,5%.

Po ashtu, edhe elementet tjera të rëndësishme sa i përket sistemit bankar apo financimit të ekonomisë, që thonë: “Aktiviteti kreditor ka rënë fuqishëm nga numrat dyshifrorë në 4%, kushtet e kreditimit mbeten të forta, dallimi në normën e interesit dhe dispozita është shumë i lartë”.

Sektori informal mbetet sfidë e madhe, qasja në kosto në financa është shumë e lartë, interferenca e shtetit në ekonomi mbetet e lartë, nuk është vendosur korniza institucionale për veprimtarinë dhe aprovimin e ndihmës shtetërore dhe plot elemente tjera, të cilat tregojnë se në aspektin e strukturimit të ekonomisë së Kosovës ne jemi shumë prapa.

U tha këtu, në aspektin e strukturimit të shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës në Kosovë, jemi shumë prapa. U tha se në aspektin e strukturimit të administratës jemi shumë prapa dhe të gjitha këto elemente pastaj krijojnë probleme në aspektin e negocimit të kapitujve të ndryshme, të cilët negocohen në Bashkimin Evropian.

Është e vërtetë që këtu janë negociuar vetëm tre kapitujt e parë, por progresi është jo ai i dëshirueshmi. Dhe, plot elemente tjera, të cilat na bëjnë që të mos jemi optimistë.

Dhe, deklarata pompoze e kryeministrit në fushatë elektorale se brenda 15 muajve do të bëhet liberalizimi i vizave me Bashkimin Evropian, dhe ndoshta brenda 20 muajve liberalizimi i vizave me Amerikën, sot po na del se as në 4 vjetët e ardhshme nuk do të ketë liberalizim të vizave, gjë që është i tmerrshëm si lajm për qytetarët e Kosovës dhe po na del që me Amerikën as që është diskutuar, as që arrihet të diskutohet kjo punë.

Prandaj, krejt këto elemente të organizimeve dhe strukturimit të shtetit të Kosovës janë elemente të cilat e paraqesin nivelin politik të Kosovës, të cilat e paraqesin kualitetin e përfaqësimit të vullnetit të qytetarëve të Kosovës, të cilat e paraqesin strukturën e organizimit të shtetit në shtyllat e veta, të sundimit të ligjit, në shtyllën e vet të administratës shtetërore, apo në shtyllën tjetër të vet që ka të bëjë me ekonominë.

Këto janë elemente thelbësore mbi bazën e të cilave ne duhet ta ndërtojmë shtetin tonë dhe mbi bazën e të cilave ne duhet t'i ndërtojmë parimet mbi të cilat ne ju ofrojmë zgjidhje qytetarëve tanë. Dhe, pastaj ne ta kemi një tendencë për t'i përfruar me Bashkimin Evropian. Ne jemi keq në raport me qytetarët tanë dhe aq më keq edhe në raport me institucionet e Bashkimit Evropian, apo me progresin drejt Bashkimit Evropian.

Prandaj, mendoj se në këtë situatë është e dhimbshme të vlerësohet, por fatkeqësisht kemi dështim shtetit nëpërmjet përfaqësuesve të shtetit të Kosovës, por edhe dështim të mbrojtjes së interesit të qytetarëve të Kosovës dhe shtetit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

E nderuara ministre,

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë në fjalën time do të fokusohem vetëm në disa nga tetë prioritetet afatmesme për Kosovën, të identifikuara në studimin e fizibilitetit dhe gjithashtu të paraqitura në planin e veprimit të Qeverisë për negociim të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Po filloj së pari me Administratën Publike.

Në planin e veprimit flitet për një progres në disa fusha në Administratën Publike. Por, e nderuara ministre, duhet pa tjetër të ju përkujtoj se miratimi i disa ligjeve në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk është dëshmi se është bërë progres i mjaftueshëm në Administratën Publike.

Ju më së miri e dini se sa ka ngecje në reformën e Administratës Publike, aq e kërkuar nga Bashkimi Evropian.

Ju rikujtoj se sot Administrata Publike e shtetit tonë të vogël numëron 77 mijë veta. Qeveria duhet së pari të fillojë reformën nga kabineti i saj. Jemi bërë Qeveria më e madhe në rajon, me 20 ministri.

E nderuara ministre,

Ju e dini mirë se sa ka nepotizëm në Administratën Publike dhe a mund ta quani këtë reformë?

Unë jua rikujtoj se reforma ndodh vetëm atëherë kur ju dhe krerët e Qeverisë suaj sakrifikoni nipa dhe dajë dhe merrni njerëz profesionalë nëpër institucione. Ligjet gjithashtu nuk po zbatohen në këtë fushë.

Në planin e veprimit për negocimin e MSA-së për politikën kundër korrupsionit, ndër të tjera, thuhet se korniza legjislative në këtë fushë është pothuajse e kompletuar, është amendamentuar Ligji për financimin e partive politike, duke adresuar mangësitë ekzistuese. Gjithashtu është rishikuar Kodi Penal dhe janë inkorporuar si vepra penale, konflikti i interesit dhe deklarimi i rremë i pasurisë nga zyrtarët publikë.

E nderuar,

Ju e dini mirë se çfarë kërkon BE-ja, jo vetëm për integritet, por edhe për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Bashkimi Evropian kërkon evidencë, kërkon provë për luftë kundër korrupsionit. Nëse ju jeni e kënaqur me progresin që është bërë deri më tani, na zhgënjoni, sepse miratimi i disa ligjeve në Kuvendin e Kosovës nuk ka rezultuar në aksione konkrete në luftë kundër korrupsionit.

Ju nuk mund të dilni dhe të thoni që nuk ka korrupsion në Qeveri dhe në Administratën Publike. Edhe nëse e thoni një gjë të tillë, ju edhe vetë nuk e besoni.

Nëse 99% e zyrtarëve publikë, që e keni paraqitur si progres në planin e veprimit, e kanë deklaruar pasurinë e tyre, kjo nuk do të thotë asgjë, sepse ju nuk keni thënë se sa personave nuk u përputhet pasuria që e kanë me të ardhurat aktuale të tyre, sa prej këtyre rasteve gjenden në Prokurori dhe a ka ndonjë person të burgosur për këtë dukuri. Ju nuk mund t'i thoni këto.

Ju më thatë dhe partia e juaj e keni bërë kryetar të Komunës njeriun, i cili është nën hetime dhe akuzohet për korrupsion dhe për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe ju kisha lutur shumë të na thoni se çfarë komenti ka Bashkimi Evropian për këtë. Edhe është e vërtetë se vlerësohemi si Kosovë, e jo si parti politike, por kur është rasti për këtë na tregoni se çka mendojnë për Kosovën Bashkimi Evropian, kur ne bëjmë kryetarë të komunave njerëz që janë nën hetime dhe njerëz që janë të akuzuar për korrupsion?

Takimet ndërministrare apo të Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit janë qesharake, nuk kanë dhënë asnjë rezultat konkret. Me këtë nivel të korrupsionit vështirë se do të ketë Marrëveshje të Stabilizim-Asociimit, liberalizim të vizave dhe aq më pak integritet në BE.

Dhe, problemi, zonja ministre, është se korrupsioni më i madh bëhet pikërisht në dikasteret e Qeverisë, pjesë e së cilës jeni edhe ju. A e dini se çka ndodhi me aferën e 1.4 milionëve në Ministrinë e Punëve të Brendshme? Çka ndodhi me vjedhjet në Dhomën e Dëshmive në Policinë në Pejë dhe në Prishtinë? Ku janë përgjegjësit? Ku ndodhen ata sot? Shkoni dhe shikojini në këto institucione personat që janë përgjegjës, që është dashur të përgjigjen se ku kanë qenë në momentet kur këto gjëra kanë ndodhur. Ata sot i gjeni të graduar në vendet e tyre të punës dhe ky është korrupsion dhe këto gjëra i ka të ditura Bashkimi Evropian.

Ju e dini shumë mirë gjithashtu se një miliard e Buxhetit të Kosovës, e taksave të qytetarëve të varfër të Kosovës shpenzohet nëpërmjet prokurimit publik. Ky është burim i korrupsionit.

Në planin e veprimit nuk ka ndonjë aksion që fillon ta luftojë korrupsionin, sepse për ta luftuar korrupsionin duhet filluar për ta luftuar Qeverinë, e Qeveria nuk ka se si ta luftojë vetveten.

Kur flasim për kriteret ekonomike, ekonominë dhe konkurrencën e lirë, BE-ja në kërkesat për MSA-në kërkon një ekonomi funksionale të tregut, e cila është në gjendje të përballet me presionin e konkurrencës dhe forcave të tregut në Bashkimin Evropian.

Në planin e veprimit për MSA-në prapë është shkruar një progres, por unë them, e nderuar, se nuk ka progres, por ka regres dhe a e dini pse? Sepse korrupsioni i lartë ka bërë që shteti për disa biznese të jetë shtet, e për të tjerat të jetë pushtet.

Korrupsioni i lartë e ka deformuar konkurrencën e lirë dhe i ka stimuluar bizneset e korruptueshme.

A jeni në dijeni se kjo Qeveri e ka deformuar tregun në fiskalizim të pjesshëm të bizneseve. Edhe sot e kësaj dite, pas tre vjetëve që e ka filluar fiskalizimin, kemi vetëm 14% të bizneseve të fiskalizuara. Informaliteti është mbi 30% dhe kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në deformimin e tregut dhe të konkurrencës së lirë.

Sipas studimeve të bëra nga organizata shumë profesionale në Kosovë, ka dalë që të vetmet kompani private që kanë pasur rritje gjatë vitit 2013 kanë qenë ato të cilat drejtpërdrejt kanë marrë punë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Është më se e vërtetë se është bërë progres në fushën e regjistrimit të bizneseve dhe ne kemi qenë pjesë e kësaj reforme, kur kemi qenë në Qeveri, dhe e kemi aplauduar një progres të tillë. Por, a e dini ju, e nderuar, se sa biznese dështojnë dhe dalin nga tregu çdo ditë?

Progres nuk do të thotë vetëm regjistrimi i lehtë i bizneseve, sepse ngecja në ekzekutimin e kontratave, në mbrojtjen e biznesit privat, në mbrojtjen e investitorëve të huaj dhe të

vendit është dëmi më i madh, do të thotë mungesa e zbatimit të kontratave dhe mbrojtja e zbatimi i ligjshmërisë dhe i rendit në këtë sferë, që u bëhet të gjitha bizneseve.

Rritja ekonomike ka rënë nga 4,4 në 2,5%, siç u konfirmua më herët. Papunësia është rritur, është rritur varfëria, deficitit tregtar në nëntëmujorin e parë të vitit 2013 ishte 1,9 miliard. Qeveria e ka falur Distribimin dhe Furnizimin e energjisë elektrike dhe ka tentuar me çdo kusht që në mënyrë joligjore ta shesë PTK-në.

Sa i përket aspektit makrofiskal, nuk është mirë që të shihen vetëm numrat në fund se a barazohen. Duhet të shihet edhe përmbajtja e asaj.

Nëse ne e kemi zbritur deficitin buxhetor dhe e kemi rritur borxhin publik për dyfishin e saj, kjo, e nderuar, nuk mund të quhet progres, por në fakt është regres.

E nderuar ministre,

A e di Qeveria se sa do të jetë kostoja e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sepse me nënshkrimin e saj liberalizohet tregtia dhe ne nuk jemi kundër kësaj. Mirëpo, hiqet taksa doganore prej 10%.

Me një llogari të thjeshtë, Kosova importon 2,5 miliardë mallra në vit dhe 10% e kësaj, duke përjashtuar marrëveshjet e lira që i kemi me Turqinë dhe vendet e CEFTA-s, atëherë i bie që kostoja do të jetë minus 200 milionë në Buxhetin e Kosovës.

A ka menduar Qeveria se si do t'i kompensojë këto të hyra, nëse nuk janë 200, atëherë ju lutem na tregoni se sa janë dhe si do t'i kompensoni?

Problemi me MSA-në, njëjtë sikur me liberalizim të vizave, do të marrë kohë. Do të thotë çështja është se ky proces do të marrë kohë. Edhe liberalizimi është premtuar për 15 muaj, e nuk ka ndodhur sot e kësaj dite, dhe nuk po pritet që do të ndodhë.

Problemi është, sepse ne e kemi një Qeveri me njerëz të vetëkënaqur, e kur ka njerëz të vetëkënaqur, atëherë nuk mund të shihet progres, sepse ata nuk i thonë vetes që kanë punë përpara, por i thonë vetes që është shumë lehtë dhe të gjitha do të përfundoher. Kërkoher më shumë punë. Sakrifikoni shokët edhe kur ata janë të korruptuar. Përndryshe do të vazhdojmë kështu, t'i sakrifikojnë proceset, sepse shokët i paskeni më të çmuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Natyrisht që në këtë temë në të cilën po flasim dhe cila është një prej temave të them që është përfolur shumë në Kosovë, qoftë në Kuvend apo jashtë tij, në skenën publike, në përgjithësi, pra integrimin në BE dhe tash ky mekanizmi i stabilizim-asociimit si një mekanizëm, apo një lloj mjeti që të orienton dhe të përafron me BE-në, është një temë shumë e rëndësishme, e cila ka implikime serioze në jetën shoqërore politike dhe

ekonomike të vendit dhe si e tillë duhet të merret me shumë më shumë kujdes sesa që po e vërej nganjëherë Qeveria e Kosovës që po bën.

Dhe, këtu nuk e kam fjalën për ministren, e cila e prezantoi raportin, por e kam fjalën përgjithësisht për Qeverinë dhe seriozitetin e ministrave të caktuar që i mbulojnë sektorët e rëndësishëm që përfshihen edhe në Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim. Për shembull, ne këtu e kemi tash situatën ku i kemi vetëm dy ministra nga Qeveria, ministrja e Integritimit Evropian, që e paraqiti raportin, dhe ministri i Shëndetësisë. Por, nuk e kemi, për shembull, ministrin e Tregtisë, ministrin e Financave, ministrin e Zhvillimit Ekonomik. Të gjitha këto janë çështje shumë të rëndësishme, kur flasim për aderimin ose rrugëtimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Pastaj ministri i Mjedisit, ta zëmë, e çështjeve tjera, që po ashtu janë kapituj të rëndësishëm në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Unë e kam një pyetje për fillim, e cila nuk fillon me ‘pse’. Pyetja është, a mund të na thotë ministrja, nëse mund të na japë një përgjigje tash, se kur presim që Qeveria e Kosovës, sipas projekteve të tyre, që marrëveshja të finalizohet dhe të nënshkruhet, pra Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit. Besoj që e kanë ndonjë plan veprimi, njëfarë dinamike të veprimit, dhe po qe se të gjitha çështjet tjera mbeten të pandryshueshme, atëherë me këtë rrugëtim të Kosovës drejt BE-së, kur do të ketë nënshkrim, finalizim të kësaj marrëveshjeje?

Çështja e dytë që unë dua ta pyes, që është natyrës politike, a do të ratifikohet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me Kosovën në të gjitha parlamentet e vendeve anëtare, siç është e zakonshme të ndodhë, apo do të ratifikohet vetëm në Parlamentin Evropian? Dhe, nëse kjo e dyta është e vërtetë, atëherë a e vendos kjo Kosovën në një pozitë jo të barabartë me shtetet tjera karshi Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe përgjithësisht karshi aderimit në Bashkimin Evropian, sepse unë mendoj që kjo është e rëndësishme.

Po, është e rëndësishme, që kur etablohet një marrëdhënie kontraktuale, që po e quaj me BE-në, Kosova ta etablojë këtë marrëdhënie kontraktuale vetëm si shtet sovran dhe i barabartë, e jo ta pranojë një derë të pasme, ku do të hyjmë me kokë ulur për shkak se dikush atje paska qenë i vullnetit të mirë dhe na ka marrë e na ka futur në BE, e jo që ne e kemi merituar, apo që na takon si e drejtë. Pra, këto janë çështje të cilat janë të rëndësishme për të diskutuar në këtë të them ashtu nganjëherë dasmë publike që po krijohet rreth integriteteve në Bashkimin Evropian.

Një çështje tjetër është që po shihet edhe në diskutime këtu dhe përgjithësisht në diskutimin publik, që zakonisht kur flasim për Bashkimin Evropian dhe integrimin drejt Bashkimit Evropian, gjë që e kam përmendur edhe më herët, thuhet që ky është pa alternativë dhe unë mendoj natyrisht që ka alternativë dhe çështjet, të cilat po i diskutojmë, në fakt, janë çështje që domosdoshmërisht duhet të përmirësohen në Kosovë, qe apo s’qe Bashkimi Evropian. Pra, zhvillimi i Kosovës dhe mirëqenia e qytetarëve është pa alternativë, ndërkohë që në çështje tjera të gjitha kanë alternativa, e integrimi në Bashkimin Evropian, po pajtohem, është një mjet goxha i mirë dhe është treguar deri

tash, të paktën në shumë raste i suksesshëm në rritjen e mirëqenies dhe zhvillimin e vendit. Dhe, në anën tjetër, mendoj që po bëhet gabim jashtëzakonisht i madh politik kur mjetet po i shndërrojnë me qëllime. Pra, edhe integrimi në BE është një lloj mjeti që e kanë përdorur vendet për avancimin e interesave, qofshin ato tregtare, ekonomike, e kështu me radhë.

Edhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është një lloj mjeti që vendet e kanë përdorur atë për t'iu afruar BE-së, pra ta reformuar veten, për t'i përmirësuar çështjet e veta, në mënyrë që ta kenë ndihmën edhe financiare të Bashkimit Evropian në këtë drejtim, në mënyrë që pastaj t'i afrohen BE-së.

Dhe, në këtu tash po i shndërrojmë në tensionime, por për ne qëllim është integrimi në Bashkimin Evropian, për me qëllim është nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku këto do të duhej t'i përdornim si mjete.

Dhe, tash po kaloj në temën për të cilën e mora fjalën.

Çështja e tregtisë. Pra, është e ditur që një pjesë e konsiderueshme e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit merret me raportet tregtare që do t'i ketë Kosova në Bashkimin Evropian dhe në këtë drejtim konsideroj që duhet t'i kushtohet një vëmendje e posaçme nga Qeveria e Kosovës. Prandaj, edhe thashë që do të ishte mirë që të ishin edhe ministrat tjerë këtu të këtij negocimi edhe të marrëveshjes që do ta nënshkruajë Kosova me BE-në, për sa u përket raporteve tregtare.

Siç u tha edhe nga disa parafolës, edhe pse mendoj që nga pak gabuan në kalkulime, por, sidoqoftë, kjo marrëveshje e tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian do të ketë implikime buxhetore.

Dhe, çështja e parë që do ta bëjë Kosova është që t'i orientojë politikën tregtare drejt lëvizjes kah përdorimi i tarifave doganore për mbrojtje të sektorëve specifikë, edhe industrive specifike të vendit, e jo për ta mbushur buxhetin, sepse kështu pastaj do të mbeten edhe pa buxhet, edhe pa prodhim.

E dyta është që të insistojë dhe të negociojë në një periudhë sa më të gjatë, nëse është e mundur deri në 10 vjet të tranzicionit. Pra, që integrimi tregtar me Bashkimin Evropian të jetë sa më gradualisht i mundshëm për shkak se një integrim i shpejtë do të na shkatërrojë ne si ekonomi, edhe ashtu të shkatërruar deri tash, për shkak të mungesës absolute dhe të prodhimit që e kemi.

Çështja tjetër është që duhet të mbrohen sa më shumë prodhimet e Kosovës dhe duhet të liberalizohen veçanërisht në faza fillestare vetëm ato prodhime, të cilat e kanë një kosto të madhe dhe që kërkojnë një ekspertizë të madhe të prodhimit, që janë zakonisht makineritë, dhe për të cilat Kosova aktualisht nuk ka potencial prodhues, apo ato prodhime të cilat Kosova kurrë nuk do t'i prodhojë. Dhe, kjo bëhet, natyrisht, duke e pasur një plan paraprak strategjik të zhvillimit ekonomik dhe industrial të vendit, e jo kështu ad hoc siç punon Qeveria e Kosovës, pa e ditur fare se çfarë potenciali prodhues

kemi, cilat janë ato mundësitë e Kosovës, ku duam të shkojmë në të ardhmen e kështu me radhë sa i përket zhvillimit dhe industrializimit të vendit.

Pastaj, duhet të përqendrohemi në kriteret specifike për lartësinë e tarifave për produkte specifike, si dhe ta dëshmojmë këtë me rolin që këto produkte specifike kanë në bruto-prodhimi vendor, në punësimin e atyre shtresave, të them ashtu të marginalizuar të shoqërisë, e kështu me radhë, e përgjithësisht në zhvillimin ekonomik të vendit.

Dhe, çështja e fundit është që duhet të kemi parasysh dhe të jemi shumë të vëmendshëm në barrierat jotregtare që mund të na paraqiten gjatë rrugëtimit, sepse kur po e përmendim liberalizimin për hapjen e tregut me Bashkimin Evropian, zakonisht po mendohet që këtu përfitimi i dyanshëm është i garantuar, sepse meqenëse ata do të shesin këtu pa barriera tarifore, edhe ne do të shesim atje pa barriera tarifore. Por, janë pikërisht këto barriera jotarifore që mund t'i shkaktojnë probleme të mëdha Kosovës, ku hyjnë për shembull standardizimi i prodhimeve, standardizimi i procesit të prodhimit, pastaj mjedisi dhe kushtet mjedisore në të cilat prodhohet e kështu me radhë, gjë që kanë rëndësi të veçantë për prodhimet bujqësore, për prodhimet blegtorale, por edhe për të gjitha prodhimet ushqimore dhe tjera që ne mund t'i shesim në Bashkimin Evropian, barriera këto të cilat do të na paraqiten po qe se nuk i kushtojmë kujdes të veçantë gjatë negociimit të marrëveshjes dhe pastaj pas nënshkrimit të saj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI: Erdhi kryetari dhe ma dha shansin të dal t'i them dy fjalë, se herën tjetër nuk kisha mundësi.

Tema është shumë e madhe, ndeshja joadekuate do të thosha, sepse diskutimi i parlamentarëve është i 'skifterëve', ndërsa Qeveria na ka sjellë këtu 'pëllumbeshë'. Domethënë është një ndeshje, do të thosha joadekuate. Natyrisht janë figura, por edhe e vërteta është kjo.

Ne kishim edhe diskutime që janë relaksuese dhe janë relaksuese, sepse e kanë karakterin afirmativ deri në nivelin e propagandës, prandaj njerëzit edhe argëtohen. E kemi edhe anën tjetër, e cila shikon nga këndi kryesisht kundërshtues i politikave, që merr ngjyrë tjetër.

Unë nuk dua të përsëris asgjë, por po ndiej nevojë, edhe personale, edhe përfaqësuese, që rreth kësaj punës së Evropës t'i them dy-tri fjalë.

Tomas Mori, një evropian shumë i njohur i ujdhesës, kryeveprën e vet e ka quajtur "Utopia". Utopia i bie, sipas fjalëformimit me bazë greke, një vend që nuk ekziston askund hiç. Askund!

Një variant tjetër i shpjegimit të leximit të kohës së Morit, thonë egzegetët - shpjeguesit, që ai e ka pasur një variant tjetër, titullin “Eutopia”. Eutopia i bie një vendi i mirë, i këndshëm. Tash, cilën po e duam, a po duam utopinë, a eutopinë? Në këtë rast, eutopia po i bie utopia evropiane, përafërsisht. Është e bukur.

Në princip, tekstet utopike kanë lindur në shoqëritë në krizë. Domethënë, shoqërinë më ideale nëpër shekuj, që prej Platonit e kënde, por sidomos prej Tomas Morit i ka lindur një situatë krize, jo situatë e zhvillimit. Kriza e lind ëndrrën e madhe. Këtë ëndërr të madhe evropiane që e kemi ne ashiqare që e forcojmë si ëndërr, aq më shumë sa të jemi në krizë. Sa më shumë të zhvillohemi, e relativizojmë. Edhe ne këtu në Kuvend, edhe shoqëria e Kosovës, edhe çdo kush, edhe çdo individ.

Thonë ‘po shkojmë në Evropë’. Asnjë vend s’ka ku shkon, se s’mund të shkojë askund, dhe Kosova s’duhet të shkojë kurrkund, por duhet të zbresim në atë situatën reale se Kosova është në krizë si shoqëri. E ne, kur të bisedojmë, edhe intimisht, edhe kur analizojmë, aty jemi. Nuk duhet të na vijë keq që duhet të zhvillohet.

Pra, e ka edhe këtë utopi, që i bie një shpresë, një imagjinatë, një ndjellje, një motivim, i cili është i domosdoshëm për çdo shoqëri, edhe kur është racionale, edhe kur s’është racionale.

Pra, Kosova s’ka nevojë të shkojë askund, por Kosova duhet të zhvillohet brenda, që të bëhet e krahaseshme, ose partner të shkojë diku, ose të udhëtojë me dikë. Nëse ky zhvillim, kjo ëndërr nuk fillon të bëhet reale këtu si mirëqenie, si komunikim, si standard vlerash, si komunikim ndërmjet veti dhe me të tjerët, atëherë përnjëmend ‘eutopia’ kthehet prapë në ‘utopi’.

Demokracia është nuk është gjendje, por është proces, i cili ndihmon. Është instrument shoqëror që ndihmon që të shkohet përpara. Provat e të gjitha sistemeve thonë që kjo është pak më e mirë, e idealja nuk është as kjo, sigurisht.

Por, veçse demokracia në një vend shumë të varfër është prapë një farë utopie. Këto janë të lidhura. Teorikisht mund të shkruash çka do, praktikisht jo. Çfarë i bie kjo? I bie që ëndrra është e nevojshme, shpresa është e domosdoshme për natyrën njerëzore, për kolektivitetin, veç pa punë të dyja kthehen dalëngadalë në ‘distopi’, domethënë në kontra-utopi, ose në ëndërr të keqe. Çfarë duhet të them? Shqiptarët në Kosovë dhe të tjerët në Kosovë, qytetarët e Kosovës, aq sa marrin mundimin që të zhvillohen, për aq janë evropianë. Nëse s’e marrin këtë mundim, askush sot nuk përfitohet me përgjërime dhe me lutje. Pranohen lutjet, por nuk janë instrument.

Prandaj, unë po them që nëse duam utopi në kuptimin e egalitetit, të gjithë barabartë, të gjithë hanë sa kanë nevojë e punojnë sa munden, e të tjera, që ju i dini, ato mandej në shekullin XIX e X e kanë marrë një emër krejt tjetër, unë s’po ia them emrin, e ndeshet në të njëjtën kohë, domethënë kjo ëndërr e egalitetit me një ‘distopi’, që ekziston pikërisht në ujdhesë. Tash është ky tjetri - Xhorxh Orvelli, prapë me anglez e kam, se utopitë edhe janë planifikuar në ujdhesë, se Anglia ka mbetur ujdhesë e veçantë, edhe pse

lidhet me Evropën. Ky tash e përshkruan këtë utopinë e vizatuar kur të bëhet në shoqëri kolektiviste çfarë ndodh. Kush e ka lexuar në vitin 1984 e ka lexuar dhe unë tutje nuk do të shpjegoj. Kush s'e ka lexuar, veç humb kohë. Pra, nëse jetojmë më 1984, e imagjinojmë utopinë, qoftë si 'eutopi', ose ëndërr evropiane, faji është yni. Faleminderit!

KRYETARI: 'Pëllumbeshë' a 'shqiponjë'? Cila? Urdhëro ministre, e ke fjalën!

MINISTRJA VLORA ÇITAKU: Faleminderit!

Si ministre, do të përpiqem të përgjigjem vetëm në pyetjet që ndërlidhen me procesin e negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Pyetja që u bë më së shpeshti ishte ajo që ndërlidhet me koston financiare, implikimet buxhetore. Një ndër parakushtet për nisjen e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ka qenë edhe përgatitja e ndikimit financiar të marrëveshjes në Buxhetin e Kosovës.

Mbi bazën e parallogaritjeve që ka bërë Ministria e Tregtisë, Ministria e Financave bashkërisht me Komisionin Evropian, implikimet buxhetore për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit priten të jenë 20 milionë euro. Asnjë centë më shumë. 20 milionë euro dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave ka përgatitur planin alternativ përmes të cilit do të kompensoheshin këto 20 milionë euro. Po ashtu duhet pasur parasysh që ky ndikim nuk është i menjëhershëm, sepse jo të gjitha produktet liberalizohen menjëherë, pra ky është një implikim i cili vjen në fund të procesit të hyrjes së plotë në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit do të negociohet në tri faza. Dy raundet e para janë përmbyllur, raundi i tretë pritet të mbahet në fund të shkurtit, më pas Draft-marrëveshja nga Komisioni Evropian shkon tek vendet anëtare për një rishikim final, të njëjtën gjë do ta bëjmë edhe ne këtu me ekipin negociator me Komisionin Parlamentar dhe me të gjitha grupet e interesit dhe vendosja e inicialeve në draft-marrëveshje parashihet të bëhet në pranverë të këtij viti, gjithsesi me këtë Komision, pra me këtë përbërje të Komisionit Evropian, më së largu deri në fund të qershorit.

Ndërkohë që pas vendosjes së inicialeve Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit kalon në procedura të mëtejme në Kosovë në ratifikim këtu në Parlamentin e Kosovës dhe në ratifikim në Parlamentin Evropian.

Është e vërtetë që për Kosovën është përdorur një procedurë ndryshe nga ajo që është përdorur me vendet tjera të rajonit për derisa në strukturë dhe substancë Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit është identike me atë të vendeve të rajonit meqë Kosova është procesi i parë edhe i fundit i stabilizim-asociimit pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, janë përdorur instrumente të reja, të cilat traktati ia ka akomoduar Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian, për ta përfshirë Kosovën në procesin e stabilizim-asociimit.

Kjo e bën Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian, të veçantë e jo struktura apo përmbajtja e saj.

Ne kemi kërkuar nga Komisioni Evropian, por edhe nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian garanci të plota që pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit gjithsesi brenda këtij viti, mirëpo se kur do të ratifikohet në Parlamentin e Kosovës dhe kur do të ratifikohet në Parlamentin Evropian, datën e saktë nuk e di, por gjithësi në vjeshtën e hershme, ajo nënshkruhet dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit, ndërkohë që në fazat transitore mendoj se kjo ka shkaktuar pak konfuzion, fazat transitore për çështje të veçanta, për shembull për ndihmën shtetërore ne kemi kërkuar fazë transitore pesëvjeçare, për mbrojtjen e disa produkteve vendore kemi kërkuar fazë tranzitore dhjetëvjeçare që është maksimalja për procesin e stabilizim-asociimit, ndërkohë që të gjitha këto rekomandime i kemi bërë pas një konsultimi të gjerë gjithëpërfshirës me komunitetin e biznesit në Kosovë, me odat ekonomike, me prodhuesit e kështu me radhë.

Sigurisht që hyrja e plotë në fuqi bëhet pasi të kalojnë fazat transitore, mirëpo kjo nuk ndërlidhet me hapat e mëtejme në procesin e integritimit evropian.

Dialogu me Serbinë ishte një nga pyetjet që u parashtrua, por dialogu me Serbinë dhe implementimi i marrëveshjeve që Kosova ka arritur me Serbinë, do të jenë pjesë e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përkatësisht pjesë e titullit të dytë që nuk është hapur ende, ngjashëm siç është vepruar me Serbinë, ku kapitulli 35 ndërlidhet kryekëput me implementimin e marrëveshjeve që Serbia ka arritur me Kosovën.

Një pyetje e veçantë ishte po ashtu çështja e programeve të qasjes së Kosovës në programet e Bashkimit Evropian, është e vërtetë, janë më shumë se 20 programe në të cilat Kosova do të përfitojë, ato kryesisht janë në fushën e shkëmbimeve kulturore, arsimore, shoqëria civile dhe sektorët e tjerë joqeveritar do të jenë përfituesit më të mëdhenj të programeve të cilat do të hapen, mirëpo edhe hyrja në fuqi, përkatësisht e drejta e Kosovës për të përfituar nga programet ndërlidhet me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Për çështje tjera besoj që mund të debatojmë kur kemi pika të veçanta, por kaq për marrëveshjen.

KRYETARI: Vazhdojmë!

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportet e auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe raportin e auditimit mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale për vitin 2012

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin e auditimit në sektorin e shëndetësisë për vitin përfundimtar më 31 dhjetor 2012 dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën ia jap kryetarit të Komisionit FunkSIONAL, deputetit Ali Sadriu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ALI SADRIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

E nderuar Kryesi,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike gjatë muajit nëntor dhe muajit dhjetor të vitit 2013 ka mbajtur dy takime të Komisionit, për të shqyrtuar raportin e auditimit, pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, auditimi i menaxhimit të sistemit të prokurimit në Qendrën Klinike Universitare, auditimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollin menaxherial të Agjencisë Kosovare për Produkte medicinale si dhe raportin e performansës për menaxhimin e mbeturinave medicinale.

Komisioni ka vendosur që Kuvendit t'i paraqesë 7 rekomandime për Ministrinë e Shëndetësisë, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës si dhe për Agjencinë për Produkte Medicinale.

Qëllimi i këtyre rekomandimeve është që t'i jepet një afat kohor Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve shëndetësore që janë të involvuar në këtë proces të adresojnë të gjitha shkeljet e konstatuara nga raporti i auditimit.

Sipas raportit të Auditimit, Ministria e Shëndetësisë kishte opinion të pakualifikuar me theks të çështjes, për shkak të gabimeve në pasqyra vjetore financiare si dhe mos paraqitjen e drejtë të stoqeve për spitalet regjionale, siç janë në Pejë dhe Gjakovë, ndërsa edhe në buxhetin kapital nuk kishte shfrytëzim racional, vlen të theksohet se vetëm në tremujorin e fundit buxheti konsumohet jo më pak se 54%.

Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit paraprak janë implementuar nga menaxhmenti. Në procesin e prokurimit janë identifikuar një numër i dobësive, ndër tjera, do t'i veçojmë disa.

Kontrata për dizajnimin e projektit ishte mbështetur vetëm në marrëveshje gojore. Është fjala për ndërtimin e një rezervari të ujit në Spitalin e Prizrenit, i cili kushton jo më pak se 92 141 euro.

Rezervuar i njëjtë në Prishtinë është ndërtuar, me vetëm 10 000 euro.

Tenderi për mirëmbajtjen e higjienës në objektin e Spitalit ishte kthye tri herë në rivlerësim nga OSHP-ja për ankesën e njërit nga ofertuesit.

Në rastin e katërt, po i bie në këtë rast, OSHP-ja e urdhëron Ministrinë që t'ia japë përsëri të njëjtë operator i cili referenca i kishte negative nga punët e kryera më herët dhe Ministria e merr, e realizon nën ndikimin pra të OSHP-ës. Nuk po e cek rastësisht, sepse kemi pasur seancën e kaluar kur është kërkuar që të votohet bordi i njëjtë i cili ka qenë edhe më parë.

Furnizimi jo në përputhje me kontratën. Është fjala për situata kur Ministria e Shëndetësisë ishte furnizuar me penj kirurgjike që nuk kanë qenë në përputhje me specifikat e kontratës. Vlera e këtij furnizimi ishte jo më pak se 116.352 euro.

Shkojmë tutje. Në kontratat për preparate kite kundër virusit të Nilit Perëndimor, thuhet se ato duhet të kalojnë nëpërmjet depos qendrore. Kjo nuk ka ndodhur dhe barnat nuk ishin evidentuar në sistemin e informimit shëndetësor në SISH, njësoj është vepruar edhe me vaksinat e pranuar nga UNICEF-i për muajin shkurt në vlerë prej 264 701 euro.

Mungesa e barazimeve financiare me spitale ku trajtohen pacientët jashtë Kosovës. Nuk ka barazim të përmbushjes, gjegjësisht të konsumimit të mjeteve të lejuara, gjegjësisht harmonizimin e mjeteve të lejuara me ato të cilat janë realizuar.

Në të gjitha kategoritë e të hyrave kishte dallime në mes të vlerës së prezantuar në raportin financiar dhe evidencave nga njësia raportuese. Është fjala për evidencën e të hyrave nga banderolat në Agjencinë Kosovare të Produkteve Medicinale, të cilat u trajtoheshin gjatë vitit 2012.

Sipas çmimit aktual të banderolave bie se janë shtypur dhe shitur 16 824 428 njësi, ndërsa sipas shënimeve të Zyrës për banderola ishin shtypur dhe shitur 22 231 917 banderola, që konverton në mjete monetare që i bie ndryshimi për 37 851 euro.

Pastaj auditori ka konstatuar në procesin e inicimit, vlerësimit, të blerit, pranimi të mallit e tjerë e kryen i njëjti person, që është në kundërshtim me dispozita ligjore.

Ka mospërputhje në furnizim me fatura të derivateve të naftës, çmimi në kontratë ishte 1,15 euro në litër, furnizohet me 1,25 centë, do të thotë paguan më shtrenjtë.

Sipas të dhënave të auditorit Komisioni ka konstatuar se mbeturinat asgjësohen në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, mosfunksionimi i furrave për djegie ka shkaktuar mungesë të trajtimit adekuat të mbeturinave të cilat mund të trajtohen vetëm në këtë mënyrë.

Në mungesë të një zgjidhjeje alternative për trajtimin e tyre, institucionet shëndetësore janë orientuar kah kompanitë që e bëjnë trajtimin e mbeturinave komunale duke mos e pasur të qartë se këto nuk janë institucione të licencuara dhe trajtimin e mbeturinave që gjenerojnë si rezultat i kujdesit shëndetësor, trajtimi nga personat e palicencuar, mund të rezultojë që mbeturinat të ekspozohen në atë mënyrë që ta rrezikojnë shëndetin dhe mjedisin.

Edhe Agjencia Alternative e Mbeturinave Patologjike bëhet nga personat jo kompetentë. Bazuar në të gjitha të gjeturat e auditorit, Komisioni ka vlerësuar që është e domosdoshme që të bëhet një auditim specifik i performansës për shërbimet që u ofrohen qytetarëve, shfrytëzimin e pajisjeve medicinale dhe furnizimin me barna, pjesë rezervë, servisimin e tyre e tjera e tjera, me qëllim të mbikëqyrjes së gjetjes në këto institucione

bazuar në të gjeturat e auditorit Komisioni ka kërkuar dhe kërkon nga Kuvendi që raporti të miratohet me këto rekomandime që do t'i lexoj tani.

1. Ministria e Shëndetësisë në afatin prej një muaji të hartojë një plan veprimi për adresimin e rekomandimit të dhënë nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm sipas raportit të auditimit dhe të njëjtin ta procedojë në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

2. Ministria e Shëndetësisë, në afat prej tre muajve me raport me shkrim të njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike si vijon:

- a) Planet për menaxhimin e mbeturinave të institucioneve shëndetësore;
- b) Emërimin e personave përgjegjës për procesin e menaxhimit të trajtimit të mbeturinave për të gjitha institucionet shëndetësore sipas kriterëve të përcaktuara;
- c) Emërimin e Komisionit për Menaxhimin e Mbeturinave të Rrezikshme për të gjitha institucionet shëndetësore.

3. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të instalojnë sistem të integruar për menaxhimin e asgjësimit të mbeturinave në institucionet shëndetësore.

Lidhur me këtë Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të njoftojnë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në afatin prej 6 muajve, se aty kërkohen investime dhe afati është dhënë më i gjatë.

4. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të gjejë një zgjidhje të përhershme për deponimin e mbeturinave toksike deri në asgjësimin final të tyre sipas standardeve.

Lidhur me këtë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ta njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike me raport me shkrim në afatin prej 6 muajve.

5. Qendra Klinike Universitare e Kosovës, në afatin prej një muaji të dorëzojë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

6. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të bëjë auditivin e performansës në sistemin shëndetësor lidhur me:

- a) Shërbimet që u afrohen qytetarëve;
- b) Furnizimin me barna dhe shpërndarjen e tyre te pacientët;
- c) Shfrytëzimin e pajisjeve medicinale, përfshirë këtu defektet, mungesën e reagencave, filmave, stendave, e tjera, e tjera.

7. Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale - AKM në afatin prej 3 muajve me plan të veprimit të njoftojë Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KZAP-it, përkatësisht me afatet kohore për zbatimin e këtij rekomandimi dhe personat përgjegjës për zbatimin e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. E ka fjalën deputeti Ramiz Lladrovci, në emër të Grupit.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të:

- Pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2012;
- Auditimin e menaxhimit të sistemit të prokurimit në Qendrën Universitare të Kosovës;
- Auditimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontroleve menaxheriale në Agjencinë Kosovare për Produktet Medicinale, si dhe
- Raportin e performansës për menaxhimin e mbeturinave medicinale.

Për hir të Kohës, unë nuk do të diskutoj për të gjeturat e këtij raporti, por edhe që të mos përsëritëm me kryetarin e këtij Komisioni, do t'ia dorëzoj sektorit për transkriptim.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike përkrah rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, kjo me qëllim të përmirësimit të sektorit të shëndetësisë në Kosovë. Faleminderit!

(Pjesë e diskutimit, e dorëzuar me shkrim)

Ministria e Shëndetësisë - MSH kishte opinionin e pakualifikuar në theksim të çështjes, kjo për shkak të gabimeve në PVF si dhe mos paraqitja e drejtë e stoqeve.

Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak nuk ishte i plotë dhe kjo ka bërë që shkeljet të përsëriten nga viti i kaluar.

Në procedurat e prokurimit janë identifikuar një numër i dobësive si për shembull:

Në disa raste nuk ka pasur kontratë të shkruar, por vetëm marrëveshje gojore, pastaj, furnizim jo në përputhje me kontratë, në disa raste i njëjti zyrtar ka marrë pjesë në vlerësim të ofertave dhe ka bërë pranimin e mallit.

QKUK, po ashtu është përcjellë me parregullsi të shumta, veçanërisht në fushën e prokurimit.

QKUK nuk ka pasur plan preliminar të prokurimit dhe kjo ka reflektuar mangësi në planin final të prokurimit.

Në disa raste janë zhvilluar procedurat e prokurimit pa deklaratën e disponueshmërisë së fondeve, ndarja e tenderëve dhe aplikimi i procedurave të ndryshme për blerjen e artikujve të ngjashëm apo të njëjtë.

Agjencia Kosovare për produkte medicinale ka pasur mungesë të regjistrit kontabël të pasurisë, informatat lidhur me të arkëtueshmet në fund të vitit nuk janë shpalosur dhe kjo ka qenë arsye e dhënies së opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes si për këtë agjenci, ashtu edhe për MSH-në.

Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale nuk kishte mbajtur evidenca të sakta për të hyrat nga banderolat dhe kjo diferencë ka rezultuar në shumën prej 37 851 euro.

Ministria e Shëndetësisë nuk ka zbatuar kriteret për çështjen e menaxhimit të mbeturinave, ku në institucionet shëndetësore kanë munguar komisionet adekuate dhe personat me kualifikim adekuat për menaxhimin e mbeturinave.

Pastaj, mosfunksionimi i furrave djegëse ka ndikuar që këto mbeturina të përzihen me mbeturina të amvisërisë.

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Afrim Hoti e ka fjalën.

AFRIM HOTI: Faleminderit, kryetar!

Ndonëse rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike kanë përfshirë raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin përfundimtar 2012, pastaj për sistemin e të hyrave vetjake pranë AKPM-së, menaxhimin e prokurimit pranë QKUK-së dhe menaxhimin e mbeturinave medicinale nga institucionet shëndetësore, raporti me i rëndësishëm është ai i pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, kjo nga shumë arsye.

Së pari, Ministria e Shëndetësisë, është institucion i menaxhimit të politikave shëndetësore dhe në rend të parë në planin e gjerë ka përgjegjësinë kryesore për menaxhimin financiar të buxhetit për të gjitha institucionet shëndetësore në nivelin dytësor dhe tretësor, si dhe për shkak të potencialit të burimeve njerëzore për t'i evituar mangësitë e rekomandimeve të vitit paraprak.

Dhe, sipas vetë Auditorit të Përgjithshëm, në faqen 5 të raportit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë, është theksuar në konkluzionet e përgjithshme se janë identifikuar shumë dobësi në fusha të rëndësishme të menaxhimit financiar. Këto dobësi edhe sipas raportit kanë të bëjnë me pasqyrat vjetore financiare, menaxhimin të financave dhe kontrollit mbi to, prokurimi publik dhe sistemi i auditimit të brendshëm.

Qysh në rekomandimin e parë vërehet vërtetimi i paaftësisë së menaxhimit të Ministrisë së Shëndetësisë nga ministri Agani, ku nga vetë rekomandimet që përfshijnë këto fusha vërtetohet mangësia e një menaxhimi të mirëfilltë të Ministrisë së Shëndetësisë në aspektin financiar, i cili padyshim është tejet i rëndësishëm për zhvillimin e politikave shëndetësore. Si shembull kemi çështjen e moszbatimit të rekomandimeve të Auditorit të

Përgjithshëm. Kjo vërehet në mangësitë e monitorimit të shpenzimeve kapitale. Kjo mangësi e vë në rrezik destinimin e drejtë të këtyre shpenzimeve kur kihet parasysh se këto shpenzime edhe ashtu kanë qëllime intensive afatgjata.

Ministrit në këtë raport i është tërhequr vëmendja në drejtim të sistemit të prokurimit në QKUK, gjë që paraqet një problematikë të veçantë duke pasur parasysh potencialin e QKUK-së dhe impaktin e saj në politikat shëndetësore.

Po ashtu, auditori ka tërhequr vëmendjen në menaxhimin e kujdesit të hyrave vetjake të AKPM-së. Rëndësia këtu theksohet kur kihet parasysh se AKPM paraqet autoritetin më kredibil për ta kontrolluar një treg, ku qarkullimi i atyre mallrave është i kufizuar dhe duke pasur parasysh këto çështje është më se e domosdoshme përkujdesja e veçantë financiare në menaxhimin e të hyrave që vijnë nga licencimi i institucioneve farmaceutike.

Përgjatë auditorit, auditori ka vërejtur mangësi në menaxhimin e procedurave të prokurimit nga ana e spitaleve rajonale. Duhet ta kemi në konsideratë faktin se pothuajse bërthama e organizmit të sistemit shëndetësor është ngushtë i lidhur me shërbimin dytësor që kryesisht përbëhet nga institucionet spitalore.

Auditori po ashtu në konkluzionet e përgjithshme ka tërhequr vëmendjen edhe për sistemin e auditimit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë. Këtu duhet të kemi një gjë parasysh se çështja e auditimit që është një nga mekanizmat e brendshme të institucioneve publike për kontrollin dhe revizionin e brendshëm të organizatave buxhetore shihet se tek rasti i Ministrisë së Shëndetësisë, Njësia e auditimit të brendshëm nuk është përkujdesur për zbatimin e rekomandimeve që janë dhënë nga vetë Njësia që ka kryer auditimin e brendshëm.

Këto lëshime të bëra nga Njësia e auditimit të brendshëm na bënë të besojmë se kjo Njësi ka pasur qëllim vetëm të përmbushjes formale të kërkesës ligjore për funksionimin e auditimit të brendshëm, por jo edhe efikasitetin e një auditimi të tillë.

Auditori ka vërejtur se rekomandimet e vitit paraprak nuk janë përmbushur në nivel të kënaqshëm, mbase është zhgënjyese që nga gjithsej 12 rekomandimeve mbi pasqyrat financiare deri më tani janë përmbushur në plotni vetëm 2 rekomandime, 4 nga to janë duke u zbatuar pjesërisht, ndërsa gjithsej 6 rekomandime nuk janë zbatuar fare. Kjo tregon më së mirë seriozitetin e Ministrisë së Shëndetësisë në fushën e menaxhimit të financave publike. Kjo bie në konstatim se dobësitë më kryesore kishin të bënin me prezantimin jo të saktë të pasqyrave vjetore financiare, raportimeve të pasakta nga njësitë e Ministrisë, menaxhimin e dobët të investimeve kapitale, menaxhimi jo i mirë i Depos qendrore të barnave, menaxhimi jo efikas i detyrimeve.

Auditori po ashtu ka vërejtur se gjatë nënshkrimit të kontratave nuk janë marrë për bazë nevojat reale për furnizim me pajisje dhe material medicinal.

Kështu, për shembull, kontrata për furnizim me produktin cefriaxone 250 miligramë, për sasinë e paraparë për 7 mijë njësi është lidhur kontratë afatgjatë për furnizim me 10 mijë njësi që paraqet një tejkalim të nevojave të arsyeshme ku në këtë rast është favorizuar njëri operator ekonomik.

Raportit të proceduar, auditori i ka bashkëlidhur edhe listën e rekomandimeve nga viti paraprak dhe në këtë listë shihen disa nga rekomandime tejet të rëndësishme që nuk janë zbatuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë. Si rekomandim i dalluar që nuk është zbatuar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë është rekomandimi lidhur me shpenzimet e prokurimit, ku ky rekomandim i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me zbatimin e aktiviteteve të prokurimit nga ana e spitaleve rajonale dhe QKUK-së që sipas legjislacionit që ishte në fuqi këto institucione paraqitnin bërthamën kryesore të organizimit të sistemit shëndetësor.

Rekomandim tjetër me rëndësi është lidhur me menaxhimin e shtogjeve të materialit farmaceutik qendror, rekomandimet më thelbësore kanë pasur parasysh konsideratën e blerjes së barnave duke marrë parasysh afatin e skadencës. Zaten, të gjithë e dimë problemin e asgjësimit të barnave me afat të skaduar që buxhetit të Kosovës i ka kushtuar hiq më pak se 1 milion e 200 000 euro, gjë që këtë tender ministri Agani është akuzuar për ndërhyrjen e dhënien e këtij tenderi për familjarin e tij që fillimisht ishte dhënë për një çmim prej 500 000 euro e ku ky çmim është rritur për 1 200 000 euro.

Andaj, duke marrë parasysh të gjitha këto rekomandime që janë përfshirë në raportin e Auditorit të Përgjithshëm, rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike duhet përkrahur dhe duhet bërë presion në Ministrinë e Shëndetësisë për të ndërmarrë të gjitha veprimet që dalin nga këto rekomandime në mënyrë që keqmenaxhimi i fondeve publike të zvogëlohet në minimum, ose të marrë sipas rekomandimeve të nxjerra nga ky komision parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Aleancës, deputeti Bali Muharremaj e ka fjalën.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka analizuar raportet e auditimit në sektorin e shëndetësisë si dhe i ka përkrahur në parim rekomandimet e dala nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Me qëllim të ketë një kontroll më të lartë të institucioneve shëndetësore në kontekst të afrimit të shërbimeve sa më të mira për qytetarët, Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve shëndetësore që janë të involvuara në këtë proces, i rekomandojmë që t'i adresojnë të gjitha shkeljet e konstatuara nga raporti i auditimit.

Nisur nga raporti i auditimit, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka arritur në konkluzionin e përgjithshëm se në shumicën e fushave të menaxhimit financiar kishte dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Për pasqyrat financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2012 është dhënë opinion i pakualifikuar në theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është bërë për faktin se Ministria e Shëndetësisë nuk kishte arritur të shpalosë informacione të sakta për vlerën e pasurive fikse dhe të stoqeve, rekomandimet nga viti paraprak nuk ishin adresuar në nivelin e dëshiruar.

Si rezultat i kësaj dobësie të njëjtat janë përsëritur nga viti në vit. Vlen të përmendën këto gabime tek shpalosja në pasqyrat vjetore financiare, menaxhim jo i duhur i Depos qendrore të barnave, problemi me raportimin e brendshëm, menaxhimi i detyrimeve të parapaguara.

Menaxhimi i të hyrave është përcjell me mungesë të raportimeve dhe harmonizimeve të mirëfillta, menaxhimi i investimeve kapitale nuk ishte i cilësisë së mirë duke rezultuar me vonesa në ekzekutimin e punimeve, pagesa të avancës kundër dispozitave të ligjit të buxhetit dhe ndryshimet e projekteve kapitale.

Aktivitetet dhe procedurat e prokurimit jo çdo herë janë zhvilluar në harmoni të plotë me ligjin e aplikueshëm, nuk kanë qenë sa duhet efikase dhe në disa raste nuk janë raportuar drejt, si për shembull në Spitalin e Gjakovës.

Mirëpo, auditimi i pasqyrave financiare të Ministria e Shëndetësisë për vitin 2012 tek pagat dhe mëditjet në disa raste kishte probleme me autorizime dhe llogaritjet e kujdestarive. Në një rast tjetër nuk kishte evidenca në lidhje me kujdestaritë e mjekëve, Spitali i Gjakovës.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, përkrah rekomandimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, duke shpresuar se sado pak këto rekomandime do të mbajnë në përgjegjësi ministrin e Shëndetësisë në menaxhimin e parasë publike dhe në ofrimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputeti Gëzim Kelmendi e ka fjalën.

GËZIM KELMENDI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar ministër,

Deputetë të nderuar,

Dëshiroj që në emër të Koalicionit për Kosovë të Re të falënderoj punën e Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare, por megjithatë ne nuk pajtohemi me shumicën dërmuese të këtyre rekomandimeve nga raporti i auditimit të përgjithshëm për faktin se pjesën dërmuese të këtyre rekomandimeve që janë 7 në tërësi, i shohim se janë të ndërlidhura me pjesë që kanë të bëjnë edhe me fushën e Komisionit për Shëndetësi, prandaj kryesisht nuk e prekin anën profesionale të Komisionit për Mbikëqyrjen Financiare.

Ajo çka u mungon këtyre rekomandimeve në pikë të parë është pika e parë kryesore që nuk është cekur nga Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare është se Ministria e

Shëndetësisë nuk posedon buxhet të mjaftueshëm financiar për mbulimin dhe menaxhimin e sistemit shëndetësor në tërësi.

Të mos harrojmë se me një buxhet të mangët dhe as gjysmak, por edhe më pak se gjysmak, po arrin që Ministria e Shëndetësisë t'i bëjë ballë një sistemi shëndetësor në nivelin më të ulët në nivel të rajonit për faktin se të mos harrojmë, një vend në rajonin tonë, një fqinj pak më larg se fqinjë e kemi Slloveninë me numër të njëjtë të banorëve sa ne, me 2 milionë banorë, ka një buxhet për shëndetësi prej 3 miliardë eurove, ndërsa ne me një buxhet prej 100 milionë euro dëshirojmë t'i plotësojmë të gjitha kënaqësitë dhe apetitet e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, me 100 milionë, 120 milionë euro buxhet për shëndetësi, unë mendoj se është e arritur, është punuar për të mos u bërë megaloman dhe për të mos i hiperbolizuar çështjet në plotëni, por është punuar mjaft, edhe sa i përket menaxhimit me barna. Kemi pasur gati 90% të rasteve, për të mos thënë 100% furnizim adekuat, qoftë të gjitha qendrave rajonale e spitalore, por edhe QKUK-s dhe është arritur të mbulohen të gjitha nevojat dhe kërkesat e pacientëve në nivel të Kosovës. Por mos të harrojmë edhe kërkesat e mëdha të pacientëve për shërim dhe trajtime jashtë vendit në nivel të Kosovës, të cilat Ministria e Shëndetësisë në pjesën dërmuese të rasteve ka arritur t'i realizojë në sajë të bashkëpunimit të mirë me vendet e rajonit, me vendet e Bashkimit Evropian dhe vendet e tjera të të cilat ka arritur të dërgojë pacientë në sajë të bashkëpunimit të saj që e ka arritur.

Përndryshe, nëse do të ishte bërë një analizë më e mirë apo një bashkëpunim më i mirë me Komisionin për Shëndetësi dhe të nxirren konkludimet nga Auditimi i Përgjithshëm, atëherë padyshim që këto rekomandime do të ishin më frytdhënëse dhe më inkurajuese për punën e Ministrisë së Shëndetësisë.

Përndryshe, ne si Koalicion për Kosovë të Re, nuk mund t'i mbështesim këto rekomandime për faktin se u mungon shtylla kryesore e këtyre rekomandimeve dhe ai çka është që të kërkohej në vazhdimësi mbështetja, rritja e mbështetjes financiare për Ministrinë e Shëndetësisë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja e lajmëruar dhe mund të them e fundit, është Time Kadriaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar!

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ka bërë auditim të pasqyrave financiare në Ministrinë e Shëndetësisë. Auditimi është bërë në sfera të rëndësishme të veçantë në Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe Auditimi mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale.

Zyra e Auditorit në këto pika ka hasur në probleme të shumta, si në planifikim edhe në menaxhim.

Të gjitha këto parregullsi nuk janë të panjohura as për ne, deputetë të nderuar, dhe as për opinionin e gjerë e sidomos për pacientë të cilët po i paguajnë këto, këtë qeverisje të

keqe, sepse atyre nuk po u afrohen shërbime shëndetësore kualitative ashtu siç e meritojnë.

Nga ky keqmenaxhim është fajtores Qeveria e Kosovës që asnjëherë nuk e pati prioritet shëndetësinë e kjo shihet nga buxheti i ndarë për këtë sferë jetike, që krahasuar me vendet e rajonit, buxheti është shumë i vogël.

Qendra Klinike Universitare, një qendër kryesore apo qendra terciare për shërbime shëndetësore më të kualifikuar përballet me këto probleme. Çka mund të diskutojmë? Për katër vjet kjo Qendër klinike aq funksionale është sa që nuk ka mund t'i zgjedhë drejtorët e klinikave. Pra, hiq më pak se 4 vjet, mungesa e barnave nga lista esenciale, mungesa e reagensëve, filmave të rëntgenit, prishja e aparaturave si CT, rezonancë magnetike, koha e gjatë e pritjes për shërbime të cilës do natyrë, i bën qytetarët e Kosovës që të kërkojnë zgjidhje jashtë Kosove.

Qeveria po thirret se kemi shëndetësi falas, e unë sot po ju them, s'ka shëndetësi falas, sepse barnat, analizat, rëntgeni, CT-ja, rezonanca magnetike kanë kosto të lartë buxhetore dhe kjo po i kushton xhepit të varfër të qytetarit të Kosovës e të mos flasim për mungesën e citostatikëve që është e papërbalueshme blerja e këtyre barnave dhe qytetarët detyrohen në mënyra të ndryshme t'i sigurojnë paratë për sigurimin e këtyre barnave.

Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale, kur flitet për këtë Agjenci menjëherë na kujtohen skandalet e njëpasnjëshme në këtë Agjenci, qoftë në abuzime me barna, me banderola, me pranim të barnave me afat të skaduar, kontraktim i barnave me kompani të pa licencuara dhe sjellja e barnave të dyshimta në Kosovë, barna që shërbejnë pacientët tonë të cilët çdo ditë po e humbasin besimin në këtë Qeveri.

Menaxhimi i mbeturinave medicinale, secili institucion shëndetësor, bile spitalet dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës, i kanë furrat për eliminimin e mbeturinave medicinale, e tash po del se ky eliminim nuk bëhet sipas standardeve, gjë që e bën për të dyshuar, se ndoshta gjatë eliminimit të këtyre mbeturinave po helmojmë popullatën që jeton përreth këtyre furrave apo insenatorëve, ose e kemi rastin e grumbullimit të barnave me afat të skaduar dhe procesi i eliminimit i ka kushtuar gjysmë milioni buxhetit të varfër të shëndetësisë.

Andaj kërkojmë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia në Ministrinë e Shëndetësisë e në të gjitha institucionet tjera se ndryshe me këtë qeverisje Kosovën po e kthejmë prapa dhe qytetarët po i udhëzojmë: kërkon shërbime jashtë Kosove se në Kosovë nuk ka shëndetësi. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, mund të përgjigjesh në ndonjë pyetje që ta kanë bërë.

FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Natyrisht këtë fjalë time nuk do ta kanalizoj në atë drejtim se çka është bërë e çka s'është bërë në shëndetësi, po fokusohem në temën, në pikën e rendit të ditës, konkretisht në

raportin që e ka përgatitur Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që e falënderoj për punën e bërë.

Dua vetëm të theksoj se këto mangësi ne i kemi diskutuar në detaje dhe ato që i paraqiti disa prej parashtrësve kryetari i Komisionit, i kemi diskutuar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në detaje.

Unë e kam mirëpritur raportin zyrtar që ka ardhur për miratim në Kuvend, kur nuk janë shumë prej pohimeve që u paraqitën në fjalën hyrëse të kryetarit të Komisionit, sepse ato janë çështje të diskutuara dhe të elaboruara dhe këtë pjesë e cila është paraqitur në raport mendoj se ka bazë faktike dhe me të cilën ne jemi marrë shumë seriozisht edhe gjatë vitit 2013. Ne i kemi adresuar këto çështje qysh gjatë vitit 2013 në detaje, plani i veprimit i kërkuar me pikën 1 të rekomandimit është i përgatitur dhe ai qysh nesër mund të vjen në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Prej këtyre 7 rekomandimeve, 5 janë për Ministrinë e Shëndetësisë, prej këtyre 3 i kemi të realizuara, në 2 do të punojmë dhe do t'i përmbushim dhe t'ia sigurojmë Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike brenda afatit kohor, i cili është përcaktuar.

Duhet ta keni parasysh një fakt që po bëjmë fjalë për raportin e vitit 2012, pra për raportin i cili e adreson vitin në të cilin në janar të atij viti ka ardhur deri te arrestimi i sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë, një vit i cili ka qenë i përcjell me një jo stabilitet të skajshëm në shërbimin civil të Ministrisë në të gjitha nivelet dhe natyrisht kjo është reflektuar edhe me mangësitë të cilat janë konstatuar edhe në raportin e Auditorit të Përgjithshëm.

Ne jemi duke punuar shumë seriozisht që t'i adresojmë këto rekomandime, do të vazhdojmë të punojmë me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në këtë drejtim në mënyrë shumë precize dhe të saktë që t'i eliminojmë deri në fund.

Në fund të fjalës time, deputetit Hoti vetëm një pyetje, nëse ka mundësi që të më tregoj se nuk e paskam ditur që kam akuzë për ndonjë tender të barnave, përpos në qoftë se në fjalorin parlamentar nuk ka vendosur ta fusë terminologjinë e gazetave dhe grupeve të ndryshme të interesit.

KRYETARI: Faleminderit! Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë Rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen Financiare. Votojmë tash.

Votimi nuk është valid. Lus deputetët në tërësi të votojnë.

(Ndërhyrje)

Nuk është çështje e një vote.

Edhe një herë e përsërisim votimin. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Një është me ngritje dore, për ose kundër? Për.

Atëherë me 56 vota janë për, 6 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Raportin me rekomandime të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin e auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë, Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe raportin e auditimit mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale për vitin përfundimtar 31 dhjetor 2012.

Edhe pika e fundit është:

8. Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka propozuar deputetin Ramë Vataj për kryetar të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në vend të ish-deputetit Idriz Vehapi.

Deputeti Bekim Haxhiu është propozuar anëtar i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Deputeti Ramiz Lladrovci është propozuar anëtar i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor në vend të deputetit Nijazi Idrizi.

Ndërsa deputeti Haxhi Shala është propozuar anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, në vend të deputetit Bekim Haxhiu.

Lus deputetët me një ngritje dore, të deklarojnë. Faleminderit! Kundër nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi i miratoi propozimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*